

**KOMBET
E BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për
Ndjekjen Penale të Personave
Përgjegjës për Shkelje të Rënda të
së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare
të Kryera në Territorin e
ish- Jugosllavisë prej Vitit 1991

Lënda Nr IT-05-87-T
Datë: 26 shkurt 2009
Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE

Para: Gjykatësit Iain Bonomy, Kryegjykatës
Gjykatësit Ali Nawaz Chowhan
Gjykatëses Tsvetana Kamenova
Gjykatëses Janet Nosworthy, Gjykatës Rezervë

Ushtruesi i detyrës së sekretarit: z. John Hocking
Aktgjykim, datë: 26 SHKURT 2009

PROKURORI

kundër

**MILLAN MILLUTINOVIQIT
NIKOLLA SHAINOVIQIT
DRAGOLUB OJDANIQIT
NEBOJSHA PAVKOVIQIT
VLADIMIR LLAZAREVIQIT
SRETEN LLUKIQIT**

PUBLIK

AKTGJYKIM

Vëllimi 4 nga 4

Zyrës së Prokurorit:

z. Thomas Hannis
z. Chester Stamp

Avokatëve të të akuzuarve:

z. Eugene O'Sullivan dhe z. Slobodan Zečević për zotin Millan Millutinović
z. Toma Filla dhe z. Vladimir Petrović për zotin Nikolla Shainović
z. Tomislav Vishnjić dhe z. Norman Sepenuk për zotin Dragolub Ojdanić
z. John Ackerman dhe z. Aleksandar Aleksić për zotin Nebojsa Pavković
z. Mihajlo Bakrač dhe z. Gjuro Čepić për zotin Vladimir Llazarević
z. Branko Llukij dhe z. Dragan Ivetić për zotin Sreten Llukij

SHTOJCAT

I. SHTOJCA A – VIKTIMAT E VRASJEVE TË PËRFSHIRA NË AKTAKUZË	3
A. GJAKOVË	3
1. Viktimat e përfshira në Listën G të Aktakuzës.....	3
2. Viktimat e përfshira në Listën H të Aktakuzës.....	7
B. RAHOVEC	170
1. Viktimat e përfshira në Listën B të Aktakuzës (Bellacërkë)	170
2. Viktimat e papërfshira në Listën B të Aktakuzës (Bellacërkë)	191
3. Viktimat e përfshira në Listën C të Aktakuzës (Krushë e Vogël)	193
4. Viktimat e papërfshira në Listën C të Aktakuzës (Krushë e Vogël)	210
C. SUHAREKË	213
1. Viktimat e përfshira në Listën D të Aktakuzës (Suharekë)	213
2. Viktimat e papërfshira në Listën D të Aktakuzës (Suharekë)	228
D. SKËNDERAJ	229
1. Viktimat e përfshira në Listën F të Aktakuzës (Izbicë).....	229
2. Viktimat e papërfshira në Listën F të Aktakuzës (Izbicë)	266
E. VUSHTRRI.....	266
1. Viktimat e përfshira në Listën I të Aktakuzës (Studime e Epërme)	266
2. Viktimat e papërfshira Listën I të Aktakuzës (Studime e Epërme)	290
F. KAÇANIK	290
1. Viktimat e përfshira në Listën K të Aktakuzës (Kotlinë)	290
2. Viktimat e papërfshira në Listën K të Aktakuzës (Kotlinë)	297
3. Viktimat e përfshira në Listën K të Aktakuzës (Vataj (Sllatinë)).....	301
4. Viktimat e papërfshira në Listën K të Aktakuzës (Vataj (Sllatinë)).....	304
5. Viktimat e përfshira në Listën K të Aktakuzës (Stagovë)	305
6. Viktimat e përfshira në Listën K të Aktakuzës (Lisnajë)	308
7. Viktimat e papërfshira në Listën K të Aktakuzës (Lisnajë).....	311
II. SHTOJCA B – LISTA E FORMAVE TË SHKURTUARA TË BURIMEVE LIGJORE TË CITUARA NË KËTË AKTGJYKIM.....	313
III. SHTOJCA C – TABELA E SHKURTESAVE.....	320
SHTOJCA D – LISTA E DËSHMITARËVE.....	323

I. SHTOJCA A – VIKTIMAT E VRASJEVE TË PËRFSHIRA NË AKTAKUZË

A. GJAKOVË

1. Viktimat e përfshira në Listën G të Aktakuzës

1. Dhoma vëren se ka një numër mospërputhjesh midis provave mjeko-ligjore dhe Aktakuzës sa i përket shkrimit të emrave të disa prej viktimave të përfshirë në Listën G. Megjithatë, në shumicën e rasteve, këto mospërputhje janë aq të vogla saqë Dhoma është në gjendje të arrijë në përfundim se të dhënat përkatëse lidhen me viktimën e caktuar.

(1) Dalina Caka (14-vjeçare, femër)

2. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se Dalina Cakën e kishin qëlluar dhe vrarë kur ndodhej në shtëpinë e Lulzim Vejsës më 2 prill 1999.¹ Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Dalina Caka ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.²

(2) Delvina Caka (6-vjeçare, femër)

3. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se Delvina Caka ishte e pranishme në shtëpinë e Lulzim Vejsës më 2 prill 1999; megjithatë, ai nuk e pa ta qëllonjë sepse ajo “sikur u largua me vrap”.³ Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Delvina Caka ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.⁴

(3) Diona Caka (2-vjeçare, femër)

4. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se Diona Caka vdiq në shtëpinë e Lulzim Vejsës më 2 prill 1999.⁵ Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Diona Caka ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.⁶

¹ Dren Caka, T. 2631, 2644–2645, 2648, 2661 (31 gusht 2006); P2279 (Planimetria e banesës nr 157, Rruga “Millosh Giliq”).

² Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

³ Dren Caka, T. 2631, 2644–2645, 2649, 2661 (31 gusht 2006);

⁴ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

⁵ Dren Caka, T. 2631, 2645, 2661 (31 gusht 2006); P2279 (Planimetria e banesës nr 157, Rruga “Millosh Giliq”).

⁶ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

(4) Valbona Caka (34-vjeçare, femër)

5. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se kishte parë që Valbona Cakën e kishin qëlluar për vdekje në shpinë kur ndodhej në shtëpinë e Lulzim Vejsës më 2 prill 1999.⁷ Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Valbona Caka ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.⁸

(5) Hysen Gashi (50-vjeçar, mashkull)

6. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se në shtëpinë e Lulzim Vejsës, më 2 prill 1999, ndodhej vetëm një burrë, megjithëse emrin e tij nuk e dha.⁹ Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Hysen Gashi ishte njëri prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.¹⁰

(6) Doruntina Haxhiavdija (8-vjeçare, femër)

7. Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Doruntina Haxhiavdija ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.¹¹

(7) Egzon Haxhiavdija (5-vjeçar, mashkull)

8. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se Egzon Haxhiavdijën e kishin qëlluar dhe vrarë kur ndodhej në shtëpinë e Lulzim Vejsës më 2 prill 1999.¹² Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Egzon Haxhiavdija ishte njëri prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.¹³

(8) Rina Haxhiavdija (4-vjeçare, femër)

⁷ Dren Caka, T. 2631, 2644, 2661 (31 gusht 2006); P2279 (Planimetria e banesës nr 157, Rruga "Millosh Giliq").

⁸ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

⁹ Dren Caka, T. 2635 (31 gusht 2006).

¹⁰ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

¹¹ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

¹² Dren Caka, T. 2649, 2661 (31 gusht 2006); P2279 (Planimetria e banesës nr 157, Rruga "Millosh Giliq").

¹³ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

9. Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Rina Haxhiavdija ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.¹⁴

(9) Valbona Haxhiavdija (38-vjeçare, femër)

10. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se Valbona Haxhiavdijën e kishin qëlluar dhe vrarë kur ndodhej në shtëpinë e Lulzim Vejsës më 2 prill 1999.¹⁵ Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Valbona Haxhiavdija ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.¹⁶

(10) Flaka Hoxha (15-vjeçare, femër)

11. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se kishte parë që Flaka Hoxhën e kishte qëlluar dhe vrarë një polic kur ndodhej në shtëpinë e Lulzim Vejsës më 2 prill 1999.¹⁷ Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se edhe Flaka Hoxha ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.¹⁸

(11) Shahindere Hoxha (55-vjeçare, femër)

12. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se kishte parë që Shahindere Hoxhën (të ëmën e Flakës) e kishin qëlluar dhe vrarë kur ndodhej në shtëpinë e Lulzim Vejsës më 2 prill 1999.¹⁹ Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Shahindere Hoxha ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.²⁰

(12) Manushe Nuçi (50-vjeçare, femër)

13. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se "Dushi", një femër rreth të dyzeteshtatave atë kohë, ishte një prej personave të vrarë në shtëpinë e Lulzim Vejsës më 2 prill 1999.²¹ Hani Hoxha

¹⁴ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

¹⁵ Dren Caka, T. 2649, 2661 (31 gusht 2006); P2279 (Planimetria e banesës nr 157, Rruga "Millosh Giliq").

¹⁶ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

¹⁷ Dren Caka, T. 2644, 2646–2647, 2661 (31 gusht 2006);

¹⁸ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 5; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

¹⁹ Dren Caka, T. 2644, 2661 (31 gusht 2006); P2279 (Planimetria e banesës nr 157, Rruga "Millosh Giliq").

²⁰ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 5; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

²¹ Dren Caka, T. 2644, 2661 (31 gusht 2006).

dhe Lulzim Vejsa thanë se Manushe Nuçi ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Gilliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.²²

(13) Shirine Nuçi (70-vjeçare, femër)

14. Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Shirine Nuçi ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Gilliq" në qytetin Gjakovë, më 2 prill 1999.²³

(14) Arlind Vejsa (5-vjeçar, mashkull)

15. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se Arlind Vejsën e kishin qëlluar dhe vrarë kur ndodhej në shtëpinë e Lulzim Vejsës më 2 prill 1999.²⁴ Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Arlind Vejsa ishte njëri prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Gilliq" në qytetin Gjakovë, më 2 prill 1999.²⁵

(15) Dorina Vejsa (10-vjeçare, femër)

16. Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Dorina Vejsa ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Gilliq" në qytetin Gjakovë, më 2 prill 1999.²⁶

(16) Fetije Vejsa (60-vjeçare, femër)

17. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se Fetije Vejsën e kishin qëlluar dhe vrarë, kur ndodhej në shtëpinë e Lulzim Vejsës, më 2 prill 1999.²⁷ Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Fetije Vejsa ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Gilliq" në qytetin Gjakovë, më 2 prill 1999.²⁸

(17) Marigona Vejsa (8-vjeçare, femër)

²² Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

²³ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

²⁴ Dren Caka, T. 2644–2645, 2661 (31 gusht 2006); P2279 (Planimetria e banesës nr 157, Rruga "Millosh Giliq").

²⁵ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

²⁶ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

²⁷ Dren Caka, T. 2649, 2661 (31 gusht 2006); P2279 (Planimetria e banesës nr 157, Rruga "Millosh Giliq").

²⁸ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

18. Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Marigona Vejsa ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.²⁹

(18) Rita Vejsa (2-vjeçare, femër)

19. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se Rita Vejsën e kanë vrarë, kur ndodhej në shtëpinë e Lulzim Vejsës, më 2 prill 1999.³⁰ Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Rita Vejsa ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.³¹

(19) Sihana Vejsa (8-vjeçare, femër)

20. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se e bija e tretë e Lulit ishte një prej personave të vrarë në shtëpinë e Lulzim Vejsës më 2 prill 1999.³² Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Sihana Vejsa ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.³³

(20) Tringa Vejsa (30-vjeçare, femër)

21. Dren Caka dëshmoi në sallën gjyqësore se Tringa Vejsën e qëlluan policët, kur ndodhej në shtëpinë e Lulzim Vejsës, më 2 prill 1999.³⁴ Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa thanë se Tringa Vejsa ishte një prej personave të vrarë në Rrugën "Millosh Giliq" në qytetin Gjakovë më 2 prill 1999.³⁵

2. Viktimat e përfshira në Listën H të Aktakuzës

22. Dhoma vëren se ka një numër mospërputhjesh midis provave mjeko-ligjore dhe Aktakuzës sa i takon shkrimin të emrave të disa prej viktimave të renditur në Listën H. Megjithatë, në shumicën e rasteve, këto mospërputhje janë kaq të vogla saqë Dhoma është në gjendje të arrijë në përfundimin se të dhënat lidhen me viktimën përkatëse.

(1) Mark Abazi (37-vjeçar, mashkull)

²⁹ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

³⁰ Dren Caka, T. 2644, 2661 (31 gusht 2006); P2279 (Planimetria e banesës nr 157, Rruga "Millosh Giliq").

³¹ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

³² Dren Caka, T. 2641, 2661 (31 gusht 2006).

³³ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

³⁴ Dren Caka, T. 2644, 2661 (31 gusht 2006); P2279 (Planimetria e banesës nr 157, Rruga "Millosh Giliq").

³⁵ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 5; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 15–16 prill 1999), f. 4.

23. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit në Mejë më 27 prill 1999.³⁶ Kufoma me etiketën “Ba05-031T”, ku dy germat e para tregojnë se kufoma vjen nga varri i përbashkët i Batajnicës në Serbi, është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Mark (Gjon) Abazi.³⁷

24. Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Mark (Gjon) Abazit, ndërsa theksohet se shkaku nuk mund të përcaktohej sepse “pjesët të kufomës janë në gjendje të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se janë konstatuar gjurmë zjarri në copëza të eshtrave të kokës, si edhe janë konstatuar edhe fraktura të shumëfishta të eshtrave. Më konkretisht, “fraktura në kularthin e djathtë është shkaktuar nga goditja e një predhe të gjuajtur me armë krahu zjarri, copëza të së cilës janë gjetur në indin e butë përreth frakturës”.³⁸ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, përcakton se shkaku i vdekjes së Mark (Gjon) Abazit ka qenë lëndimi nga goditja me armë zjarri në shtyllën kurrizore.³⁹ Kjo përputhet me aktekspertizën antropologjike përmbledhëse për Mark (Gjon) Abazin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore të Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁴⁰

(2) Pashk Abazi (40-vjeçar, mashkull)

25. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴¹ Kufoma me etiketën “Ba05-156T” është identifikuar përmes analizës së ADN-së se i përket Pashk (Gjon) Abazit.⁴² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Mark (Gjon) Abazit, ndërsa në raport theksohet se nuk mund të përcaktohej shkaku sepse “kufoma është në gjendje të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se nga autopsia janë konstatuar fraktura të shumëfishta të eshtrave dhe se dëmtimet në lëkurë dhe indet e buta në anën e djathtë të zonës murore të kafkës dhe në anën e djathtë të ashtit muror përbëjnë plagë hyrëse:

³⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së). Këtë listë e ka përpiluar ZPZHML-ja mbështetur edhe në KNKK, Listën e Personave të Zhdukur të hartuar nga Policia e UNMIK-ut, Listën e OSBE-së dhe lista të tjera të shoqatave të familjarëve, e cila kontrollohet dhe plotësohet vazhdimisht. Jose Baraybar, P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), f. 6.

³⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 15.

³⁸ P2415 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 05: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 24–29.

³⁹ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 241–243.

⁴⁰ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 243.

⁴¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 15.

“trajektorja e plumbit kalon përmes zgavrës kafkore ku, në një ind të butë të dekompozuar, është gjetur një predhë metalike e deformuar”.⁴³

(3) Pjetër Abazi (53-vjeçar, mashkull)

26. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së e personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁴ Kufoma me etiketën “Ba05-107T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Pjetër (Mark) Abazi.⁴⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së “Ba05–107T”, ndërsa theksohet se shkaku nuk mund të përcaktohej sepse “kufoma ndodhet në gjendje të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Mirëpo, në aktautopsi theksohet se nga autopsia janë konstatuar fraktura të shumëfishta të eshtrave dhe se “është gjetur një predhë metalike me ngjyrë të verdhë në indin e butë të nënlëkurës të shpatullës së djathtë”.⁴⁶ Megjithatë, Dhoma vëren se kjo aktautopsi arrin në përfundimin se mbetjet skeletore të “Ba05-107T” janë të “një mashkulli, përafërsisht 25-deri-30-vjeçar”, çka nuk përputhet me moshën e përafërt të deklaruar në Aktakuzë (53).⁴⁷

(4) Bekim Ademaj (18-vjeçar, mashkull)

27. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-80” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Bekim (Muharem) Ademaj.⁴⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Bekim (Muharem) Ademajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se kishte fraktura të shumëfishta në pjesët e mbetura të kafkës, vertebrave dhe brinjëve, si dhe gjurmë goditjeje me mjete të forta dhe të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.⁵⁰ Edhe në certifikatën e vdekjes, të

⁴³ P2414 (Dokumente që kanë të bëjnë me vendzhvarrimin e Batajnicës 05: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 54–60.

⁴⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 15 (e mbyllur me vulë).

⁴⁶ P2416 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 05: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 8–17.

⁴⁷ P2416 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 05: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 14.

⁴⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 15 (e mbyllur me vulë).

⁵⁰ P942 (Dokumente që kanë të bëjnë vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 446–449.

lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkak i vdekjes së Bekim (Muharem) Ademajt është i papërcaktuar⁵¹ dhe kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Bekim (Muharem) Ademajn, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁵²

(5) Shemsi Ademaj (38-vjeçar, mashkull)

28. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵³ Kufoma me etiketën “2Ba-107” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Shemsi (Binak) Ademaj.⁵⁴ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkak i vdekjes së Shemsi (Binak) Ademajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazën e ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta në kafkë dhe brinjë të shkaktuara me mjete të forta, në fyellin e këmbës së djathtë është gjetur një predhë, ndërsa në disa eshtra janë gjetur gjurmë goditjeje të shkaktuar me zjarr.⁵⁵ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkak i vdekjes së Shemsi (Binak) Ademajt kanë qenë goditjet me armë zjarri në kokë.⁵⁶

(6) Isuf Ademi (36-vjeçare, mashkull)

29. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁷ Kufoma me etiketën “2Ba-90” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Isuf (Avdyl) Ademi.⁵⁸ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkak i vdekjes së Isuf (Avdyl) Ademit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të eshtrave të shkaktuara me mjete të forta, ndërsa kufoma është pjesërisht e

⁵¹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 120–122.

⁵² P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 586.

⁵³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 15 (e mbyllur me vulë).

⁵⁵ P942 (Dokumente që kanë të bëjnë me vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 583–585.

⁵⁶ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 172–173.

⁵⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁸ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 15 (e mbyllur me vulë).

shkrumbuar.⁵⁹ Në certifikatën e vdekjes të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë konstatohet se shkak i vdekjes së Isuf (Avdyl) Ademit është i papërcaktuar.⁶⁰

(7) Mazllum Ademi (17-vjeçar, mashkull)

30. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶¹ Kufoma me etiketën “2Ba-188” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Mazllum (Bajram) Ademi.⁶² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkak i vdekjes së Mazllum (Bajram) Ademit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të eshtrave të shkaktuara me mjete të forta.⁶³ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkak i vdekjes së Mazllum (Bajram) Ademit është i papërcaktuar.⁶⁴ Megjithatë, sipas një raporti përmbledhës antropologjik të përgatitur për Mazllum (Bajram) Ademin nga një mjek ligjor dhe të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, shkak i vdekjes ka qenë një “goditje me armë zjarri në trung”.⁶⁵

(8) Liridon Ahmetaj (17-vjeçar, mashkull)

31. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁶ Kufoma me etiketën “2Ba-17” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Liridon (Çaush) Ahmetaj.⁶⁷ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkak i vdekjes së Liridon (Çaush) Ahmetajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të kafkës, trungut dhe gjymtyrëve të shkaktuara me mjete të forta, dhe se ka gjurmë të

⁵⁹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 499–501.

⁶⁰ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 141–143.

⁶¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 15 (e mbyllur me vulë).

⁶³ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1024–1032.

⁶⁴ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 25–28.

⁶⁵ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 27–28.

⁶⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 15 (e mbyllur me vulë).

ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.⁶⁸ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Liridon (Çaush) Ahmetajt janë goditjet e shumëfishta me armë zjarri në kokë.⁶⁹

(9) Ahmet Ahmeti (54-vjeçar, mashkull)

32. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁰ Kufoma me etiketën “Ba05-076T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ahmet (Mustafë) Ahmeti.⁷¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Ahmet (Mustafë) Ahmetit, ndërsa theksohet se shkaku nuk mund të përcaktohej sepse “kufoma është në gjendje të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohen fraktura të shumëfishta të eshtrave.⁷² Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Ahmet (Mustafë) Ahmetit ka qenë një lëndim në kokë i shkaktuar nga e shtëna me armë zjarri.⁷³

(10) Ahmet Ahmeti (65-vjeçar, mashkull)

33. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-148” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ahmet (Ramadan) Ahmeti.⁷⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Ahmet (Ramadan) Ahmetit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të eshtrave të shkaktuara me mjete të forta dhe se në disa prej eshtrave janë gjetur gjurmë të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.⁷⁶ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Ahmet (Ramadan) Ahmetit ka qenë një “lëndim në gjoks [dhe në] dy krahët e sipërm i shkaktuar nga të shtëna me armë

⁶⁸ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 116–119.

⁶⁹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 19–21.

⁷⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 15 (e mbyllur me vulë).

⁷² P2415 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 05: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 67–72.

⁷³ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 201–202.

⁷⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 16 (e mbyllur me vulë).

⁷⁶ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 819–824.

zjarri”.⁷⁷ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Ahmet (Ramadan) Ahmetin, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁷⁸

(11) Blerim Ahmeti (19-vjeçar, mashkull)

34. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁹ Kufoma me etiketën “2Ba-61” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Blerim (Hysen) Ahmeti.⁸⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Blerim (Hysen) Ahmetit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të eshtrave të shkaktuara me mjete të forta dhe se në disa prej eshtrave janë gjetur gjurmë të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.⁸¹ Edhe në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Blerim (Hysen) Ahmetit është i papërcaktuar⁸² dhe kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Blerim (Hysen) Ahmetin, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁸³

(12) Hysen Ahmeti (68-vjeçar, mashkull)

35. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁸⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-176” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Hysen (Sadik) Ahmeti.⁸⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Hysen (Sadik) Ahmetit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka

⁷⁷ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 269–271.

⁷⁸ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 271.

⁷⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁸⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 15 (e mbyllur me vulë).

⁸¹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 355–357.

⁸² P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 191–192.

⁸³ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 504–505.

⁸⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁸⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 15 (e mbyllur me vulë).

fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.⁸⁶ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkak i vdekjes së Hysen (Sadik) Ahmetit është i papërcaktuar.⁸⁷

(13) Malë Ahmeti (63-vjeçar, mashkull)

36. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁸⁸ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova Mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(14) Adem Aliaj (55-vjeçar, mashkull)

37. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁸⁹ Kufoma me etiketën “2Ba-22” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Adem (Haxhi) Aliaj.⁹⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk është përcaktuar shkak i vdekjes së Adem (Haxhi) Aliajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi vihet në dukje një frakturë në eshtrën e krahut të djathtë të shkaktuar nga një predhë (e cila ka ngecur në asht), si edhe fraktura të tjera të shkaktuara me mjet të fortë. Në disa prej eshtrave janë gjetur gjurmë të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.⁹¹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkak i vdekjes së Adem (Haxhi) Aliajt kanë qenë “lëndimet e shumëfishta nga të shtëna me armë zjarri (në kokë, trung dhe gjymtyrë)”.⁹² Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Adem (Haxhi) Aliajn, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁹³

(15) Agron Aliaj (17-vjeçar, mashkull) dhe Arben Aliaj (19-vjeçar, mashkull)

⁸⁶ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 955–959.

⁸⁷ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 290–291.

⁸⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁸⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁹⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 16 (e mbyllur me vulë).

⁹¹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 145–148.

⁹² P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 189–190.

⁹³ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 548–549.

38. Dhoma vëren se dy etiketa të ndryshme u janë vendosur dy viktimave me emra të ngjashëm: “2Ba–146” për viktimën me emër Arbrn ose Agron (Adem) Aliaj, dhe “2Ba–152” për viktimën me emër Arben ose Agron (Adem) Aliaj, dhe, për rrjedhojë, nuk mund të kuptohet se cilës viktimë i përket cila etiketë.⁹⁴ Agron Aliaj është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së për personat e zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se ai bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit në Mejë më 27 prill 1999. Mirëpo, emri Arben Aliaj nuk përmendet në listën e personave të zhdukur.⁹⁵

39. Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së “2Ba–146”, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të shkaktuara me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁹⁶ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së viktimës me numër “2Ba–146” është i papërcaktuar.⁹⁷ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për “2Ba–146”, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁹⁸

40. Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së “2Ba–152”, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të shkaktuara me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së larë. Krahas kësaj, “është gjetur një predhë metalike e deformuar ngjyrë hiri, në pjesën menjëherë përreth vendit ku bashkohet ashti publik me eshtrën e këllkut.”⁹⁹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstaton se shkaku i vdekjes i viktimës me numër “2Ba-152” është “lëndime të shumta nga të shtëna me armë zjarri”.¹⁰⁰ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për “2Ba–152”, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹⁰¹ Trupi

⁹⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 16. Dhoma vëren se Tabela e Vërtetimeve të Vdekjes e dorëzuar nga Prokuroria e identifikon viktimën me etiketë “2Ba–152” si Agron Aliaj dhe “2Ba–146” si Arben Aliaj (e mbyllur me vulë).

⁹⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁹⁶ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 801–808.

⁹⁷ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 266–268.

⁹⁸ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 268.

⁹⁹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 840–845.

¹⁰⁰ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 272–275.

¹⁰¹ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 274–275.

Gjykues mendon se, në bazë të përfshirjes në listën e personave të zhdukur nga Meja dhe të identifikimit përmes ADN-së të Agron Aliaj si njëri prej dy kampioneve të marra, provohet se u vra në Mejë më 27 prill 1999. Megjithatë, Trupi Gjykues nuk mendon se është provuar që Arben Aliaj të jetë vrasë në Mejë më 27 prill 1999.

(16) Ali Aliaj (50-vjeçar, mashkull)

41. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁰² Kufoma me etiketën “2Ba-37” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ali (Mustafë) Aliaj.¹⁰³ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Ali (Mustafë) Aliajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të eshtrave të shkaktuara nga goditja me mjete të forta dhe se në disa prej eshtrave janë gjetur gjurmë të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.¹⁰⁴ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Ali (Mustafë) Aliajt është i papërcaktuar.¹⁰⁵

(17) Sali Aliaj (53-vjeçar, mashkull)

42. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁰⁶ Kufoma me etiketën “2Ba-222” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Sali (Ramë) Aliaj.¹⁰⁷ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Sali (Ramë) Aliajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, brinjëve, shpatullës së majtë dhe kërcirit të këmbës së djathtë, si dhe gjurmë të goditjes me

¹⁰² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁰³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 16 (e mbyllur me vulë).

¹⁰⁴ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 227–229.

¹⁰⁵ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 51–54.

¹⁰⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁰⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 16 (e mbyllur me vulë).

mjete të forta.¹⁰⁸ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Sali Aliajt është i papërcaktuar.¹⁰⁹

(18) Zenun Aliaj (44-vjeçar, mashkull)

43. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹¹⁰ Kufoma me etiketën “2Ba-44” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Zenun (Ramë) Aliaj.¹¹¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk është përcaktuar shkaku i vdekjes së Zenun (Ramë) Aliajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të eshtrave të shkaktuara me mjet të fortë, në kafkë është gjetur një predhë prej metali të përhirtë dhe në disa eshtra ka gjurmë të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.¹¹² Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Zenun (Ramë) Aliajt është i papërcaktuar.¹¹³

(19) Arben Aliaj (19-vjeçar, mashkull)

44. Shih analizën numër 15, më lart.

(20) Ymer Avdullahu (17-vjeçar, mashkull)

45. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹¹⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-123” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ymer (Xhemail) Avdullahu.¹¹⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Ymer (Xhemail) Avdullahut, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim

¹⁰⁸ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1207–1210.

¹⁰⁹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 368–370.

¹¹⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹¹¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 16 (e mbyllur me vulë).

¹¹² P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 263–265.

¹¹³ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 64–67.

¹¹⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹¹⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 17 (e mbyllur me vulë).

ndaj temperaturës së lartë. Krahas kësaj, është gjetur një predhë metalike “e futur në pjesën e anës së pasme të vertebrës së dytë lumbare, në nivelin e kanalit të shtyllës kurrizore”.¹¹⁶ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes i Ymer (Xhemail) Avdullahu është “goditje e mundshme nga të shtëna me armë zjarri në kokë”.¹¹⁷ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Ymer (Xhemail) Avdullahun, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹¹⁸

(21) Avdyl Avdyli (40–55-vjeçar, mashkull)

46. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima është parë për herë të fundit në Dobrosh më 30 prill 1999.¹¹⁹ Kufoma me etiketën “Ba05-141T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Avdyl (Sejdë) Avdyli.¹²⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Avdyl (Sejdë) Avdyli, ndërsa theksohet se shkaku nuk mund të përcaktohej sepse “kufoma është në gjendje të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se janë konstatuar fraktura të shumëfishta të eshtrave dhe gjurmë zjarri në eshtra dhe në inde të buta.¹²¹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Avdyl (Sejdë) Avdyli ka qenë një plagë në kokë e shkaktuar nga të shtëna me armë zjarri.¹²²

(22) Afrim Avdyli (19-vjeçar, mashkull)

47. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²³ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(23) Bajrush Avdyli (16-vjeçar, mashkull)

¹¹⁶ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), f. 666–673.

¹¹⁷ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 28–29.

¹¹⁸ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 30.

¹¹⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 17 (e mbyllur me vulë).

¹²¹ P2414 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 05: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 32–41.

¹²² P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 193–194.

¹²³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

48. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-198” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Bajrush (Rizah) Avdyli.¹²⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Bajrush (Rizah) Avdyli, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.¹²⁶ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Bajrush (Riza) Avdyli është i papërcaktuar.¹²⁷

(24) Hysen Avdyli (56-vjeçar, mashkull)

49. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-205” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Hysen (Ukë) Avdyli.¹²⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Hysen (Ukë) Avdyli, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, brinjëve dhe krahut të djathtë, si dhe gjurmë goditjeje me mjete të forta dhe të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, ka pasur dëmtimet të eshtrave të kafkës dhe në aktautopsi theksohet se kjo mund të jetë shkaktuar nga depërtimi e një predhe në kokë.¹³⁰ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Hysen (Ukë) Avdyli kanë qenë “lëndimet në kokë, kraharor, e vithe të majtë të shkaktuara nga të shtëna me armë zjarri”.¹³¹ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike

¹²⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 17 (e mbyllur me vulë).

¹²⁶ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1075–1078.

¹²⁷ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 322–324.

¹²⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 17 (e mbyllur me vulë).

¹³⁰ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1113–1120.

¹³¹ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 61–62.

përmbledhëse për Hysen (Ukë) Avdylin, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹³²

(25) Mehmet Avdyli (42-vjeçar, mashkull)

50. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹³³ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(26) Muhedin Avdyli (26-vjeçar, mashkull)

51. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹³⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-45” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Muhedin (Ali) Avdyli.¹³⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Muhedin (Ali) Avdylit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shkaktuara me mjete të forta. Konkretisht, një frakturë e vertebrës së pestë lumbare është shkaktuar nga një predhë, siç theksohet nga gjurma e një fisheku që shkon nga pjesa e pasme në pjesën e përparme, si edhe disa fraktura të kërbishtit ka të ngjarë të jenë shkaktuar nga një predhë. Në kufomë janë gjetur gjurmë të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.¹³⁶ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Muhedin (Ali) Avdylit ka qenë një “lëndim në kraharror dhe komblik, i shkaktuar me armë zjarri”.¹³⁷ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Muhedin (Ali) Avdylin, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹³⁸

(27) Pajazit Avdyli (32-vjeçar, mashkull)

52. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të

¹³² P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 63–64.

¹³³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹³⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹³⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 17 (e mbyllur me vulë).

¹³⁶ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 269–276.

¹³⁷ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 4–5.

¹³⁸ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 6.

fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹³⁹ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(28) Lavdim Bajraktari (22-vjeçar, mashkull)

53. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁴⁰ Kufoma me etiketën “2Ba-126” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Lavdim (Xhafer) Bajraktari.¹⁴¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Lavdim (Xhafer) Bajraktarit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, është gjetur një predhë metalike “në indin e butë në një të tretën e poshtme të zonës së shpatullës së djathtë”.¹⁴² Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Lavdim (Xhafer) Bajraktarit ka qenë “lëndime në trung të shkaktuara nga të shtëna me armë zjarri”.¹⁴³ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Lavdim (Xhafer) Bajraktarin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹⁴⁴

(29) Ali Bajrami (55-vjeçar, mashkull)

54. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁴⁵ Kufoma me etiketën “2Ba-92” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ali (Kadri) Bajrami.¹⁴⁶ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së “2Ba-92”, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të eshtrave të shkaktuara me mjete të forta.¹⁴⁷ Dhoma vëren se aktautopsia arrin në

¹³⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁴⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁴¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 17 (e mbyllur me vulë).

¹⁴² P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 683–692.

¹⁴³ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 34–35.

¹⁴⁴ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 36.

¹⁴⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁴⁶ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 18 (e mbyllur me vulë).

¹⁴⁷ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 502–506.

përfundimin se mbetjet skeletore të “2Ba-92” “i përket një mashkulli me moshë përafërsisht 25 deri 35 vjeç”, çka nuk përputhet me moshën e përafërt të deklaruar në Aktakuzë (55 vjeç).¹⁴⁸ Dhoma është e mendimit se ky dallim sa i takon moshës tregon se kufoma nuk është e Ali (Kadri) Bajramit.

(30) Shaban Bajrami (27-vjeçar, mashkull)

55. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁴⁹ Kufoma me etiketën “2Ba-160” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Shaban (Mehmet) Bajrami.¹⁵⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Shaban (Mehmet) Bajramit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, fytyrës, eshtrave të kofshës, kërbishtit, krahëve dhe shputave të këmbëve, si dhe gjurmë goditjeje me mjete të forta dhe të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.¹⁵¹

(31) Sylë Bajrami (37-vjeçar, mashkull)

56. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁵² Kufoma me etiketën “2Ba-223” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Sylë (Halil) Bajrami.¹⁵³ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Sylë (Halil) Bajramit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se mungon dora e majtë dhe shputa e këmbës së djathtë, se ka fraktura të shumëfishta të vertebrave dhe brinjëve, si dhe gjurmë goditjeje me mjete të forta.¹⁵⁴ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Sylë (Halil) Bajramit ka qenë “lëndime në krahë të shkaktuara nga të shtëna me armë zjarri”.¹⁵⁵ Kjo përputhet me aktekspertizën

¹⁴⁸ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 05: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 505.

¹⁴⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁵⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 18 (e mbyllur me vulë).

¹⁵¹ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 880–886.

¹⁵² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁵³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 17 (e mbyllur me vulë).

¹⁵⁴ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1211–1215.

¹⁵⁵ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 69–70.

antropologjike përmbledhëse për Sylë (Halil) Bajramin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, në të cilën thuhet se në trup janë gjetur plagë të shkaktuara nga të shtëna me armë zjarri.¹⁵⁶

(32) Xhafer Bajrami (35-vjeçar, mashkull)

57. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁵⁷ Kufoma me etiketën “2Ba-128” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Xhafer (Hamza) Bajrami.¹⁵⁸ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Xhafer (Hamza) Bajramit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, këqyrja ka zbuluar një plagë në kokë të shkaktuar me armë zjarri.¹⁵⁹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes i Xhafer (Hamza) Bajramit kanë qenë “plagët e shumëfishta të kokës të shkaktuara nga të shtëna me armë zjarri”.¹⁶⁰

(33) Xhavit Bajrami (27-vjeçar, mashkull)

58. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁶¹ Kufoma me etiketën “2Ba-91” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Xhavit (Ali) Bajrami.¹⁶² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Xhavit (Ali) Bajramit dhe i “2Ba-103” (që, gjithashtu, i përket Xhavit (Ali) Bajramit), ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të eshtrave të shkaktuara me mjete të forta dhe se ka gjurmë të ekspozimit të disa eshtrave ndaj zjarrit.¹⁶³

¹⁵⁶ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 71.

¹⁵⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁵⁸ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 17 (e mbyllur me vulë).

¹⁵⁹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 704–709.

¹⁶⁰ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 209–212.

¹⁶¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁶² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 17 (e mbyllur me vulë).

¹⁶³ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 558–562.

(34) Ali Bala (75-vjeçar, mashkull)

59. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁶⁴ Kufoma me etiketën “Ba05–139T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ali (Sali) Bala.¹⁶⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Ali (Sali) Balës, ndërsa theksohet se shkaku nuk mund të përcaktohet sepse “kufoma është në faza të avancuara të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të eshtrave dhe se ka gjurmë që tregojnë se eshtrat dhe indet e buta janë ekspozuar ndaj zjarrit.¹⁶⁶ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Ali (Sali) Balës është i papërcaktuar.¹⁶⁷

(35) Bajram Bala (46-vjeçar, mashkull)

60. Dhoma vëren se viktimës me emrin Bajram (Ali) Bala i janë vendosur dy etiketa të ndryshme: “Ba05–146T” dhe “Ba05–144DT”.¹⁶⁸ Kjo viktimitë është renditur si i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë, i parë për herë të fundit në Mejë më 27 prill 1999.¹⁶⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit Mjekësor të Beogradit, nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së “Ba05-144DT”, ndërsa theksohet se nga këqyrja e eshtrave nuk është konstatuar asnjë frakturë apo lëndim tjetër.¹⁷⁰ Në certifikatën e vdekjes së lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcaktohet se shkaku i vdekjes së “Ba05-146T” ka qenë një goditje me armë zjarri në kraharor dhe një goditje e mundshme me armë zjarri në këmbën e djathtë.¹⁷¹ Dhoma nuk mendon se shënimi i Bajram (Ali) Balës me dy etiketa vë në dyshim faktin se ai u vra në Mejë më 27 prill 1999.

(36) Mehmet Bala (42-vjeçar, mashkull)

61. Dhoma vëren se viktimës me emrin Mehmet (Ali) Bala i janë vendosur dy etiketa të ndryshme: “Ba05–116T” dhe “Ba05–209DT”.¹⁷² Viktima është përfshirë si person i zhdukur në

¹⁶⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁶⁵ P2559 (Shtojë e Aktekspertizës 004/2005-ER nga muaji shtator 2005 përgatitur nga KNPZH-ja), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 18. (e mbyllur me vulë).

¹⁶⁶ P2414 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 05: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 25–31.

¹⁶⁷ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 476–478.

¹⁶⁸ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 18 (e mbyllur me vulë).

¹⁶⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁷⁰ P2414 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 05: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 42–46.

¹⁷¹ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 197–200.

¹⁷² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 18 (e mbyllur me vulë).

listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁷³ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së “Ba05–116T”, ndërsa theksohet se shkaku nuk mund të përcaktohej sepse “kufoma ndodhet në gjendje të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të eshtrave dhe se ka gjurmë zjarri në indet e buta dhe eshtra.¹⁷⁴ Në certifikatën e vdekjes të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë konstatohet se shkaku i vdekjes së Mehmet (Ali) Balës (viktima me numër “Ba05–116T” dhe “Ba05–209DT”) ka qenë një “lëndim nga të shtëna me armë zjarri në kokë”.¹⁷⁵ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për “Ba05–116T” dhe “Ba05-209DT”, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹⁷⁶ Dhoma nuk mendon se shënimi i Mehmet (Ali) Balës me dy etiketa vë në dyshim faktin se ai u vra në Mejë më 27 prill 1999.

(37) Përparim Bala (28-vjeçar, mashkull)

62. Dhoma vëren se, pas analizave të ADN-së, viktimës me emrin Përparim (Ali) Bala i janë vendosur dy etiketa të ndryshme: “Ba05–155T” dhe “Ba05–213DT”.¹⁷⁷ Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁷⁸ Dhoma nuk mendon se shënimi i Përparim (Ali) Balës me dy etiketa vë në dyshim faktin se ai u vra në Mejë më 27 prill 1999.

(38) Ragip Baliu (30-vjeçar, mashkull)

63. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁷⁹ Kufoma me etiketën “2Ba-48” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ragip (Zenun) Baliu.¹⁸⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk mund të përcaktohej

¹⁷³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁷⁴ P2414 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 05: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1–7.

¹⁷⁵ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 268–269.

¹⁷⁶ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 270.

¹⁷⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 18 (e mbyllur me vulë).

¹⁷⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁷⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 18 (e mbyllur me vulë).

shkaku i vdekjes së Ragip (Zenun) Baliut, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shkaktuara me mjete të forta dhe një frakturë të një vertebre dhe defekt në shpatull që ka shumë të ngjarë të jetë shkaktuar nga një predhë. Ka pasur edhe gjurmë të ekspozimit të eshtrave ndaj temperaturave të larta.¹⁸¹ Në certifikatën e vdekjes të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcaktohet se shkaku i vdekjes së Ragip (Zenun) Baliut ka qenë goditje të shumta me armë zjarri në kraharor¹⁸² dhe kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Ragip (Zenun) Baliun, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹⁸³

(39) Demush Bardheci (29-vjeçar, mashkull)

64. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁸⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-36” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Demush (Selim) Bardheci.¹⁸⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së “2Ba-36”, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se në eshtra janë gjetur gjurmë të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë dhe se ka fraktura të shkaktuara nga goditja me mjete të forta.¹⁸⁶ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Demush (Selim) Bardhecaj është i papërcaktuar.¹⁸⁷

(40) Idriz Bardheci (25-vjeçar, mashkull)

65. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁸⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-40” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Idriz (Dine) Bardheci.¹⁸⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i

¹⁸¹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 286–289.

¹⁸² P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 203–204.

¹⁸³ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 498–499.

¹⁸⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 18 (e mbyllur me vulë).

¹⁸⁶ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 223–226.

¹⁸⁷ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 48–50.

¹⁸⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 18 (e mbyllur me vulë).

vdekjes së Idriz (Dine) Bardhecit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shkaktuar me mjete të forta dhe se në trup janë gjetur gjurmë të shkaktuara nga temperaturat e larta.¹⁹⁰ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Idriz (Dine) Bardhecit është i papërcaktuar.¹⁹¹ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Idriz (Dine) Bardhecin, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹⁹²

(41) Haki Batusha (29-vjeçar, mashkull)

66. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁹³ Kufoma me etiketën “2Ba-238” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Haki (Dervish) Batusha.¹⁹⁴ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Haki (Dervish) Batushës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.¹⁹⁵ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Haki (Dervish) Batushës ka qenë “goditje me armë zjarri në kraharor (dy gjuajtje)”.¹⁹⁶ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Haki (Dervish) Batushën, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹⁹⁷

(42) Armend Beqaj (17-vjeçar, mashkull)

67. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹⁹⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-125” është identifikuar përmes

¹⁹⁰ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 239–245.

¹⁹¹ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 249–251.

¹⁹² P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 251.

¹⁹³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁹⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 18 (e mbyllur me vulë).

¹⁹⁵ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1310–1318.

¹⁹⁶ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 75–76.

¹⁹⁷ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 77.

¹⁹⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

analizave të ADN-së se është personi me emër Armend (Muhamet) Beqaj.¹⁹⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Armend (Muhamet) Beqajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, brinjëve, vertebrave dhe femurit të djathtë, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, “është gjetur një predhë metalike në indin e butë të parakrahut të djathtë, në një të tretën e mesme, në kufirin midis anës së jashtme dhe të pasme të tij”.²⁰⁰ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Armend (Muhamet) Beqajt ka qenë “lëndim me armë zjarri në pjesën e sipërme të shtyllës kurrizore”.²⁰¹ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Armend (Muhamet) Beqajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.²⁰²

(43) Bajram Beqaj (41-vjeçar, mashkull)

68. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²⁰³ Kufoma me etiketën “2Ba-163” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Bajram (Brahim) Beqaj.²⁰⁴ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Bajram (Brahim) Beqajt ka qenë “lëndim me armë zjarri në pjesën e poshtme të kraharorit dhe në komblik”.²⁰⁵ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Bajram (Brahim) Beqajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, ku thuhet, gjithashtu, se ka fraktura të shumëfishta në gjithë kufomën.²⁰⁶

(44) Bedri Beqaj (36-vjeçar, mashkull)

69. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²⁰⁷ Kufoma me etiketën “2Ba-34” është identifikuar përmes

¹⁹⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 19 (e mbyllur me vulë).

²⁰⁰ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 678–682.

²⁰¹ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 31–32.

²⁰² P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 33.

²⁰³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

²⁰⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 20 (e mbyllur me vulë).

²⁰⁵ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 180–181.

²⁰⁶ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 182–183.

²⁰⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

analizave të ADN-së se është personi me emër Bedri (Brahim) Beqaj.²⁰⁸ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Bedri (Brahim) Beqajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shkaktuara me mjete të forta. Krahas kësaj, “është gjetur një predhë metalike e përhirtë në indin e butë ngjitur me anën e djathtë të komblikut”.²⁰⁹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Bedri (Brahim) Beqajt ka qenë një “lëndim me armë zjarri në kraharor, vithe të majtë dhe në të dyja kofshët”.²¹⁰ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Bedri (Brahim) Beqajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.²¹¹

(45) Brahim Beqaj (28-vjeçar, mashkull)

70. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²¹² Kufoma me etiketën “2Ba-161” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Brahim (Sylejman) Beqaj.²¹³ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Brahim (Sylejman) Beqajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kafkës, komblikut, eshtrës së krahut të majtë, eshtrës së jashtëm të parakrahut të djathtë, femurit të djathtë dhe kupës së gjurit të majtë, si dhe gjurmë goditjeje me mjete të forta dhe të ekspozimit temperaturës së lartë.²¹⁴ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor Mjekësor të Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes i Brahim (Sylejman) Beqajt kanë qenë “plagë të shumëfishta të kokës, komblikut dhe barkut të poshtëm, të shkaktuara nga të shtënat me armë zjarri”.²¹⁵

(46) Dritan Beqaj (17-vjeçar, mashkull)

²⁰⁸ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 19 (e mbyllur me vulë).

²⁰⁹ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 212–217.

²¹⁰ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1–2.

²¹¹ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 3.

²¹² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

²¹³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 19 (e mbyllur me vulë).

²¹⁴ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 887–891.

²¹⁵ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 260–263.

71. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²¹⁶ Kufoma me etiketën “2Ba-38” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Dritan (Ymer) Beqaj.²¹⁷ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Dritan (Ymer) Beqajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shkaktuara me mjete të forta dhe nënshtrim temperaturës së lartë.²¹⁸ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Dritan (Ymer) Beqajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, në të cilën thuhet se shkaku i vdekjes është i papërcaktuar.²¹⁹

(47) Emin Beqaj (34-vjeçar, mashkull)

72. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²²⁰ Kufoma me etiketën “2Ba-159” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Emin (Beqë) Beqaj.²²¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Emin (Beqë) Beqajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.²²² Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Emin (Beqë) Beqajt është i papërcaktuar.²²³ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për “2Ba-159”, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.²²⁴

(48) Kujtim Beqaj (16-vjeçar, mashkull)

²¹⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

²¹⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 19 (e mbyllur me vulë).

²¹⁸ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 231–234.

²¹⁹ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 207–208.

²²⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

²²¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 19 (e mbyllur me vulë).

²²² P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 876–879.

²²³ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 46–47.

²²⁴ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 48.

73. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²²⁵ Kufoma me etiketën “2Ba-43” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Kujtim (Tafë) Beqaj.²²⁶ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Kujtim (Tafë) Beqajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shkaktuara me mjete të forta dhe “defekte në gjysmën e djathtë të ashtit ballor të shkaktuar nga një predhë”. Krahas këtyre, ka gjurmë të temperaturës së lartë në disa pjesë të ashtit.²²⁷ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Kujtim (Tafë) Beqajt është i papërcaktuar.²²⁸

(49) Mentor Beqaj (19-vjeçar, mashkull)

74. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²²⁹ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(50) Milazim Beqaj (31-vjeçar, mashkull)

75. Dhoma vëren se, pas analizave të ADN-së, viktimës me emrin Milazim (Beqë) Beqaj i janë vendosur dy etiketa të ndryshme: “2Ba-S-4” dhe “2Ba-S-6”.²³⁰ Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²³¹ Dhoma nuk mendon se shënimi i Milazim (Beqë) Beqajt me dy etiketa vë në dyshim faktin se ai u vra në Mejë më 27 prill 1999.

(51) Ramadan Beqaj (57-vjeçar, mashkull)

²²⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

²²⁶ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 19 (e mbyllur me vulë).

²²⁷ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 258–262.

²²⁸ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 61–63.

²²⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

²³⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 19 (e mbyllur me vulë).

²³¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

76. Dhoma vëren se, pas analizave të ADN-së, viktimës me emrin Ramadan (Shaban) Beqaj i janë vendosur dy etiketa të ndryshme: “Ba08–001DT” dhe “Ba08–005DT”.²³² Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²³³ Dhoma nuk mendon se shënimi i Ramadan (Shaban) Beqajt me dy etiketa vë në dyshim faktin se ai u vra në Mejë më 27 prill 1999.

(52) Rasim Beqaj (46-vjeçar, mashkull)

77. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²³⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-79” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Rasim (Brahim) Beqaj.²³⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Rasim (Brahim) Beqajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, komblikut, fyellit të këmbës dhe kularthit të majtë, si dhe gjurmë goditjeje me mjete të forta dhe të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.²³⁶ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Rasim (Brahim) Beqajt është i papërcaktuar.²³⁷

(53) Tafë Beqaj (54-vjeçar, mashkull)

78. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²³⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-42” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Tafë (Shaban) Beqaj.²³⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Tafë (Shaban) Beqajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi

²³² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 19 (e mbyllur me vulë).

²³³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

²³⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

²³⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 19 (e mbyllur me vulë).

²³⁶ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 442–445.

²³⁷ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 116–119.

²³⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

²³⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 19 (e mbyllur me vulë).

theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.²⁴⁰ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Tafë (Shaban) Beqajt është i papërcaktuar.²⁴¹

(54) Ymer Beqaj (50-vjeçar, mashkull)

79. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²⁴² Kufoma me etiketën “2Ba-192” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ymer (Brahim) Beqaj.²⁴³ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Ymer (Brahim) Beqajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se mungon e gjithë koka, ka fraktura të shumëfishta të kufomat, si dhe gjurmë goditjeje me mjete të forta dhe të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.²⁴⁴ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Ymer (Brahim) Beqajt është i papërcaktuar.²⁴⁵

(55) Albert Beqiraj (21-vjeçar, mashkull)

80. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²⁴⁶ Kufoma me etiketën “2Ba-05” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Albert (Tahir) Beqiraj.²⁴⁷ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Albert (Tahir) Beqirajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se

²⁴⁰ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 254–257.

²⁴¹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 58–60.

²⁴² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

²⁴³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 19 (e mbyllur me vulë).

²⁴⁴ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1052–1054.

²⁴⁵ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 311–313.

²⁴⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

²⁴⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 20 (e mbyllur me vulë).

frakturat e brinjës së katërt në anën e majtë të kufomat dhe të femurit të majtë janë shkaktuar nga plagë nga të shtënat me armë zjarri.²⁴⁸

(56) Arsim Beqiraj (16-vjeçar, mashkull)

81. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²⁴⁹ Kufoma me etiketën “2Ba-118” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Arsim (Musa) Beqiraj.²⁵⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Arsim (Musa) Beqirajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.²⁵¹ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor të Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Arsim (Musa) Beqirajt kanë qenë “plagët nga të shtëna me armë zjarri”.²⁵² Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për “2Ba-118”, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, ku thuhet se shkaku i vdekjes kanë qenë “goditjet nga të shtëna me armë zjarri në kofshën e majtë”.²⁵³

(57) Sylë Beqiraj (55-vjeçar, mashkull)

82. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²⁵⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-120” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Sylë (Haxhi) Beqiraj.²⁵⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore të Fakultetit të Mjekësisë në Beograd nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Sylë (Haxhi) Beqirajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, vertebrave, brinjëve, dërrasës së krahavorit dhe

²⁴⁸ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 49–52.

²⁴⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

²⁵⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 20 (e mbyllur me vulë).

²⁵¹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 644–647.

²⁵² P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 193–196.

²⁵³ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 578.

²⁵⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

²⁵⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 20 (e mbyllur me vulë).

krahëve, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, është gjetur një predhë metalike “në indin e butë rrethues në lartësinë e vertebrës së shtatë në zonën e kraharorit, në të majtë të shtyllës kurrizore”.²⁵⁶ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Sylë (Haxhi) Beqirajt është “[plagë të shumëfishta nga të shtënat me armë zjarri]”.²⁵⁷

(58) Tahir Beqiraj (58-vjeçar, mashkull)

83. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²⁵⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-154” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Tahir (Haxhi) Beqiraj.²⁵⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Tahir (Haxhi) Beqirajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta në gjithë kufomën, si edhe “fraktura të kafkës, trungut dhe gjymtyrëve, të shkaktuara me mjete të forta”, dhe gjurmë të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, “është gjetur [një] predhë metalike në zonën e poshtme të djathtë të pubisit”.²⁶⁰ Në certifikatën e vdekjes të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë konstatohet se shkaku i vdekjes së Tahir (Haxhi) Beqirajt janë “plagët nga të shtënat me armë zjarri në barkun e poshtëm”.²⁶¹

(59) Ahmet Berisha (45-vjeçar, mashkull)

84. Dhoma vëren se dy viktima me të njëjtin emër janë të përfshirë si të zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Mirëpo, asnjëri prej tyre nuk ka qenë i zhdukur në komunën e Gjakovës.²⁶² Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këto viktima të përfshira në listë.

(60) Halil Berisha (50-vjeçar, mashkull)

85. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të

²⁵⁶ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 654–657.

²⁵⁷ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 197–199.

²⁵⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

²⁵⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 20 (e mbyllur me vulë).

²⁶⁰ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 852–855.

²⁶¹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 253–255.

²⁶² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

fundit më 27 prill 1999 në Mejë.²⁶³ Kufoma me etiketën “2Ba-162” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Halil (Ukë) Berisha.²⁶⁴ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Halil (Ukë) Berishës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.²⁶⁵ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Halil (Ukë) Berishës ka qenë “lëndimi në shtyllën kurrizore në pjesën e mesit, i shkaktuar nga të shtëna me armë zjarri”.²⁶⁶ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Halil (Ukë) Berishën, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.²⁶⁷

(61) Avni Binaku (42-vjeçar, mashkull)

131. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁰¹ Kufoma me etiketën “2Ba-187” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Xhafer (Adem) Gaxherri.⁴⁰² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore e Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Xhafer (Adem) Gaxherrit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të brinjëve, vertebrave, kularthit të majtë, eshtrës së gjatë të parakrahut të djathtë, ashtit komblikut dhe këmbëve, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.⁴⁰³ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Xhafer Gaxherrit kanë qenë “plagët në kraharor të shkaktuara me armë zjarri”.⁴⁰⁴

(97) Demë Gjocaj (39-vjeçar, mashkull)

132. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁰⁵ Kufoma me etiketën “2Ba-84” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Demë (Ali) Gjocaj.⁴⁰⁶ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes

³⁹⁹ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 189–190.

⁴⁰⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁰¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁰² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 28 (e mbyllur me vulë).

⁴⁰³ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1020–1023.

⁴⁰⁴ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 308–310.

⁴⁰⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁰⁶ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 29 (e mbyllur me vulë).

së Demë (Ali) Gjocajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁴⁰⁷ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Demë (Ali) Gjocajt është i papërcaktuar.⁴⁰⁸

(98) Ardian Gjokaj (23-vjeçar, mashkull)

133. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁰⁹ Kufoma me etiketën “2Ba-100” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ardian (Ibrahim) Gjokaj.⁴¹⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Ardian (Ibrahim) Gjokajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, “është gjetur një predhë metalike, e futur në pjesën e pasme të kokës së femurit të djathtë”.⁴¹¹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Ardian (Ibrahim) Gjokajt ka qenë “plagë e shkaktuar me armë zjarri në kraharor”.⁴¹² Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Ardian (Ibrahim) Gjokajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁴¹³

(99) Asllan Golaj (41-vjeçar, mashkull)

134. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴¹⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-26” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Asllan (Brahim) Golaj.⁴¹⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i

⁴⁰⁷ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 467–470.

⁴⁰⁸ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 132–134.

⁴⁰⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴¹⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 29 (e mbyllur me vulë).

⁴¹¹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 544–547.

⁴¹² P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 162–165.

⁴¹³ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 592.

⁴¹⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴¹⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 29 (e mbyllur me vulë).

vdekjes së Asllan (Brahim) Golajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, është gjetur një predhë në dërrasën e kraharorit.⁴¹⁶ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkak i vdekjes së Asllan (Brahim) Golajt ka qenë “goditje të mundshme me armë zjarri në kokë dhe në kraharor”.⁴¹⁷ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Asllan (Brahim) Golajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, ku thuhet se shkak i vdekjes ka qenë “goditje me armë zjarri në kraharor (dhe goditje e mundshme nga të shtëna me armë zjarri në kokë)”.⁴¹⁸

(100) Avdi Golaj (31-vjeçar, mashkull)

135. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴¹⁹ Kufoma me etiketën “2Ba-208” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Avdi (Murat) Golaj.⁴²⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkak i vdekjes së Avdi (Murat) Golajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të qafës, vertebrave, shputave të këmbëve dhe shpatullës së majtë, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.⁴²¹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkak i vdekjes së Avdi (Murat) Golajt ka qenë “goditje me armë zjarri në kraharor”.⁴²² Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Avdi (Murat) Golajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁴²³

(101) Idriz Golaj (56-vjeçar, mashkull)

⁴¹⁶ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 163–167.

⁴¹⁷ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 34–37.

⁴¹⁸ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 496.

⁴¹⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴²⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 29 (e mbyllur me vulë).

⁴²¹ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1130–1134.

⁴²² P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 77–78.

⁴²³ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 511.

136. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴²⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-77” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Idriz (Mehmet) Golaj.⁴²⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Idriz (Mehmet) Golajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, janë gjetur pjesë predhe “në të djathtë të vertebrës së pestë lumbare, L5”.⁴²⁶ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Idriz (Mehmet) Golajt ka qenë “plagë të shtyllës kurrizore dhe komblikut, të shkaktuara me armë zjarri”.⁴²⁷ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Idriz (Mehmet) Golajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, ku thuhet se shkaku i vdekjes ka qenë “plaga e shkaktuar me armë zjarri në shtyllën kurrizore”.⁴²⁸

(102) Musa Golaj (24-vjeçar, mashkull)

137. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴²⁹ Kufoma me etiketën “2Ba-09” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Musë (Rexhë) Gola.⁴³⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Musë (Rexhë) Golës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, ka një dëmtim të femurit të djathtë, i cili mund të jetë shkaktuar “nga kova e ekskavatorit”.⁴³¹ Certifikata e vdekjes e

⁴²⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴²⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 29 (e mbyllur me vulë).

⁴²⁶ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 432–436.

⁴²⁷ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 110–112.

⁴²⁸ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 582.

⁴²⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴³⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 29 (e mbyllur me vulë).

⁴³¹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 74–78.

lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkak i vdekjes së Musë (Rexhë) Golajt është “plaga në trung, e shkaktuar me armë zjarri”.⁴³²

(103) Ramë Golaj (35-vjeçar, mashkull)

138. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴³³ Kufoma me etiketën “2Ba-56” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ramë (Mehmet) Golaj.⁴³⁴ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkak i vdekjes së Ramë (Mehmet) Golajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, vertebrave, brinjëve, komblikut, ashtit pubik dhe femurit të djathtë, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.⁴³⁵ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkak i vdekjes së Ramë (Mehmet) Golajt kanë qenë “lëndimet në kokë, qafë dhe komblik, të shkaktuara me armë zjarri”.⁴³⁶ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Ramë (Mehmet) Golajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁴³⁷

(104) Rexhë Golaj (54-vjeçar, mashkull)

139. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴³⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-13” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Rexhë (Mehmet) Golaj.⁴³⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkak i vdekjes së Rexhë (Mehmet) Golajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas

⁴³² P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 10–12.

⁴³³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴³⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 29 (e mbyllur me vulë).

⁴³⁵ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 323–332.

⁴³⁶ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 176–177.

⁴³⁷ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 178–179.

⁴³⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴³⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 29 (e mbyllur me vulë).

këtyre, është gjetur një predhë “përgjatë buzës së djathtë të anës së pasme të vertebrës së njëmbëdhjetë gjoksore”.⁴⁴⁰ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Rexhë (Mehmet) Golajt kanë qenë “lëndimet në kokë, kraharor dhe këmbë, të shkaktuara me armë zjarri”.⁴⁴¹ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Rexhë (Mehmet) Golajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁴⁴²

(105) Skënder Hadërgjonaj (18-vjeçar, mashkull)

140. Dhoma vëren se, pas analizave të ADN-së, viktimës me emrin Skënder (Bajram) Hadërgjonaj i janë vendosur dy etiketa të ndryshme: “K2BA-196-K1-2” dhe “K2BA-191-K1-2”.⁴⁴³ Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁴⁴ Dhoma është e mendimit se nga vendosja e dy etiketave Skënder (Bajram) Hadërgjonajt nuk lind asnjë dyshim për faktin që ai u vra në Mejë më 27 prill 1999.

(106) Faik Hajredini (43-vjeçar, mashkull)

141. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁴⁵ Kufoma me etiketën “2Ba-190” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Faik (Sadik) Hajredini.⁴⁴⁶ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Faik (Sadik) Hajredinit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, brinjëve, vertebrave, kularthit të majtë dhe të eshtrës së krahut të djathtë, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.⁴⁴⁷ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Faik (Sadik) Hajredinit kanë qenë “goditjet me armë zjarri në kokë, kraharor dhe

⁴⁴⁰ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 94-97.

⁴⁴¹ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 75-76.

⁴⁴² P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 502.

⁴⁴³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 29 (e mbyllur me vulë).

⁴⁴⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁴⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁴⁶ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 29 (e mbyllur me vulë).

⁴⁴⁷ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1040-1044.

krahun e djathtë”.⁴⁴⁸ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Faik (Sadik) Hajredinin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁴⁴⁹

(107) Hysni Hajredini (35-vjeçar, mashkull)

142. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁵⁰ Kufoma me etiketën “2Ba-114” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Hysni (Ymer) Hajredini.⁴⁵¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Hysni (Ymer) Hajredinit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, brinjëve, shpatullës së djathtë dhe të majtë, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.⁴⁵² Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Hysni (Ymer) Hajredinit kanë qenë “plagët e shumëfishta me armë zjarri”.⁴⁵³

(108) Qamil Hajredini (34-vjeçar, mashkull)

143. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁵⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-158” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Qamil (Hazir) Hajredini.⁴⁵⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Qamil (Hazir) Hajredini, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁴⁵⁶ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Qamil (Hazir) Hajredinit kanë qenë

⁴⁴⁸ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 95–96.

⁴⁴⁹ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 540–541.

⁴⁵⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁵¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 29 (e mbyllur me vulë).

⁴⁵² P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 622–626.

⁴⁵³ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 183–185.

⁴⁵⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁵⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 2 (e mbyllur me vulë).

⁴⁵⁶ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 872–875.

“lëndimet në trung dhe kofshën e majtë, të shkaktuara me armë zjarri”.⁴⁵⁷ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Qamil (Hazir) Hajredinin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁴⁵⁸

(109) Elson Hasanaj (28-vjeçar, mashkull)

144. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁵⁹ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(110) Gjon Hasanaj (66-vjeçar, mashkull)

145. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁶⁰ Kufoma me etiketën “2Ba–206” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Gjon (Palush) Hasanaj.⁴⁶¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Gjon (Palush) Hasanajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të brinjëve, vertebrave, eshtrës së komblikut dhe femurit të majtë, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.⁴⁶² Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Gjon (Palush) Hasanajt është i papërcaktuar.⁴⁶³

(111) Luan Hasanaj (17-vjeçar, mashkull)

146. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁶⁴ Kufoma me etiketën “2Ba–170” është identifikuar përmes

⁴⁵⁷ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 93–94.

⁴⁵⁸ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 538–539.

⁴⁵⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁶⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁶¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 30 (e mbyllur me vulë).

⁴⁶² P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1121–1125.

⁴⁶³ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 329–331.

⁴⁶⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

analizave të ADN-së se është personi me emër Luan (Shyt) Hasanaj.⁴⁶⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Luan (Shyt) Hasanajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, “është gjetur një predhë në një të tretën e sipërme të krahut të sipërm të djathtë, domethënë në indin e butë të kësaj zone”.⁴⁶⁶ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Luan Hasanajt ka qenë “plagë të shumëfishta të kraharorit të shkaktuara me armë zjarri”.⁴⁶⁷

(112) Mitër Hasanaj (56-vjeçar, mashkull)

147. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁶⁸ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(113) Ndue Hasanaj (60-vjeçar, mashkull)

148. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁶⁹ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(114) Shyt Hasanaj (45-vjeçar, mashkull)

149. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁷⁰ Kufoma me etiketën “2Ba–221” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Shyt (Gjon) Hasanaj.⁴⁷¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Shyt (Gjon) Hasanajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej

⁴⁶⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 30 (e mbyllur me vulë).

⁴⁶⁶ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 928–933.

⁴⁶⁷ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 274–276.

⁴⁶⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁶⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁷⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁷¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 30 (e mbyllur me vulë).

në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të brinjëve dhe komblikut, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, ka pasur një dëmtim në ashtin çapokut në formë vrime, e cila “është shkaktuar nga një plumb dhe një kanal nga pjesa e pasme në pjesën e përparme”.⁴⁷² Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Shyt (Gjon) Hasanajt kanë qenë “goditjet me armë zjarri në nyjën e çapokut dhe në zgavrën e barkut”.⁴⁷³ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Shyt (Gjon) Hasanajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, ku thuhet se shkaku i vdekjes ka qenë “goditja me armë zjarri në pjesën e poshtme të barkut”.⁴⁷⁴

(115) Mentor Haxha (25-vjeçar, mashkull)

150. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁷⁵ Kufoma me etiketën “2Ba-211” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Mentor (Sadri) Haxhaj.⁴⁷⁶ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Mentor (Sadri) Haxhaj, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, ka pasur një kallo apo vrage në eshtrën e supit të djathtë.⁴⁷⁷ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Mentor (Sadri) Haxhës është “plaga në kraharor, e shkaktuar me armë zjarri”.⁴⁷⁸

(116) Afrim Haxhiu (36-vjeçar, mashkull)

151. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të

⁴⁷² P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1202–1206.

⁴⁷³ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 365–367.

⁴⁷⁴ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 575.

⁴⁷⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁷⁶ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 30 (e mbyllur me vulë).

⁴⁷⁷ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1147–1151.

⁴⁷⁸ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 340–343.

fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁷⁹ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(117) Avdi Haxhiu (23-vjeçar, mashkull)

152. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁸⁰ Kufoma me etiketën “2Ba-196” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Avdi (Jashar) Haxhija.⁴⁸¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Avdi (Jashar) Haxhijës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, vertebrave, dërrasës së kraharorit dhe krahëve, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, “është gjetur një predhë e pozicionuar diagonalisht, me majën e drejtuar teposhtë, në indin e butë të pjesës së pasme të trungut, menjëherë pranë vertebrave të tretë dhe katërt lumbare”.⁴⁸²

(118) Florim Haxhiu (33-vjeçar, mashkull)

153. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁸³ Kufoma me etiketën “2Ba-04” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Florim (Isuf) Haxhija.⁴⁸⁴ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Florim (Isuf) Haxhijës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.⁴⁸⁵ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Florim (Isuf) Haxhijës është “plaga në kokë, e shkaktuar me armë zjarri”.⁴⁸⁶ Kjo konfirmohet nga

⁴⁷⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁸⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁸¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 31 (e mbyllur me vulë).

⁴⁸² P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1066–1069.

⁴⁸³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁸⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës 004/2005-ER nga muaji shtator 2005 përgatitur nga KNPZH-ja), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 30.

⁴⁸⁵ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 44–48.

⁴⁸⁶ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 4–6.

aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Florim (Isuf) Haxhijën, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁴⁸⁷

(119) Tahir Haxhiu (49-vjeçar, mashkull)

154. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁴⁸⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-20” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Tahir (Alush) Haxhiu.⁴⁸⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Tahir (Alush) Haxhiut, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, frakturat e eshtrave të krahut të majtë dhe të shpatullës së majtë mund të jenë shkaktuar nga “një predhë e shkrepur nga armë zjarri dore”.⁴⁹⁰ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Tahir (Alush) Haxhiut ka qenë “plaga me armë zjarri në trung”.⁴⁹¹

(120) Ardian Hoxha (16-vjeçar, mashkull) dhe Blendian Hoxha (18-vjeçar, mashkull)

155. Dhoma vëren se dy etiketa të ndryshme (“2Ba-197” dhe “2Ba-149”) u janë vendosur viktimave me emra të ngjashëm: Ardian Hoxha dhe Blendian (Bajram) Hoxha.⁴⁹² Të dy viktimat janë përfshirë si persona të zhdukur në listën e ZPZHML-së për personat e zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se dy viktimat bënin pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit në Mejë më 27 prill 1999.⁴⁹³ Në bazë të dëshmisë së Jose Baraybar në lidhje me përgatitjen e listës së ZPZHML-së,⁴⁹⁴ si edhe në bazë të faktit që lista e ZPZHML-së identifikon “2Ba-149” si Ardian Hoxha dhe “2Ba-197” si Blendian (Bajram) Hoxha dhe që në listë thuhet se secili prej këtyre rasteve është

⁴⁸⁷ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 590.

⁴⁸⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁸⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 31 (e mbyllur me vulë).

⁴⁹⁰ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 132–137.

⁴⁹¹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 25–27.

⁴⁹² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 32 (e mbyllur me vulë).

⁴⁹³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁹⁴ Jose Baraybar, P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), f. 5–6.

mbyllur dhe kufoma i është kthyer familjeve,⁴⁹⁵ Dhoma është e bindur se ky grup kufomash është i viktimave të përcaktuara përkatësisht në listën e ZPZHML-së.

156. Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Blendian (Bajram) Hoxhës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.⁴⁹⁶ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Blendian (Bajram) Hoxhës ka qenë “lëndimi në kraharor, shkaktuar me armë zjarri”.⁴⁹⁷ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Blendian (Bajram) Hoxhën, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁴⁹⁸

157. Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Ardian Hoxhës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁴⁹⁹ Në certifikatën e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë konstatohet se shkaku i vdekjes së Ardian (Bajram) Hoxhës është i papërcaktuar.⁵⁰⁰ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Ardian Hoxhën, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁵⁰¹

(121) Bajram Hoxha (44-vjeçar, mashkull)

158. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁰² Kufoma me etiketën “2Ba-256” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Bajram (Zenun) Hoxha.⁵⁰³ Në aktautopsinë e

⁴⁹⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁴⁹⁶ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1070–1074.

⁴⁹⁷ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 58–59.

⁴⁹⁸ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 60.

⁴⁹⁹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 825–827.

⁵⁰⁰ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 43–44.

⁵⁰¹ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 45.

⁵⁰² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁰³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 32 (e mbyllur me vulë).

përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Bajram (Zenun) Hoxhës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimit pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁵⁰⁴ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Bajram (Zenun) Hoxhës kanë qenë “lëndimet në krahë, shkaktuar me armë zjarri”.⁵⁰⁵ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Bajram (Zenun) Hoxhën, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁵⁰⁶

(122) Blendian Hoxha (18-vjeçar, mashkull)

159. Shih analizën numër 120, më lart.

(123) Fadil Hoxha (39-vjeçar, mashkull)

160. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁰⁷ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(124) Fitim Hoxha (32-vjeçar, mashkull)

161. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁰⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-106” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Fitim (Sadik) Hoxha.⁵⁰⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Fitim (Sadik) Hoxhës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së

⁵⁰⁴ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1413–1417.

⁵⁰⁵ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 78–79.

⁵⁰⁶ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 80.

⁵⁰⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁰⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁰⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 32 (e mbyllur me vulë).

lartë.⁵¹⁰ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Fitim (Sadik) Hoxhës ka qenë “plaga në kokë, e shkaktuar me armë zjarri”.⁵¹¹ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Fitim (Sadik) Hoxhën, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁵¹²

(125) Hajrullah Hoxha (27-vjeçar, mashkull) dhe Naim Hoxha (25-vjeçar, mashkull)

162. Dhoma vëren se dy etiketa të ndryshme (“2BA-105” dhe “2BA-S-5”) u janë vendosur viktimave me emra të ngjashëm: Hajrullah Hoxha dhe Naim (Hysni) Hoxha.⁵¹³ Të dy viktimat janë përfshirë si persona të zhdukur në listën e ZPZHML-së për personat e zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktimat bënin pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit në Mejë më 27 prill 1999.⁵¹⁴ Lista e identifikon viktimën me numër “2BA-105” si Naim (Hysni) Hoxha; rrjedhimisht, viktimja me numër “2BA-S-5” duhet të jetë Hajrullah Hoxha.⁵¹⁵ Në bazë të dëshmisë së Jose Baraybar në lidhje me përgatitjen e listës së ZPZHML-së,⁵¹⁶ Dhoma bindet se dy kufomat janë të Hajrullah Hoxhës dhe Naim (Hysni) Hoxhës.

163. Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Naim (Hysni) Hoxhës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimit pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, “është gjetur një copëz predhe metalike në zonën e kufomat të vertebrave të katërt, pestë, gjashtë dhe shtatë të krahavorit, në anën e majtë”.⁵¹⁷ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Naim (Hysni) Hoxhës kanë qenë “plagët e shumëfishta në trung, komblik dhe kofshën e majtë, shkaktuar me armë zjarri”.⁵¹⁸ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike

⁵¹⁰ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 579–582.

⁵¹¹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 169–171.

⁵¹² P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 577.

⁵¹³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 32 (e mbyllur me vulë).

⁵¹⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵¹⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵¹⁶ Jose Baraybar, P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), f. 5–6.

⁵¹⁷ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 573–578.

⁵¹⁸ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 11–12.

përmbledhëse për Naim (Hysni) Hoxhën, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁵¹⁹

(126) Naim Hoxha (25-vjeçar, mashkull)

164. Shih analizën numër 125, më lart.

(127) Ramiz Hoxha (42-vjeçar, mashkull)

165. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵²⁰ Kufoma me etiketën “2Ba-74” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ramiz (Shaban) Hoxha.⁵²¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Ramiz (Shaban) Hoxhës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.⁵²² Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Ramiz (Shaban) Hoxhës kanë qenë “lëndimet në kokë dhe kraharor, të shkaktuara me armë zjarri”.⁵²³ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Ramiz (Shaban) Hoxhën, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁵²⁴

(128) Rifat Hoxha (33-vjeçar, mashkull)

166. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵²⁵ Kufoma me etiketën “2Ba-98” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Rifat (Ilaz) Hoxha.⁵²⁶ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Rifat (Ilaz) Hoxhës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të

⁵¹⁹ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 13–14.

⁵²⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵²¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 32 (e mbyllur me vulë).

⁵²² P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 420–424.

⁵²³ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 16–17.

⁵²⁴ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 18.

⁵²⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵²⁶ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 32 (e mbyllur me vulë).

avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.⁵²⁷ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Rifat (Ilaz) Hoxhës kanë qenë “goditjet me armë zjarri në kokë”.⁵²⁸ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Rifat (Ilaz) Hoxhën, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁵²⁹

(129) Gafurr Hykosmanaj (23-vjeçar, mashkull)

167. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵³⁰ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(130) Binak Hyseni (17-vjeçar, mashkull)

168. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵³¹ Kufoma me etiketën “2Ba-108” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Binak (Ramë) Hyseni.⁵³² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Binak (Ramë) Hysenit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, ka dëmtime të eshtrave të kafkës, të cilat “mund të jenë shkaktuar nga një predhë që ka depërtuar eshtrat, trajektorja e së cilës shkon nga e djathta në të majtë, nga pjesa e pasme paksa në pjesën e përparme, me kah nga poshtë”.⁵³³ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Binak (Ramë) Hysenit ka qenë “lëndimi në kokë, shkaktuar me armë zjarri”.⁵³⁴ Kjo konfirmohet nga

⁵²⁷ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 536–539.

⁵²⁸ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 156–158.

⁵²⁹ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 580.

⁵³⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵³¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵³² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 33 (e mbyllur me vulë).

⁵³³ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 587–591.

⁵³⁴ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 97–98.

aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Binak (Ramë) Hysenin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁵³⁵

(131) Ali Ibrahim (37-vjeçar, mashkull)

169. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵³⁶ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(132) Hysni Ibrahim (40-vjeçar, mashkull)

170. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵³⁷ Kufoma me etiketën “2Ba-117” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Isni (Qazim) Ibrahimaj.⁵³⁸ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Hysni (Qazim) Ibrahimit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, brinjëve, dërrasës së krahavorit, vertebrave, krahut të majtë dhe femurëve, si edhe fraktura të kafkës, trungut dhe gjymtyrëve, të shkaktuara nga goditje me mjete të forta, si edhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, janë gjetur copëza të vogla dhe të mëdha predhe “në indin e butë poshtë lëkurës, menjëherë në të majtë të vijës mediale, në nivelin e thikës së dërrasës së krahavorit”.⁵³⁹ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Isni (Qazim) Ibrahimajt kanë qenë “plagët të shumëfishta me armë zjarri”.⁵⁴⁰

(133) Masar Idrizi (21-vjeçar, mashkull)

171. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁴¹ Kufoma me etiketën “2Ba-104” është identifikuar përmes

⁵³⁵ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 515.

⁵³⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵³⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵³⁸ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 33 (e mbyllur me vulë).

⁵³⁹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 639–643.

⁵⁴⁰ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 189–192.

⁵⁴¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

analizave të ADN-së se është personi me emër Masar (Smajl) Idrizi.⁵⁴² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Masar (Smajl) Idrizit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁵⁴³ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Masar (Smajl) Idrizit ka qenë “goditja me armë zjarri në kofshën e majtë”.⁵⁴⁴ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Masar (Smajl) Idrizin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁵⁴⁵

(134) Demë Islamaj (63-vjeçar, mashkull)

172. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁴⁶ Kufoma me etiketën “2Ba-149” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Demë (Ali) Islamaj.⁵⁴⁷ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Demë (Ali) Islamajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, vertebrave dhe brinjëve, si dhe gjurmë të goditjes me teh jo të mprehtë të një mjete mekanik.⁵⁴⁸ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Demë (Ali) Islamajt ka qenë të paktën dy plagë të kraharorit të shkaktuara me armë zjarri.⁵⁴⁹

(135) Bajram Isufi (16-vjeçar, mashkull)

173. Dhoma vëren se dy etiketa të ndryshme (“2Ba-168” dhe “2Ba-226”) janë identifikuar përmes analizave të ADN-së se u përkasin viktimave me emër Lavdim, Kujtim, Isa ose Bajram (Bekë)

⁵⁴² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 33 (e mbyllur me vulë).

⁵⁴³ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 563–572.

⁵⁴⁴ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 25–26.

⁵⁴⁵ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 27.

⁵⁴⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁴⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 34 (e mbyllur me vulë).

⁵⁴⁸ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1376–1379.

⁵⁴⁹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 427–429.

Isufi.⁵⁵⁰ Bajram (Bekë) Isufi është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHK-së për personat e zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktimi bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁵¹ Aty, etiketa “2Ba-226” identifikohet si Bajram (Bekë) Isufi dhe rasti i tij regjistrohet si mbyllur kurse kufoma i është kthyer familjes.⁵⁵² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Lavdim/Kujtim/Isa/Bajram (Bekë) Isufit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të brinjëve, kularthit të djathtë, kërdhokullës së djathtë, ashtit të krahut të djathtë dhe fyellit të këmbës së djathtë, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.⁵⁵³

(136) Isa Isufi (19-vjeçar, mashkull)

174. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktimi bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁵⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-168” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Lavdim, Kujtim, Isa ose Bajram (Bekë) Isufit.⁵⁵⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Lavdim, Kujtim, Isa ose Bajram (Bekë) Isufi, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, është gjetur një predhë metalike “në indin e butë të parit të pasmë abdominal, dy centimetra në të majtë të pjesës anësore të vertebrës së dytë lumbale”.⁵⁵⁶ Lista e ZPZHML-së i identifikon “2Ba-226”, “CZ01-063B” dhe “CZ01-045B” përkatësisht si Bajram (Bekë) Isufi, Kujtim (Bekë) Isufi dhe Lavdim (Bekë) Isufi; për rrjedhojë, “2Ba-168” duhet të jetë Isa (Bekë) Isufi.⁵⁵⁷ Në bazë të dëshmisë së Jose Baraybar në lidhje me përgatitjen e listës së ZPZHML-së,⁵⁵⁸ Dhoma bindet se kufoma është e Isa (Bekë) Isufit.

⁵⁵⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 34 (e mbyllur me vulë).

⁵⁵¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁵² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁵³ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1226–1233.

⁵⁵⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁵⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 34 (e mbyllur me vulë).

⁵⁵⁶ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1226–1234.

⁵⁵⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁵⁸ Jose Baraybar, P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), f. 5–6.

(137) Andrush Kabashi (18-vjeçar, mashkull)

175. Lizane Malaj dëshmoi më 27 prill 1999 se burra të armatosur e rrethuan shtëpinë e saj dhe hynë në oborrin e saj. Ata i dhanë urdhër nipit të saj, Andrush Kabashit, dhe burrave të tjerë në shtëpi të shtrihen përdhe dhe u thanë grave të largoheshin. Kur Malaj dhe gratë e tjera ishin larguar rreth 50 metra nga shtëpia, kishin dëgjuar të shtëna të shumëfishta dhe ulërime dhe kur kishte vështruar mbrapa kishte parë se shtëpia e saj ishte në flakë. Malaj nuk e pa më kurrë të gjallë Andrush Kabashin.⁵⁵⁹

176. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁶⁰ Kufoma me etiketën “Ba05–235T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Andrush (Nikollë) Kabashi.⁵⁶¹

(138) Arben Kabashi (14-vjeçar, mashkull)

177. Lizane Malaj dëshmoi më 27 prill 1999 se burra të armatosur e rrethuan shtëpinë e saj dhe hynë në oborrin e saj. Ata i dhanë urdhër nipit të saj, Arben Kabashit, dhe burrave të tjerë në shtëpi të shtrihen përdhe dhe u thanë grave të largohen. Kur Malaj dhe gratë e tjera qenë rreth 50 metra larg shtëpisë, ajo dëgjoi të shtëna të shumëfishta dhe ulërime dhe kur vështroi mbrapa pa se shtëpia e saj ishte në flakë. Malaj nuk e pa më të gjallë Arben Kabashin dhe mësoi për vdekjen e tij më 17 dhjetor 2005.⁵⁶²

178. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁶³ Dhoma vëren se viktimës me emrin Arben (Sokol) Kabashi i janë vendosur dy etiketa të ndryshme: “Ba05–010DT” dhe “Ba05–006T”.⁵⁶⁴ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Arben (Sokol) Kabashit është i papërcaktuar.⁵⁶⁵ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Arben (Sokol) Kabashin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi

⁵⁵⁹ Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2000), f. 3–4. P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 5, T. 1311 (9 gusht 2006).

⁵⁶⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁶¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 35 (e mbyllur me vulë).

⁵⁶² Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2000), f. 3–4. P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 3, T. 1310–1311, 1314–1315 (9 gusht 2006).

⁵⁶³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁶⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 35 (e mbyllur me vulë).

⁵⁶⁵ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 37–38.

Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁵⁶⁶ Dhoma është e mendimit se vendosja e dy etiketave Arben (Sokol) Kabashit nuk vë në dyshim faktin se ai u vra në Mejë më 27 prill 1999.

(139) Nikoll Kabashi (32-vjeçar, mashkull)

179. Lizane Malaj dëshmoi më 27 prill 1999 se burra të armatosur e rrethuan shtëpinë e saj dhe hynë në oborrin e saj. Ata i dhanë urdhër vëllait të saj, Nikoll Kabashit, dhe burrave të tjerë në shtëpi të shtrihen përdhe dhe u thanë grave të largohen. Kur Malaj dhe gratë e tjera qenë rreth 50 metra larg shtëpisë, ajo dëgjoi të shtëna të shumëfishta dhe ulërime dhe kur vështroi mbrapa pa se shtëpia e saj ishte në flakë. Malaj nuk e pa më asnjëherë të gjallë Nikoll Kabashin dhe e mori kufomën e tij më 27 prill 2005. Ajo deklaroi se i kishin thënë se kufoma ishte gjetur “në varrezën e Batajnicës”.⁵⁶⁷

180. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁶⁸ Kufoma me etiketën “Ba05–109T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Nikoll (Zefë) Kabashi.⁵⁶⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Nikoll (Zefë) Kabashit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma është në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të eshtrave, si dhe gjurmë të ekspozimit ndaj zjarrit.⁵⁷⁰

(140) Pjetër Kacoli (23-vjeçar, mashkull)

181. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁷¹ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(141) Tom Kacoli (23-vjeçar, mashkull)

182. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të

⁵⁶⁶ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 39.

⁵⁶⁷ Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2000), f. 3–4. P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 3, T. 1310–1311, 1314–1315 (9 gusht 2006).

⁵⁶⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁶⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 35 (e mbyllur me vulë).

⁵⁷⁰ P2416 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 18–24.

⁵⁷¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁷² Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(142) Besim Kameri (29-vjeçar, mashkull)

183. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁷³ Kufoma me etiketën “Ba05–277T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Besim (Bajram) Kamerit.⁵⁷⁴

(143) Gëzim Kameri (29-vjeçar, mashkull)

184. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁷⁵ Kufoma me etiketën “2Ba-195” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Gëzim (Halim) Kameri.⁵⁷⁶ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Gëzim (Halim) Kamerit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se mungojnë këmbët, ka fraktura të shumëfishta të kufomat, si dhe gjurmë goditjeje me mjete të forta.⁵⁷⁷

(144) Muharrem Kameri (36-vjeçar, mashkull)

185. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁷⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-234” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Muharrem (Malë) Kamberi.⁵⁷⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Muharrem (Malë) Kamberit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi

⁵⁷² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁷³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁷⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 36 (e mbyllur me vulë).

⁵⁷⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁷⁶ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 36 (e mbyllur me vulë).

⁵⁷⁷ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1062–1065.

⁵⁷⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁷⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 35 (e mbyllur me vulë).

theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, në aktautopsi theksohet ekzistenca e një kanali përmes eshtrave kafkore dhe se kjo “ka shumë të ngjarë të jetë krijuar nga kalimi i predhës nëpër kafkë”.⁵⁸⁰ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Muharrem (Malë) Kamberit ka qenë “lëndime në kokë dhe kraharor, shkaktuar me armë zjarri”.⁵⁸¹ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Muharrem (Malë) Kamberin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁵⁸²

(145) Rrustem Kameri (41-vjeçar, mashkull)

186. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁸³ Kufoma me etiketën “2Ba-207” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Rrustem (Sadri) Kameri.⁵⁸⁴ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Rrustem (Sadri) Kamerit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të qafës, vertebrave, shputave të këmbëve dhe shpatullës së majtë, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.⁵⁸⁵ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Rrustem (Sadri) Kamerit është i papërcaktuar.⁵⁸⁶

(146) Shpend Kameri (49-vjeçar, mashkull)

187. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁸⁷ Kufoma me etiketën “2Ba-130” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Shpend (Malë) Kameri.⁵⁸⁸ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i

⁵⁸⁰ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1283–1285.

⁵⁸¹ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 3–4.

⁵⁸² P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 522–523.

⁵⁸³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁸⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 36 (e mbyllur me vulë).

⁵⁸⁵ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1126–1129.

⁵⁸⁶ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 332–334.

⁵⁸⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

vdekjes së Shpend (Malë) Kamerit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, një predhë ishte “e pranishme në pllakën e brendshme të eshtrave të thyera të kafkës” dhe se kjo linte të kuptoje se viktima është qëlluar me armë zjarri në zonën e kokës.⁵⁸⁹

(147) Nikollë Komani (26-vjeçar, mashkull)

188. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁹⁰ Kufoma me etiketën “2Ba-01” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Nikollë (Gjokë) Komani.⁵⁹¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Nikollë (Gjokë) Komani, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kafkës, eshtrave të komblikut dhe një dëmtim të shpatullës së majtë. Frakturat e kafkës dhe të eshtrave të komblikut janë shkaktuar nga goditje me mjete të forta. Krahas këtyre, defekti i shpatullës së majtë është shkaktuar nga “një predhë që ka kaluar tejpertej ashtit”.⁵⁹² Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Nikollë (Gjokë) Komani kanë qenë “lëndimet në kokë dhe kraharor, të shkaktuara me armë zjarri”.⁵⁹³ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Nikollë (Gjokë) Komani, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁵⁹⁴

(148) Fran Komani (28-vjeçar, mashkull)

189. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁵⁹⁵ Kufoma me etiketën “2Ba-134” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Fran (Prenk) Komani.⁵⁹⁶ Në aktautopsinë e përpiluar

⁵⁸⁸ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 36 (e mbyllur me vulë).

⁵⁸⁹ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 715–723.

⁵⁹⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁹¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 36 (e mbyllur me vulë).

⁵⁹² P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 28–32.

⁵⁹³ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 241–242.

⁵⁹⁴ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 243–244.

⁵⁹⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁵⁹⁶ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 36 (e mbyllur me vulë).

nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Fran (Prenk) Komanit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, këqyrja “ka zbuluar dëmtime në eshtrat e kafkës, të cilat ka shumë të ngjarë të jenë shkaktuar nga kalimi i predhës nëpër eshtra, dhe një dëmtim të dorës së djathtë që mund të jetë shkaktuar nga kalimi i predhës nëpër indin e kësaj pjese”.⁵⁹⁷ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Fran (Prenk) Komanit është i papërcaktuar.⁵⁹⁸ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Fran (Prenk) Komanin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁵⁹⁹

(149) Pashk Komani (33-vjeçar, mashkull)

190. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁰⁰ Kufoma me etiketën “2Ba-93” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Pashk (Prenk) Komani.⁶⁰¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Pashk (Prenk) Komanit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁶⁰² Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Pashk (Prenk) Komanit ka qenë “goditja me armë zjarri në kraharor”.⁶⁰³ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Pashk (Prenk) Komanin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁶⁰⁴

(150) Mikel Kqira (37-vjeçar, mashkull)

⁵⁹⁷ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 742–747.

⁵⁹⁸ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40–41.

⁵⁹⁹ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 42.

⁶⁰⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁰¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 36 (e mbyllur me vulë).

⁶⁰² P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: Autopsi: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 507–512.

⁶⁰³ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 8–9.

⁶⁰⁴ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 10.

191. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁰⁵ Kufoma me etiketën “Ba05–119T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Mikel (Ndue) Kqira.⁶⁰⁶ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Mikel (Ndue) Kqirës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma është në fazë të avancuar të ndryshimit pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si edhe ekspozim ndaj zjarrit.⁶⁰⁷ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Mikel (Ndue) Kqirës kanë qenë “lëndimet i shumëfishta, të shkaktuara me armë zjarri”.⁶⁰⁸ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Mikel (Ndue) Kqirën, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁶⁰⁹

(151) Pashk Kqira (40-vjeçar, mashkull)

192. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶¹⁰ Kufoma me etiketën “Ba05–09T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Pashkë (Dedë) Kqira.⁶¹¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Pashk (Dedë) Kqirës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma është në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si edhe ekspozim ndaj zjarrit.⁶¹² Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Pashk (Dedë) Kqirës kanë qenë “lëndimet e kokës të shkaktuara me armë zjarri”.⁶¹³ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Pashk (Dedë) Kqirën, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur

⁶⁰⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁰⁶ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 37 (e mbyllur me vulë).

⁶⁰⁷ P2414 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 8–15.

⁶⁰⁸ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 271–272.

⁶⁰⁹ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 273.

⁶¹⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶¹¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 37 (e mbyllur me vulë).

⁶¹² P2415 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1–9.

⁶¹³ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 229–230.

dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, ku thuhet se shkak i vdekjes ka qenë “lëndim i kokës me armë zjarri”.⁶¹⁴

(152) Luz Kqiraj (39-vjeçar, mashkull)

193. Dhoma vëren se viktimës me emrin Luz (Mark) Kqira i janë vendosur dy etiketa të ndryshme: “Ba05–273DT” dhe “Ba05–239T”.⁶¹⁵ Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶¹⁶ Aty, viktima “Ba05–239T” identifikohet si Luz (Mark) Kqira dhe theksohet se rasti i tij është i mbyllur dhe se kufoma i është kthyer familjes.⁶¹⁷ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkak i vdekjes së “Ba05-239T”, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma është fazë të avancuar të transformimit pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të eshtrave, si dhe gjurmë të ekspozimit ndaj zjarrit.⁶¹⁸ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkak i vdekjes së Luz (Mark) Kqirës kanë qenë “lëndimet e kokës të shkaktuara me armë zjarri”.⁶¹⁹ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për “Ba05–273DT” dhe “Ba05-239T”, lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁶²⁰ Dhoma është e mendimit se vendosja e dy etiketave në kufomën e Luz (Mark) Kqirës nuk vë në dyshim faktin se ai u vra në Mejë më 27 prill 1999.

(153) Albert Krasniqi (19-vjeçar, mashkull)

194. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶²¹ Kufoma me etiketën “2Ba-129” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Albert (Ndrec) Krasniqi.⁶²² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkak i vdekjes së Albert (Ndrec) Krasniqit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet

⁶¹⁴ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 231.

⁶¹⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 37 (e mbyllur me vulë).

⁶¹⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶¹⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶¹⁸ P2416 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 25–33.

⁶¹⁹ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 306–307.

⁶²⁰ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 308–309.

⁶²¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶²² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 37 (e mbyllur me vulë).

se ka fraktura të shumëfishta të kokës dhe krahëve, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.⁶²³ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes i Albert (Ndrec) Krasniqit “ka mundësi të jetë plaga me armë zjarri në kokë”.⁶²⁴

(154) Lazër Krasniqi (39-vjeçar, mashkull) dhe Pjetër Krasniqi (33-vjeçar, mashkull)

195. Kufoma me etiketën “2Ba-171” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Pjetër ose Lazër (Dedë) Krasniqi.⁶²⁵ Të dy viktimat janë përfshirë si persona të zhdukur në listën e ZPZHML-së për personat e zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktimat bënë pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit në Mejë më 27 prill 1999. Lista i identifikon kufomën “2Ba-171” si Pjetër (Dedë) Krasniqi dhe rasti i tij regjistrohet si i mbyllur dhe se kufoma i është kthyer familjes.⁶²⁶

196. Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Pjetër (Dedë) Krasniqit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, është gjetur një dëmtim në ashtin kafkor, e cili “ka shumë të ngjarë të jetë vendi i depërtimit të predhës që ka kaluar tejprtej kokës”.⁶²⁷ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Pjetër (Dedë) Krasniqit kanë qenë “plagët në kokë të shkaktuara me armë zjarri”.⁶²⁸

197. Rrjedhimisht, Dhoma është e mendimit se në lidhje me Lazër (Dedë) Krasniqin nuk ka prova mjeko-ligjore për të vërtetuar se si ka vdekur apo nëse faktikisht ka vdekur.

(155) Mark Krasniqi (24-vjeçar, mashkull)

198. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶²⁹ Kufoma me etiketën “2Ba-224” është identifikuar përmes

⁶²³ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 710–714.

⁶²⁴ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 213–215.

⁶²⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 37 (e mbyllur me vulë).

⁶²⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶²⁷ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 934–938.

⁶²⁸ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 277–279.

⁶²⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

analizave të ADN-së se është personi me emër Marko (Hil) Krasniqi.⁶³⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Marko (Hil) Krasniqit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, është gjetur një predhë në indin e trurit, e cila ndodhej “në nivelin e njëjës së eshtrave të djathta ballore dhe anësore, dhe frakturat e eshtrave kafkore mund të jenë shkaktuar nga goditja e predhës”.⁶³¹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes i Marko (Hil) Krasniqit ka qenë “lëndimi i kokës me predhë”.⁶³²

(156) Ndue Krasniqi (33-vjeçar, mashkull)

199. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶³³ Kufoma me etiketën “2Ba-241” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ndue (Bibë) Krasniqi.⁶³⁴ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Ndue (Bibë) Krasniqit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, në aktautopsi theksohet se është gjetur një predhë “në vijën e mesme kularthit në anën e djathtë, në nivelin e brinjës së tretë”.⁶³⁵ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Ndue (Bibë) Krasniqit kanë qenë “plagët e shumëfishta me armë zjarri”.⁶³⁶

(157) Pjetër Krasniqi (33-vjeçar, mashkull)

200. Shih analizën numër 154, më lart.

⁶³⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 37 (e mbyllur me vulë).

⁶³¹ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1216-1219.

⁶³² P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 371-373.

⁶³³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶³⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 37 (e mbyllur me vulë).

⁶³⁵ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1331-1335.

⁶³⁶ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 388-392.

(158) Hasan Kuqi (37-vjeçar, mashkull)

201. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶³⁷ Kufoma me etiketën “2Ba-110” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Hasan (Ibrahim) Kuqi.⁶³⁸ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Hasan (Ibrahim) Kuqit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁶³⁹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Hasan (Ibrahim) Kuqit kanë qenë “plagët në komblik të shkaktuara me armë zjarri”.⁶⁴⁰

(159) Shpend Kuqi (19-vjeçar, mashkull)

202. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁴¹ Kufoma me etiketën “2Ba-52” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Shpend (Avdyl) Kuqi.⁶⁴² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Shpend (Avdyl) Kuqit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁶⁴³ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Shpend (Avdyl) Kuqit ka qenë “lëndimi në kraharor, i shkaktuar me armë zjarri”.⁶⁴⁴ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Shpend (Avdyl) Kuqin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁶⁴⁵

⁶³⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶³⁸ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 38 (e mbyllur me vulë).

⁶³⁹ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 597–600.

⁶⁴⁰ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 180–182.

⁶⁴¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁴² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 38 (e mbyllur me vulë).

⁶⁴³ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 304–306.

⁶⁴⁴ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 10–11.

⁶⁴⁵ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 12.

(160) Ilmi Kurpali (19-vjeçar, mashkull)

203. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë thuhet se viktima është parë për herë të fundit në Mejë më 26 mars 1999.⁶⁴⁶ Kufoma me etiketën “2Ba-96” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Elmi (Rexhep) Kurpali.⁶⁴⁷ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Elmi (Rexhep) Kurpalit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, është gjetur një predhë “në indin e butë afër brinjës së dhjetë mbi vijën mesoshpatullore mbi anën e pasme të djathtë të krahavorit”.⁶⁴⁸ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Elmi (Rexhep) Kurpalit ka qenë “plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri”.⁶⁴⁹ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Elmi (Rexhepin) Kurpalin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁶⁵⁰

(161) Haki Kurtaj (19-vjeçar, mashkull)

204. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁵¹ Kufoma me etiketën “2Ba-51” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Haki (Muhamet) Kurtaj.⁶⁵² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Haki (Muhamet) Kurtajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, frakturat e vertebrës së dhjetë dhe vertebrës së njëmbëdhjetë në zonën e krahavorit “tregojnë se mund jenë shkaktuar nga predha”.⁶⁵³ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i

⁶⁴⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁴⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 38 (e mbyllur me vulë).

⁶⁴⁸ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 527–531.

⁶⁴⁹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 150–152.

⁶⁵⁰ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 583.

⁶⁵¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁵² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 38 (e mbyllur me vulë).

⁶⁵³ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 300–303.

vdekjes së Haki (Muhamet) Kurtajt ka qenë “goditja me armë zjarri në kraharor”.⁶⁵⁴ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Haki (Muhamet) Kurtajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁶⁵⁵

(162) Isa Kurtaj (30-vjeçar, mashkull)

205. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁵⁶ Kufoma me etiketën “2Ba-184” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Isa (Osman) Kurtaj.⁶⁵⁷ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Isa (Osman) Kurtajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, “është gjetur një predhë metalike në indin e butë të gjysmës së djathtë të qafës, në nivelin e vertebrës së gjashtë të shtypur të qafës”.⁶⁵⁸ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Isa (Osman) Kurtajt kanë qenë “plagët e shumëfishta të kraharorit dhe barkut të poshtëm të shkaktuara me armë zjarri”.⁶⁵⁹ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Isa (Osman) Kurtajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁶⁶⁰

(163) Muhamet Kurtaj (45-vjeçar, mashkull)

206. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁶¹ Kufoma me etiketën “2Ba-S-7” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Muhamet (Osman) Kurtaj.⁶⁶²

(164) Sami Kurtaj (29-vjeçar, mashkull)

⁶⁵⁴ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 7–8.

⁶⁵⁵ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 9.

⁶⁵⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁵⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 38 (e mbyllur me vulë).

⁶⁵⁸ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1005–1009.

⁶⁵⁹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 300–303.

⁶⁶⁰ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 568.

⁶⁶¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁶² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 38 (e mbyllur me vulë).

207. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁶³ Kufoma me etiketën “2Ba-76” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Sami (Qazim) Kurtaj.⁶⁶⁴ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Sami (Qazim) Kurtajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁶⁶⁵ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Sami (Qazim) Kurtajt kanë qenë “ ndoshta plagët e krahut të djathtë dhe kofshës së djathtë, të shkaktuara me armë zjarri”.⁶⁶⁶ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Sami (Qazim) Kurtajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁶⁶⁷

(165) Anton Lleshi (25-vjeçar, mashkull)

208. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁶⁸ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(166) Kllaudie Mala (15-vjeçare, femër)

209. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁶⁹ Kufoma me etiketën “Ba05-263T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Klaudia (Kolë) Mala.⁶⁷⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Klaudia (Kolë) Malës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma është në

⁶⁶³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁶⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 38 (e mbyllur me vulë).

⁶⁶⁵ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 428-431.

⁶⁶⁶ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 5-6.

⁶⁶⁷ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 7.

⁶⁶⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁶⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁷⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 39 (e mbyllur me vulë).

fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të eshtrave, si edhe ekspozim ndaj zjarrit.⁶⁷¹

(167) Kol Mala (44-vjeçar, mashkull)

210. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁷² Kufoma me etiketën “Ba05–261T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Kolë (Nikollë) Mala.⁶⁷³ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Kolë (Nikollë) Malës, ndërsa theksohet se pjesa e poshtme e këmbës së djathtë është “në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të eshtrave, si dhe gjurmë të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.⁶⁷⁴

(168) Monika Mala (66-vjeçare, femër)

211. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁷⁵ Kufoma me etiketën “Ba05–310T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Monika (Zef) Mala.⁶⁷⁶ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Monika (Zef) Malës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma është në fazë të avancuar të ndryshimit pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të ekspozimit ndaj zjarrit.⁶⁷⁷ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Monika (Zef) Malës është i papërcaktuar.⁶⁷⁸

(169) Blerim Malaj (15-vjeçar, mashkull)

212. Lizane Malaj dëshmoi më 27 prill 1999 se burra të armatosur e rrethuan shtëpinë e saj dhe hynë në oborrin e saj. Ata e urdhëruar djalin e Malajve, Blerim Malaj, dhe burrat e tjerë në shtëpi të

⁶⁷¹ P2416 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 80–90.

⁶⁷² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁷³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 39 (e mbyllur me vulë).

⁶⁷⁴ P2416 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 74–79.

⁶⁷⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁷⁶ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 39 (e mbyllur me vulë).

⁶⁷⁷ P2602 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 16–23.

⁶⁷⁸ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 511–513.

bien përdhe dhe u thanë grave të largohen. Kur ajo dhe gratë e tjera ishin rreth 50 metra larg shtëpisë, ajo dëgjoji shumë të shtëna të vinin nga drejtimi i shtëpisë dhe dëgjoji Blerimin duke bërtitur, dhe kur ktheu kokën pas pa shtëpinë e saj mes flakëve.⁶⁷⁹ Malaj dëshmoi se, më vonë, ajo e mori kufomën e Blerim Malajt më 27 prill 2005 dhe deklaroi se i thanë se kufoma ishte gjetur në “varrezën e Batajnicës”.⁶⁸⁰

213. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁸¹ Kufoma me etiketën “Ba05-77T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Blerim (Vatë) Malaj.⁶⁸² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Blerim (Vatë) Malajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma është në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si edhe ekspozim ndaj zjarrit.⁶⁸³ Në aktekspertizën antropologjike përmbledhëse për Blerim (Vatë) Malajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, përcaktohet se shkaku i vdekjes është “lëndim me armë zjarri në kokë”.⁶⁸⁴

(170) Vat Malaj (37-vjeçar, mashkull)

214. Lizane Malaj dëshmoi më 27 prill 1999 se burra të armatosur e rrethuan shtëpinë e saj dhe hynë në oborrin e saj. Ata e urdhëruan të shoqin e Malajt, Vat Malaj, dhe burrat e tjerë në shtëpi të shtrihen përdhe dhe u thanë grave të largohen. Kur ajo dhe gratë e tjera ishin rreth 50 metra larg shtëpisë, ajo dëgjoji shumë të shtëna të vinin nga drejtimi i shtëpisë, dhe kur ktheu kokën pas pa shtëpinë e saj mes flakëve. Malaj dëshmoi se nuk e pa më kurrë të shoqin dhe mësoi për vdekjen e tij më 17 prill 2004.⁶⁸⁵

215. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të

⁶⁷⁹ Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2000), f. 3–4. P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 3, T. 1310–1311, (9 gusht 2006).

⁶⁸⁰ Lizane Malaj, T. 1314–1315 (9 gusht 2006).

⁶⁸¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁸² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 39 (e mbyllur me vulë).

⁶⁸³ P2415 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 75–83.

⁶⁸⁴ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 452.

⁶⁸⁵ Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2000), f. 3–4. P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 3, T. 1310–1311, 1314 (9 gusht 2006).

fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁸⁶ Kufoma me etiketën “Ba05–73T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Vatë (Mark) Malaj.⁶⁸⁷ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Vatë (Mark) Malajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma është në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të ekspozimit ndaj zjarrit.⁶⁸⁸ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Vat (Mark) Malajt ka qenë “goditja me armë zjarri në kokë”.⁶⁸⁹ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Vat (Mark) Malajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁶⁹⁰

(171) Vilson Malaj (29-vjeçar, mashkull)

216. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁹¹ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(172) Blerim Maloku (40-vjeçar, mashkull)

217. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁹² Kufoma me etiketën “2Ba-69” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Blerim (Asllan) Maloku.⁶⁹³ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Blerim (Asllan) Malokut, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁶⁹⁴ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Blerim (Asllan) Malokut ka qenë

⁶⁸⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁸⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 39 (e mbyllur me vulë).

⁶⁸⁸ P2415 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 59–66.

⁶⁸⁹ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 21–22.

⁶⁹⁰ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 416.

⁶⁹¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁹² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁹³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 39 (e mbyllur me vulë).

⁶⁹⁴ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 395–398.

“goditja me armë zjarri në kraharor”.⁶⁹⁵ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Blerim (Asllan) Malokun, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁶⁹⁶

(173) Burim Maloku (17-vjeçar, mashkull)

218. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁶⁹⁷ Kufoma me etiketën “2Ba-217” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Burim (Ibrahim) Maloku.⁶⁹⁸ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Burim (Ibrahim) Malokut, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.⁶⁹⁹ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet gjithashtu se shkaku i vdekjes së Burim (Ibrahim) Malokut është i papërcaktuar.⁷⁰⁰

(174) Petrit Maloku (22-vjeçar, mashkull)

219. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁰¹ Kufoma me etiketën “2Ba-115” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Petrit (Hajdar) Maloku.⁷⁰² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Petrit (Hajdar) Malokut, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁷⁰³ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Petrit (Hajdar) Malokut është i

⁶⁹⁵ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 45–46.

⁶⁹⁶ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 506.

⁶⁹⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁶⁹⁸ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40 (e mbyllur me vulë).

⁶⁹⁹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1178–1181.

⁷⁰⁰ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 354–357.

⁷⁰¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁰² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40 (e mbyllur me vulë).

⁷⁰³ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 627–631.

papërcaktuar.⁷⁰⁴ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Petrit (Hajdar) Malokun, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁷⁰⁵

(175) Ymer Maloku (39-vjeçar, mashkull)

220. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁰⁶ Kufoma me etiketën “2Ba-81” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ymer (Hazer) Maloku.⁷⁰⁷ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit i Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Ymer (Hazer) Malokut, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁷⁰⁸ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet gjithashtu se shkaku i vdekjes së Ymer (Hazer) Malokut është i papërcaktuar.⁷⁰⁹

(176) Besim Malushaj (32-vjeçar, mashkull)

221. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷¹⁰ Kufoma me etiketën “2Ba-137” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Besim (Muhamet) Malushaj.⁷¹¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit i Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Besim (Muhamet) Malushajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të eshtrave nga goditje me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁷¹² Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet gjithashtu se shkaku i vdekjes së Besim (Muhamet)

⁷⁰⁴ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 186–188.

⁷⁰⁵ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 584.

⁷⁰⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁰⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40 (e mbyllur me vulë).

⁷⁰⁸ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 450–454.

⁷⁰⁹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 123–125.

⁷¹⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷¹¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40 (e mbyllur me vulë).

⁷¹² P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 766–769.

Malushajt është i papërcaktuar.⁷¹³ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Besim (Muhamet) Malushajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁷¹⁴

(177) Esad Malushaj (29-vjeçar, mashkull)

222. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷¹⁵ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(178) Shefki Malushaj (38-vjeçar, mashkull)

223. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷¹⁶ Kufoma me etiketën “2Ba-145” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Shefki (Mustafë) Malushaj.⁷¹⁷ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Shefki (Mustafë) Malushajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, është gjetur një predhë metalike në “masën sfungjerore kockore të gjysmëperimetrit të djathtë të vertebrës së katërt të pjesës së kraharorit” dhe është gjetur një dëmtim “në shpatullën e djathtë që mund të jetë shkaktuar nga kalimi i predhës tejprtej ashtit”.⁷¹⁸ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Shefki (Mustafë) Malushajt ka qenë “goditja me armë zjarri në kraharor”.⁷¹⁹ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Shefki (Mustafë) Malushajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁷²⁰

(179) Bekim Markaj (23-vjeçar, mashkull)

⁷¹³ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 43–44.

⁷¹⁴ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 513.

⁷¹⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷¹⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷¹⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 44 (e mbyllur me vulë).

⁷¹⁸ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 801–807.

⁷¹⁹ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 19–20.

⁷²⁰ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 21.

224. Merita Deda ka dëshmuar se më 27 prill 1999 Bekim Markajn e kanë detyruar të futej në resht në oborrin e shtëpisë së Prend Markajt, së bashku me anëtarët e tjerë meshkuj të familjes së saj. Kur Deda po largohej nga shtëpia, ajo dëgjoi të shtëna armësh dhe, kur ajo u kthye, i pa burrat të shtrirë në tokë. Nuk e dinte nëse kishin vdekur apo jo, por ajo nuk e pa më kurrë Bekim Markajn të gjallë.⁷²¹

225. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷²² Kufoma me etiketën “Ba05–260T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Bekim (Mark) Markaj.⁷²³ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Bekim (Mark) Markajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “mbetjet kockore ndodhen në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të ekspozimit ndaj zjarrit. Krahas këtyre, “në indin e butë të zonës së ijës së djathtë është gjetur predha e një arme dore”.⁷²⁴ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Bekim (Mark) Markajt kanë qenë “lëndimet në kraharor dhe kofshën e djathtë, të shkaktuara me armë zjarri”.⁷²⁵ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Bekim (Mark) Markajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁷²⁶

(180) Mark Markaj (65-vjeçar, mashkull)

226. Merita Deda ka dëshmuar se më 27 prill 1999 Mark Markajn e kanë detyruar të futej në resht në oborrin e shtëpisë së Prend Markajt, së bashku me anëtarët e tjerë meshkuj të familjes së saj. Kur po largohej nga mjediset, Deda dëgjoi të shtëna armësh dhe, kur u kthye, i pa burrat të shtrirë në tokë. Nuk e dinte nëse kishin vdekur apo jo, por ajo nuk e pa më kurrë Mark Markajn të gjallë.⁷²⁷

227. Dhoma vëren se viktimës me emrin Mark (Zef) Markaj i janë vendosur dy etiketa të ndryshme: “Ba05–280DT” dhe “Ba05–247T”.⁷²⁸ Viktima është përfshirë si person i zhdukur në

⁷²¹ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 3.

⁷²² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷²³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40 (e mbyllur me vulë).

⁷²⁴ P2416 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 64–73.

⁷²⁵ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 37–38.

⁷²⁶ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 413.

⁷²⁷ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 3.

⁷²⁸ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40 (e mbyllur me vulë).

listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktimi bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit në Mejë më 27 prill 1999. Lista i identifikon të dyja etiketat si Mark (Zef) Markaj dhe në të thuhet se rasti i tij është mbyllur dhe se kufoma i është kthyer familjes.⁷²⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Mark (Zef) Markajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma është në fazë të avancuar të ndryshimit pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.⁷³⁰ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet gjithashtu se shkaku i vdekjes së Mark (Zef) Markajt është i papërcaktuar.⁷³¹ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmblendhëse për “Ba05–280DT” dhe “Ba05-247T”, lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁷³² Dhoma është e mendimit se shënimi i Mark (Zef) Markajt me dy etiketa nuk vë në dyshim faktin se ai u vra në Mejë më 27 prill 1999.

(181) Dedë Markaj (36-vjeçar, mashkull)

228. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktimi bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷³³ Kufoma me etiketën “2Ba-245” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Dedë (Zefë) Markaj.⁷³⁴ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Dedë (Zefë) Markajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të brinjëve të shkaktuara nga goditja me mjete të forta. Krahas këtyre, janë gjetur plagë plumbi në zonën e shpatullës së majtë, kafazit të kraharorit dhe në “anën e majtë të pjesës së pasme të zonës midis kraharorit dhe mesit”.⁷³⁵ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Dedë (Zef) Markajt kanë qenë “plagët në kraharor dhe kokë të shkaktuara me armë zjarri”.⁷³⁶

⁷²⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷³⁰ P2416 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 43–49.

⁷³¹ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 41–42.

⁷³² P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 484.

⁷³³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷³⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40 (e mbyllur me vulë).

⁷³⁵ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1353–1358.

⁷³⁶ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 402–404.

(182) Gëzim Markaj (21-vjeçar, mashkull)

229. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷³⁷ Kufoma me etiketën “Ba05-35T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Gëzim (Sokol) Marku.⁷³⁸ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Gëzim (Sokol) Markut, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma është në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të ekspozimit ndaj zjarrit. Krahas këtyre, është edhe një dëmtim i ashtit në zonën e zgavrës së kafkës, që është “hyrja e një plage depërtuese në kafkë e shkaktuar nga predha e shkrepur nga armë zjarri dore”.⁷³⁹

(183) Gjovalin Markaj (36-vjeçar, mashkull)

230. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁴⁰ Kufoma me etiketën “2Ba-242” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Xhevalin (Dedë) Markaj.⁷⁴¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Xhevalin (Dedë) Markajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, është gjetur një predhë metalike “në vijën e mesme kularthit në anën e djathtë, në nivelin e brinjës së tretë”.⁷⁴² Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Xhevalin (Dedë) Markajt ka qenë “plagët e mundshme në kokë të shkaktuara me armë zjarri”.⁷⁴³

(184) Mark Markaj (65-vjeçar, mashkull)

⁷³⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷³⁸ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 41 (e mbyllur me vulë).

⁷³⁹ P2415 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 34–44.

⁷⁴⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁴¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40 (e mbyllur me vulë).

⁷⁴² P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1336–1339.

⁷⁴³ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 393–395.

231. Edhe pse në Aktakuzë emri Mark Markaj përfshihet dy herë, vetëm një Mark Markaj është përfshirë në listën e personave të zhdukur e ZPZHML-së dhe kufomat e gjetura në varret e përbashkëta të Batajnicës i janë bashkëlidhur një personi me emrin Mark Markaj, siç trajtohet në analizën numër 180, më lart.⁷⁴⁴ Për më tepër, të dy emrat në Aktakuzë renditen me saktësisht të njëjtën moshë, ndërsa njëri prej tyre nuk ndjek rendin alfabetik. Rrjedhimisht, Dhoma është e mendimit se renditja e dyfishtë e emrit Mark Markaj në Aktakuzë duhet të jetë bërë gabimisht.

(185) Milan Markaj (35-vjeçar, mashkull)

232. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁴⁵ Kufoma me etiketën “2Ba-212” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Milan (Dedë) Markaj.⁷⁴⁶ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Milan (Dedë) Markajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kafkës, vertebrae, brinjëve, kërcirit të këmbës dhe krahut të djathtë, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, është gjetur një predhë metalike “në indin e butë që i përket bazës së lobit të djathtë temporal të trurit”.⁷⁴⁷ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Milan (Dedë) Markajt kanë qenë “plagët në kokë dhe vertebra të krahavorit të shkaktuara me armë zjarri”.⁷⁴⁸

(186) Pashk Markaj (38-vjeçar, mashkull)

233. Merita Deda ka dëshmuar se më 27 prill 1999 Pashuk Markajn e kanë detyruar të futej në rresht në oborrin e shtëpisë së Prend Markajt, së bashku me anëtarët e tjerë meshkuj të familjes së saj. Kur po largohej nga mjediset, Deda dëgjoi të shtëna armësh dhe, kur u kthye, i pa burrat përdhe. Nuk e dinte nëse kishin vdekur apo jo, por ajo nuk e pa më kurrë Pashk Markajn të gjallë.⁷⁴⁹

234. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të

⁷⁴⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁴⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁴⁶ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40 (e mbyllur me vulë).

⁷⁴⁷ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1152–1156.

⁷⁴⁸ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 344–346.

⁷⁴⁹ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 3.

fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁵⁰ Kufoma me etiketën “Ba05–200T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Pashuk (Pren) Markaj.⁷⁵¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Pashuk (Pren) Markajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si edhe ekspozim ndaj zjarrit.⁷⁵² Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Pashk (Pren) Markajt ka qenë “lëndimi në këmbën e djathtë”.⁷⁵³ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Pashuk (Pren) Markajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, ku thuhet se shkaku i vdekjes ka qenë “goditja me armë zjarri në kofshën e majtë”.⁷⁵⁴

(187) Petrit Markaj (27-vjeçar, mashkull)

235. Merita Deda ka dëshmuar se më 27 prill 1999 Petrit Markajn e kanë detyruar të futej në rresht në oborrin e shtëpisë së Prend Markajt, së bashku me anëtarët e tjerë meshkuj të familjes së saj. Kur po largohej nga mjediset, Deda dëgjoi të shtëna armësh dhe, kur u kthye, i pa burrat përdhe. Nuk e dinte nëse kishin vdekur apo jo, por ajo nuk e pa më kurrë Petrit Markajn të gjallë.⁷⁵⁵

236. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁵⁶ Kufoma me etiketën “Ba05–326T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Petrit (Mark) Markaj.⁷⁵⁷ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Petrit (Mark) Markajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma është në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të eshtrave, si dhe gjurmë të ekspozimit ndaj zjarrit.⁷⁵⁸ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Petrit

⁷⁵⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁵¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40 (e mbyllur me vulë).

⁷⁵² P2414 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 73–79.

⁷⁵³ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 201–203.

⁷⁵⁴ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 578.

⁷⁵⁵ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 3.

⁷⁵⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁵⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40 (e mbyllur me vulë).

⁷⁵⁸ P2602 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 24–36.

(Mark) Markajt ka qenë “goditja me armë zjarri në trung dhe parakrahun e djathhtë”.⁷⁵⁹ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për “Ba05–326DT” dhe “Ba05-326T/IV”, lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁷⁶⁰

(188) Pren Markaj (60-vjeçar, mashkull)

237. Merita Deda ka dëshmuar se më 27 prill 1999 Prend Markajn e kanë detyruar të futej në rresht në oborrin e shtëpisë së tij, së bashku me anëtarët e tjerë meshkuj të familjes së saj. Kur po largohej nga mjediset, Deda dëgjoi të shtëna armësh. Kur u kthye, i pa burrat përdhe. Nuk e dinte nëse kishin vdekur apo jo, por ajo nuk e pa më kurrë Prend Markajn të gjallë.⁷⁶¹

238. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁶² Kufoma me etiketën “Ba05–255T” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Pren (Zef) Markaj.⁷⁶³ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Pren (Zef) Markajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma është në fazë të avancuar të ndryshimit pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të eshtrave, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj zjarrit.⁷⁶⁴

(189) Sokol Markaj (63-vjeçar, mashkull)

239. Dhoma vëren se viktimës me emrin Sokol (Zef) Markaj i janë vendosur dy etiketa të ndryshme: “Ba05–223DT” dhe “Ba05–134T”.⁷⁶⁵ Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit në Mejë më 27 prill 1999. Lista e identifikon “Ba05–223DT” si Sokol (Zef) Markaj dhe në të thuhet se rasti i tij është mbyllur dhe se kufoma i është kthyer familjes.⁷⁶⁶ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Sokol (Zef) Markajt kanë qenë “goditja me armë zjarri në

⁷⁵⁹ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 68–69.

⁷⁶⁰ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 70.

⁷⁶¹ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 3.

⁷⁶² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁶³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40 (e mbyllur me vulë).

⁷⁶⁴ P2416 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 56–63.

⁷⁶⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40 (e mbyllur me vulë).

⁷⁶⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

kokë, goditja e mundshme me armë zjarri në kërdhokullën e djathtë”.⁷⁶⁷ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për “Ba05–134T”, të lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁷⁶⁸ Dhoma është e mendimit se shënimi i Sokol (Zef) Markajt me dy etiketa nuk vë në dyshim faktin se ai u vra në Mejë më 27 prill 1999.

(190) Agron Mehmeti (21-vjeçar, mashkull)

240. Kufoma me etiketën “2Ba-07” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Agron ose Arben (Gani) Mehmeti.⁷⁶⁹ Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit në Mejë më 27 prill 1999. Lista e identifikon “2Ba–07” si Agron (Gani) Mehmeti dhe thotë se rasti i tij është mbyllur dhe se kufoma i është kthyer familjes.⁷⁷⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Agron (Gani) Mehmeti, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Sidoqoftë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si edhe një dëmtim në formë ovale që është shkaktuar me një goditje të vetme me armë zjarri. Krahas këtyre, në aktautopsi theksohet se fraktura e “vertebrës së nëntë të krahavorit është shkaktuar nga një predhë e shkrepur me armë zjarri dore”.⁷⁷¹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Agron (Gani) Mehmetit ka qenë “goditja me armë zjarri në krahavor dhe kokë”.⁷⁷² Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Agron (Gani) Mehmetin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁷⁷³

(191) Arben Mehmeti (19-vjeçar, mashkull)

241. Kufoma me etiketën “2Ba-33” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Agron ose Arben (Gani) Mehmeti.⁷⁷⁴ Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në

⁷⁶⁷ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 194–195.

⁷⁶⁸ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 196.

⁷⁶⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 41 (e mbyllur me vulë).

⁷⁷⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁷¹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 64–68.

⁷⁷² P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 168–169.

⁷⁷³ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 170–171.

⁷⁷⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 41 (e mbyllur me vulë).

një grup personash që u panë për herë të fundit në Mejë më 27 prill 1999. Lista e identifikon “2Ba–33” si Arben (Gani) Mehmeti dhe thotë se rasti i tij është mbyllur dhe se kufoma i është kthyer familjes.⁷⁷⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Arben (Gani) Mehmeti, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, është gjetur një predhë në zonën e shpatullës së majtë dhe një në anën e majtë të kufomat sipër kularthit dhe janë gjetur copëza predhe në acetabul dhe kokën e femurit të majtë.⁷⁷⁶ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Arben (Gani) Mehmetit ka qenë “goditja me armë zjarri në trung (në kraharor dhe shtyllën kurrizore në zonën e kraharorit)”.⁷⁷⁷ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Arben (Gani) Mehmetin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁷⁷⁸

(192) Gani Mehmeti (45-vjeçar, mashkull)

242. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁷⁹ Kufoma me etiketën “2Ba-78” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Gani (Elez) Mehmeti.⁷⁸⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Gani (Elez) Mehmetit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, “është gjetur një predhë metalike në masën e indit të sapunëzuar gjatë prerjes së indit të butë të zonës së vitheve”.⁷⁸¹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Gani (Elez) Mehmetit ka qenë “goditja me armë zjarri në kokë”.⁷⁸²

(193) Hysen Mehmeti (44-vjeçar, mashkull)

⁷⁷⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁷⁶ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 204–211.

⁷⁷⁷ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 172–173.

⁷⁷⁸ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 174–175.

⁷⁷⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁸⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 41 (e mbyllur me vulë).

⁷⁸¹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 437–441.

⁷⁸² P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 113–115.

243. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁸³ Kufoma me etiketën “2Ba-72” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Hysen (Mehmet) Mehmeti.⁷⁸⁴ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Hysen (Mehmet) Mehmetit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.⁷⁸⁵ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Hysen (Mehmet) Mehmetit ka qenë “goditja me armë zjarri në kokën e femurit të djathtë”.⁷⁸⁶ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Hysen (Mehmet) Mehmetin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁷⁸⁷

(194) Hysni Mehmeti (40-vjeçar, mashkull)

244. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁸⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-135” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Hysni (Ali) Mehmeti.⁷⁸⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Hysni (Ali) Mehmetit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, ka dëmtime të kafkës, çka “tregon një predhë se ka kaluar përmes eshtrave, duke ndjekur një trajektore nga pjesa e përparme në pjesën e pasme”.⁷⁹⁰ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Hysni (Ali) Mehmetit ka qenë “goditje me armë zjarri në kokë, trung dhe krahun e majtë”.⁷⁹¹ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse

⁷⁸³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁸⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 41 (e mbyllur me vulë).

⁷⁸⁵ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 407–410.

⁷⁸⁶ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 101–103.

⁷⁸⁷ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 593.

⁷⁸⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁸⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 41 (e mbyllur me vulë).

⁷⁹⁰ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 748–759.

⁷⁹¹ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 262–263.

për Hysni (Ali) Mehmetin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore E Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁷⁹²

(195) Mehmet Mehmeti (18-vjeçar, mashkull)

245. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁹³ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(196) Muharrem Mehmeti (68-vjeçar, mashkull)

246. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.⁷⁹⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-116” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Muharrem (Sali) Mehmeti.⁷⁹⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Muharrem (Sali) Mehmetit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.⁷⁹⁶ Krahas këtyre, është gjetur edhe një vrimë në eshtrën e kombikut e shkaktuar nga plumbi, si edhe një predhë metalike “në pjesën poshtme të anës së brendshme të femurit të djathtë, mu poshtë nyjës kërbishto-çapokore në kufirin e lidhjes së femurit, ashtit iskiatik dhe ashtit pubik”. Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Muharrem (Sali) Mehmetit kanë qenë “lëndimet e shumëfishta të trungut dhe krahut të djathtë, të shkaktuara me armë zjarri”.⁷⁹⁷ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Muharrem (Sali) Mehmetin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.⁷⁹⁸

(197) Qaush Mehmeti (45-vjeçar, mashkull)

247. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur

⁷⁹² P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 264–265.

⁷⁹³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁹⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

⁷⁹⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 41 (e mbyllur me vulë).

⁷⁹⁶ P942 (Dokumente për vendzharrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 632–636.

⁷⁹⁷ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 53–54.

⁷⁹⁸ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 518–519.

369. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹¹⁹⁷ Kufoma me etiketën “2Ba-177” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Simon (Ibrahim) Sokoli.¹¹⁹⁸ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Simon (Ibrahim) Sokolit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të brinjëve, shputës së djathtë dhe këmbës së majtë, dhe fraktura të kokës, trungut dhe ekstremiteteve që janë shkaktuar nga goditja me mjete të forta.¹¹⁹⁹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Simon (Ibrahim) Sokolit ka qenë “goditja me armë zjarri në kraharor”.¹²⁰⁰ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Simon (Ibrahim) Sokolin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹²⁰¹

(309) Ismet Sylja (48-vjeçar, mashkull)

370. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁰² Kufoma me etiketën “2Ba-213” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ismet (Zenun) Sylja.¹²⁰³ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Ismet (Zenun) Sylës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, vertebrave, brinjëve, këmbëve dhe krahëve, si dhe

¹¹⁹⁶ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 533.

¹¹⁹⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹¹⁹⁸ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 53 (e mbyllur me vulë).

¹¹⁹⁹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 960–964.

¹²⁰⁰ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 313–314.

¹²⁰¹ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 547.

¹²⁰² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁰³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 53 (e mbyllur me vulë).

gjurmë të goditjes me mjete të forta.¹²⁰⁴ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Ismet (Zenun) Sylës kanë qenë “lëndimet e shumëfishta të trungut, krahut të majtë, dhe të dyja këmbëve, të shkaktuara me armë zjarri”.¹²⁰⁵ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Ismet (Zenun) Sylën, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹²⁰⁶

(310) Rexhep Sylja (77-vjeçar, mashkull)

371. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁰⁷ Kufoma me etiketën “2Ba-23” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Rexhep (Avdi) Sylja.¹²⁰⁸ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Rexhep (Avdi) Sylës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë goditjeje me mjete të forta në kokë, trung dhe gjymtyrë, dhe të ekspozimit ndaj temperaturave të larta.¹²⁰⁹ Në certifikatën e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet gjithashtu se shkaku i vdekjes së Rexhep (Avdi) Sylës është i papërcaktuar.¹²¹⁰

(311) Bajram Sylaj (51-vjeçar, mashkull)

372. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²¹¹ Kufoma me etiketën “2Ba-66” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Bajram (Sali) Sylja.¹²¹² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Bajram (Sali) Sylës, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet

¹²⁰⁴ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1157–1161.

¹²⁰⁵ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 307–308.

¹²⁰⁶ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 554–555.

¹²⁰⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁰⁸ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 53 (e mbyllur me vulë).

¹²⁰⁹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 150–153.

¹²¹⁰ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 28–30.

¹²¹¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

në fazë të avancuar të ndryshimit pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se mungon pjesa më e madhe e kokës dhe fytyrës, se ka fraktura të shumëfishta të vertebrave, brinjëve dhe dërrasës së kraharorit, si dhe gjurmë goditjeje me mjete të forta.¹²¹³

(312) Bajram Tahiraj (55-vjeçar, mashkull)

373. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²¹⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-142” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Bajram (Malë) Tahiraj.¹²¹⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Bajram (Malë) Tahirajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të eshtrave të shaktuara nga goditja me mjete të forta. Krahas këtyre, është gjetur një predhë në “indin e butë të hapësirës ndërbrinjore të pestë në anën e djathtë, në nivelin e vijës shpatullore... maja e së cilës është e drejtuar nga ana e sipërme e brinjës së gjashtë”.¹²¹⁶ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet gjithashtu se shkaku i vdekjes së Bajram (Malë) Tahirajt është i papërcaktuar.¹²¹⁷

(313) Halil Tahiraj (34-vjeçar, mashkull)

374. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²¹⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-50” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Halil (Myftar) Tahiraj.¹²¹⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Halil (Myftar) Tahirajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në

¹²¹² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 53 (e mbyllur me vulë).

¹²¹³ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 377–383.

¹²¹⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²¹⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 54 (e mbyllur me vulë).

¹²¹⁶ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 789–792.

¹²¹⁷ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 239–241.

¹²¹⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²¹⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 54 (e mbyllur me vulë).

aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.¹²²⁰ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Halil (Myftar) Tahirajt ka qenë “lëndim shkaktuar me armë zjarri”.¹²²¹

(314) Isuf Tahiraj (63-vjeçar, mashkull)

375. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²²² Kufoma me etiketën “2Ba-97” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Isuf (Tahir) Tahiraj.¹²²³ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Isuf (Tahir) Tahirajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.¹²²⁴ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet gjithashtu se shkaku i vdekjes së Isuf (Tahir) Tahirajt është i papërcaktuar.¹²²⁵

(315) Osman Tahiraj (47-vjeçar, mashkull)

376. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²²⁶ Kufoma me etiketën “2Ba-141” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Osman (Tahir) Tahiraj.¹²²⁷ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Osman (Tahir) Tahirajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të eshtrave të shkaktuara nga goditja me mjete të forta.¹²²⁸

¹²²⁰ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 296–299.

¹²²¹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 72–74.

¹²²² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²²³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 54 (e mbyllur me vulë).

¹²²⁴ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 532–535.

¹²²⁵ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 153–155.

¹²²⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²²⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 54 (e mbyllur me vulë).

¹²²⁸ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 785–788.

Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Osman (Tahir) Tahirajt ka qenë “lëndime të shkaktuara me armë zjarri”.¹²²⁹

(316) Ramadan Tahiraj (37-vjeçar, mashkull)

377. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²³⁰ Kufoma me etiketën “2Ba-182” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Ramadan (Tahir) Tahiraj.¹²³¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Ramadan (Tahir) Tahirajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, brinjëve, vertebrave, krahëve dhe këmbës së majtë, si edhe “fraktura të shumëfishta të shkaktuara me anën jo të mprehtë të një mjeti mekanik”, si edhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.¹²³² Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Ramadan (Tahir) Tahirajt ka qenë “lëndim shkaktuar me armë zjarri”.¹²³³

(317) Rrustem Tahiraj (22-vjeçar, mashkull)

378. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²³⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-228” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Rrustem (Sadri) Tahiraj.¹²³⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Rrustem (Sadri) Tahirajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, vertebrave dhe brinjëve, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.¹²³⁶ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të

¹²²⁹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 236–238.

¹²³⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²³¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 54 (e mbyllur me vulë).

¹²³² P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 991–995.

¹²³³ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 296–299.

¹²³⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²³⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 54 (e mbyllur me vulë).

¹²³⁶ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1240–1246.

Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Rrustem (Sadri) Tahirajt kanë qenë “goditjet me armë zjarri në kokë dhe kraharor”.¹²³⁷ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Rrustem (Sadri) Tahirajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, ku thuhet se vdekja ka ardhur si pasojë e dy goditjeve me armë zjarri në kokë dhe kraharor.¹²³⁸

(318) Selman Tahiraj (47-vjeçar, mashkull)

379. Dhoma vëren se viktimës me emër Selman (Tafë) Tahiraj i janë vënë dy etiketa të ndryshme (“K-2BA196-K2” dhe “K2BA-196-K1-1”).¹²³⁹ Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁴⁰ Dhoma është e mendimit se vendosja e dy etiketave Selman (Tafë) Tahirajt nuk vë në dyshim faktin se ai u vra në Mejë më 27 prill 1999.

(319) Xhevdet Tahiraj (24-vjeçar, mashkull)

380. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁴¹ Kufoma me etiketën “2Ba-179” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Xhevdet (Selman) Tahiraj.¹²⁴² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Xhevdet (Selman) Tahirajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të brinjëve, vertebrave, kularthi së djathtë, shpatullës së djathtë dhe eshtrës së krahut të djathtë, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, “është gjetur një predhë metalike pranë vertebrës së parë të qafës.”¹²⁴³ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Xhevdet (Selman) Tahirajt ka qenë “lëndimi në kraharor, i shkaktuar me armë zjarri”.¹²⁴⁴ Kjo konfirmohet nga

¹²³⁷ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 283–284.

¹²³⁸ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 285–286.

¹²³⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 54 (e mbyllur me vulë).

¹²⁴⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁴¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁴² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 54 (e mbyllur me vulë).

¹²⁴³ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 973–981.

¹²⁴⁴ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 52–53.

aktekspertiza antropologjike përmblendhëse për Xhevdet (Selman) Tahirajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹²⁴⁵

(320) Ukë Xhemajli (30-vjeçar, mashkull) dhe Shpend Xhemajli (21-vjeçar, mashkull)

381. Dhoma vëren se e njëjta etiketë, “2Ba–140”, u është vendosur dy viktimave: Ukë dhe Shpend (Osman) Xhemajli.¹²⁴⁶ Të dy viktimat janë përfshirë si persona të zhdukur në listën e ZPZHML-së për personat e zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktimat bënin pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit në Mejë më 27 prill 1999. Ajo e identifikon etiketën “2Ba–140” si Ukë (Osmon) Xhemajli.¹²⁴⁷

382. Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Ukë (Osmon) Xhemajlit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, “brinja e tetë e djathtë ka pasur fraktura të shumëfishta në vendin ku lidhet me shtyllën kurrizore, ndërsa indi i butë rrethues kishte marrë një ngjyrim të gjelbër dhe kishte një predhë të gjelbër në të”.¹²⁴⁸ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor Mjekësor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes i Ukë (Osmon) Xhemajlit kanë qenë “plagët e shumëfishta në zonën e kombikut dhe barkut dhe në femurin e djathtë, të shkaktuara me armë zjarri”.¹²⁴⁹

383. Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova Mjeko-ligjore në lidhje me Shpend (Osman) Xhemajlin, kështu që nuk bindet që mund të provohet se ai u vra në Mejë më 27 prill 1999.

(321) Alban Xhemajli (19-vjeçar, mashkull)

384. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të

¹²⁴⁵ P2454 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 54.

¹²⁴⁶ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës 004/2005-ER nga muaji shtator 2005 përgatitur nga KNPZH-ja), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 55. (e mbyllur me vulë). Dhoma vëren se P2559 i rendit dy emrat e parë për etiketën “2Ba–140”.

¹²⁴⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁴⁸ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 779–784.

¹²⁴⁹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 232–235.

fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁵⁰ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova Mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(322) Hasan Xhemajli (64-vjeçar, mashkull)

385. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁵¹ Kufoma me etiketën “2Ba-47” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Hasan (Ramë) Xhemajlaj.¹²⁵² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Hasan (Ramë) Xhemajlajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, në aktautopsi theksohet se frakturat e dërrasës së kraharorit ka mundësi të jenë shkaktuar nga një predhë, si edhe është gjetur një predhë “në indin e butë në pjesën e majtë anësore të qafës”.¹²⁵³ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Hasan (Ramë) Xhemajlajt kanë qenë “disa dëmtime në komblik dhe dërrasën e kraharorit, që përputhen me goditjet me plumba”.¹²⁵⁴

(323) Ilija Xhemajli (23-vjeçar, mashkull)

386. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁵⁵ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova Mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(324) Isa Xhemajli (55-vjeçar, mashkull)

387. Dhoma vëren se viktimës me emrin Isa (Raman) Xhemajlaj i janë vendosur dy etiketa të ndryshme: “2Ba-S-16” dhe “K2BA-S-15-2Ba-S-16-3”.¹²⁵⁶ Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima

¹²⁵⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁵¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁵² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 55 (e mbyllur me vulë).

¹²⁵³ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 281–285.

¹²⁵⁴ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 68–71.

¹²⁵⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁵⁶ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 55 (e mbyllur me vulë).

bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁵⁷ Dhoma është e mendimit se nga vendosja e dy etiketave Isa (Raman) Xhemajlit nuk vë në dyshim faktin se ai u vra në Mejë më 27 prill 1999.

(325) Miftar Xhemajli (34-vjeçar, mashkull)

388. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁵⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-57” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Miftar (Hasan) Xhemajlaj.¹²⁵⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Miftar (Hasan) Xhemajlajt, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.¹²⁶⁰ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, gjithashtu konstatohet se shkaku i vdekjes së Miftar (Hasan) Xhemajlajt është i papërcaktuar.¹²⁶¹

(326) Muharrem Xhemajli (26-vjeçar, mashkull)

389. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁶² Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova Mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(327) Rifat Xhemajli (19-vjeçar, mashkull)

390. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁶³ Kufoma me etiketën “2Ba-133” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Rifat (Isa) Xhamajli.¹²⁶⁴ Në aktautopsinë e përpiluar

¹²⁵⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁵⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁵⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 55 (e mbyllur me vulë).

¹²⁶⁰ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 333–337.

¹²⁶¹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 84–87.

¹²⁶² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁶³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁶⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 55 (e mbyllur me vulë).

nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Rifat (Isa) Xhamajli, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të vertebrave, brinjëve, këmbës së djathtë dhe krahut të djathtë, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, ekzaminimi ka zbuluar se ka dy plagë të shkaktuara me armë zjarri në shpatullën e djathtë dhe një plagë të mundshme në kraharor.¹²⁶⁵ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Rifat (Isa) Xhamajlajt kanë qenë “lëndimet me armë zjarri në kraharor dhe krahun e majtë”.¹²⁶⁶ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Rifat (Isa) Xhamajlajn, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹²⁶⁷

(328) Shkëlzen Xhemajli (20-vjeçar, mashkull)

391. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁶⁸ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova Mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(329) Shpend Xhemajli (21-vjeçar, mashkull)

392. Shih analizën numër 320, më lart.

(330) Xhemajl Xhemajli (46-vjeçar, mashkull)

393. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁶⁹ Kufoma me etiketën “2Ba-248” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Xhemaji (Ramë) Xhemajli.¹²⁷⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Xhemajl (Ramë) Xhemajlit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, në

¹²⁶⁵ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 736–741.

¹²⁶⁶ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 328–329.

¹²⁶⁷ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 500–501.

¹²⁶⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁶⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁷⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 55 (e mbyllur me vulë).

aktautopsi theksohet se është gjetur një predhë metalike “në indin e butë, mu nën lëkurë, në zonën e një të tretës së brendshme të kularthi së djathtë”.¹²⁷¹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Xhemaji (Ramë) Xhemajlit kanë qenë “plagët e shumëfishta të pjesës së sipërme të kufomat, të shkaktuara me armë zjarri”.¹²⁷²

(331) Elez Ymeri (59-vjeçar, mashkull)

394. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁷³ Kufoma me etiketën “2Ba-95” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Elez (Tafë) Imeri.¹²⁷⁴ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Elez (Tafë) Imerit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë. Krahas këtyre, “është gjetur në eshtrën e krahut të djathtë”.¹²⁷⁵ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Elez (Tafë) Imerit ka qenë “goditje me armë zjarri në kokë”.¹²⁷⁶

(332) Gani Ymeri (41-vjeçar, mashkull)

395. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁷⁷ Megjithatë, Dhoma vëren se nuk ka prova mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(333) Halit Ymeri (57-vjeçar, mashkull)

396. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të

¹²⁷¹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1371-1375.

¹²⁷² P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 430-433.

¹²⁷³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁷⁴ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 34 (e mbyllur me vulë).

¹²⁷⁵ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 523-526.

¹²⁷⁶ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 147-149.

¹²⁷⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁷⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-99” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Halit (Mustafë) Imeri.¹²⁷⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Halit (Mustafë) Imerit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.¹²⁸⁰ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, gjithashtu konstatohet se shkaku i vdekjes së Halit (Mustafë) Ymerit është i papërcaktuar.¹²⁸¹

(334) Hasan Ymeri (24-vjeçar, mashkull)

397. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁸² Kufoma me etiketën “2Ba-60” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Hasan (Halit) Imeri.¹²⁸³ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Hasan (Halit) Imerit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.¹²⁸⁴ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Hasan (Halit) Imerit ka qenë “plaga në bark, e shkaktuar me armë zjarri”.¹²⁸⁵ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Hasan (Halit) Imerin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, ku thuhet se shkaku i vdekjes ka qenë “plagë e shkaktuar me armë zjarri në trung”.¹²⁸⁶

(335) Hysen Ymeri (mashkull, 18-vjeçar)

398. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur

¹²⁷⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁷⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 34 (e mbyllur me vulë).

¹²⁸⁰ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 540–543.

¹²⁸¹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 159–161.

¹²⁸² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁸³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 33 (e mbyllur me vulë).

¹²⁸⁴ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 349–354.

¹²⁸⁵ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 88–90.

në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁸⁷ Kufoma me etiketën “2Ba-194” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Hysen (Halit) Imeri.¹²⁸⁸ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Hysen (Halit) Imerit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.¹²⁸⁹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Hysen (Halit) Imerit kanë qenë “plagët e shumëfishta në kraharor, të shkaktuara me armë zjarri”.¹²⁹⁰ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Hysen (Halit) Imerin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹²⁹¹

(336) Musa Ymeri (36-vjeçar, mashkull)

399. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁹² Kufoma me etiketën “2Ba-193” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Musa (Xhafer) Ymeri.¹²⁹³ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Musa (Xhafer) Ymerit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se mungon e gjithë koka dhe ka fraktura të shumëfishta dhe gjurmë goditjeje me mjete të forta dhe të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.¹²⁹⁴ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, gjithashtu konstatohet se shkaku i vdekjes së Musa (Xhafer) Imerit është i papërcaktuar.¹²⁹⁵

(337) Xhafer Ymeri (68-vjeçar, mashkull)

¹²⁸⁶ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 587.

¹²⁸⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁸⁸ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 33 (e mbyllur me vulë).

¹²⁸⁹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1058–1061.

¹²⁹⁰ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 317–321.

¹²⁹¹ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 569.

¹²⁹² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁹³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 34 (e mbyllur me vulë).

¹²⁹⁴ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1055–1057.

¹²⁹⁵ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 314–316.

400. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹²⁹⁶ Kufoma me etiketën “2Ba-153” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Xhafer (Musë) Ymeri.¹²⁹⁷ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së “2Ba-153”, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.¹²⁹⁸ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Xhafer (Musë) Ymerit ka qenë “plagë me armë zjarri në barkun e poshtëm”.¹²⁹⁹

(338) Zenel Ymeri (41-vjeçar, mashkull)

401. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹³⁰⁰ Kufoma me etiketën “2Ba-87” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Zenel (Xhafer) Ymeri.¹³⁰¹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Zenel (Xhafer) Ymerit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “është konstatuar se kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se mungon dora e majtë, ka fraktura të shumëfishta të kërcit tiroid, fyellit të këmbës së majtë, eshtrave të këmbëve dhe kularthi së djathtë, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.¹³⁰² Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, gjithashtu konstatohet se shkaku i vdekjes së Zenel (Xhafer) Ymerit është i papërcaktuar.¹³⁰³

(339) Bajram Zenuni (36-vjeçar, mashkull)

¹²⁹⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹²⁹⁷ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 33 (e mbyllur me vulë).

¹²⁹⁸ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 848–851.

¹²⁹⁹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 249–252.

¹³⁰⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹³⁰¹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 34 (e mbyllur me vulë).

¹³⁰² P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 481–484.

¹³⁰³ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 138–140.

402. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹³⁰⁴ Kufoma me etiketën “2Ba-131” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Bajram (Lahë) Zenuni.¹³⁰⁵ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Bajram (Lahë) Zenunit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të krahavorit dhe vertebrave, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.¹³⁰⁶ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Bajram (Lahë) Zenunit ka qenë “goditje me armë zjarri në krahavor”.¹³⁰⁷

(340) Xhevat Zenuni (43-vjeçar, mashkull)

403. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹³⁰⁸ Kufoma me etiketën “2Ba-08” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Xhevat (Hazir) Zenuni.¹³⁰⁹ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Xhevat (Hazir) Zenunit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, vertebrave, kërcirit të këmbës së djathtë, femurëve, eshtrës së krahut të majtë, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe të ekspozimit ndaj temperaturës së lartë.¹³¹⁰ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Xhevat (Hazir) Zenunit është “plagë në kokë, e shkaktuar me armë zjarri”.¹³¹¹

(341) Zenel Zenuni (42-vjeçar, mashkull)

404. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të

¹³⁰⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹³⁰⁵ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 56 (e mbyllur me vulë).

¹³⁰⁶ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 724–729.

¹³⁰⁷ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 216–219.

¹³⁰⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹³⁰⁹ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 56 (e mbyllur me vulë).

¹³¹⁰ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 69–73.

¹³¹¹ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 7–9.

fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹³¹² Kufoma me etiketën “2Ba-41” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Zenel (Zeqë) Zenuni.¹³¹³ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Zenel (Zeqë) Zenunit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.¹³¹⁴ Në certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë, konstatohet se shkaku i vdekjes së Zenel (Zeqë) Zenunit është i papërcaktuar.¹³¹⁵ Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Zenel (Zeqë) Zenunin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹³¹⁶

(342) Hasan Zeqiri (56-vjeçar, mashkull)

405. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹³¹⁷ Kufoma me etiketën “2Ba-210” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Hasan (Ramë) Zeqiri.¹³¹⁸ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Hasan (Ramë) Zeqirit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta të kokës, komplikut, brinjëve, vertebrave, dorëzës dhe dy shpatullave, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.¹³¹⁹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Hasan (Ramë) Zeqirit është “plaga që përshkon qafën, e shkaktuar me armë zjarri”.¹³²⁰

(343) Arbër Zyberi (17-vjeçar, mashkull)

406. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të

¹³¹² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹³¹³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 56 (e mbyllur me vulë).

¹³¹⁴ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 246–253.

¹³¹⁵ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 252–253.

¹³¹⁶ P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 254.

¹³¹⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹³¹⁸ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 56 (e mbyllur me vulë).

¹³¹⁹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1143–1146.

fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹³²¹ Kufoma me etiketën “2Ba-227” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Arbër (Selim) Zyberi.¹³²² Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Arbër (Selim) Zyberit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta. Krahas këtyre, është gjetur një predhë dhe një plagë e shkaktuar me armë zjarri në “zonën e brinjës së dymbëdhjetë në anën e majtë”.¹³²³ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Arbër (Selim) Zyberit ka qenë “plagë të kokës të shkaktuara me armë zjarri”.¹³²⁴

(344) Gani Zyberi (30-vjeçar, mashkull)

407. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹³²⁵ Kufoma me etiketën “2Ba-124” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Gani (Sadri) Zyberi.¹³²⁶ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Gani (Sadri) Zyberit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhet në fazat e fundit të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta dhe ekspozim ndaj temperaturës së lartë.¹³²⁷ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Gani (Sadri) Zyberit ka qenë “lëndimi në kraharor, të shkaktuar me armë zjarri”.¹³²⁸

(345) Skënder Zyberi (30-vjeçar, mashkull)

408. Viktima është përfshirë si person i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur në Kosovë. Në listë theksohet se viktima bënte pjesë në një grup personash që u panë për herë të

¹³²⁰ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 335–339.

¹³²¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹³²² P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 56 (e mbyllur me vulë).

¹³²³ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1235–1239.

¹³²⁴ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 374–376.

¹³²⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹³²⁶ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 56 (e mbyllur me vulë).

¹³²⁷ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 674–677.

¹³²⁸ P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 206–208.

fundit më 27 prill 1999 në Mejë.¹³²⁹ Kufoma me etiketën “2Ba-59” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se është personi me emër Skënder (Beqir) Zyberi.¹³³⁰ Në aktautopsinë e përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i Fakultetit të Mjekësisë të Beogradit nuk përcaktohet shkaku i vdekjes së Skënder (Beqir) Zyberit, ndërsa theksohet se arsyeja për këtë është fakti se “kufoma ndodhej në fazë të avancuar të ndryshimeve pas vdekjes”. Megjithatë, në aktautopsi theksohet se ka fraktura të shumëfishta, si dhe gjurmë të goditjes me mjete të forta.¹³³¹ Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Mjekut Ligjor e Departamentit të Drejtësisë përcakton se shkaku i vdekjes së Skënder (Beqir) Zyberit ka qenë “goditja me armë zjarri në shpatullën e djathtë dhe parakrahun e djathtë”.¹³³² Kjo konfirmohet nga aktekspertiza antropologjike përmbledhëse për Skënder (Beqir) Zyberin, e lëshuar nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.¹³³³

B. RAHOVEC

409. Isuf Zhuniqi dëshmoi se i kontrolloi të gjithë emrat e përfshirë në aktekspertizën e Ekipit Mjekoligjor Britanik (Aktekspertiza e Zhvarrimit, përpiluar nga Dega e Luftës kundër Terrorizmit e Policisë Metropolitane, në lidhje me këqyrjen e vendit në Bellacërkë, numër BC001, të Kosovës)¹³³⁴ si persona të vrarë në Bellacërkë dhe i njohu të gjithë emrat si persona të vrarë më 26 mars 1999 në përroin e Bellajës.¹³³⁵

410. Gjatë dëshmisë së Sabri Popajt, Prokuroria ka theksuar se ai përmendet në aktekspertizën e Ekipit Mjekoligjor Britanik si një person që ka identifikuar 15 nga të vdekurit të përfshirë në aktekspertizë dhe ka dëshmuar se ata janë vrarë në Bellacërkë.¹³³⁶

1. Viktimat e përfshira në Listën B të Aktakuzës (Bellacërkë)

411. Dhoma vëren se ka një sërë mospërputhjesh midis provave dhe aktakuzës sa i takon mënyrës se si shkruhen emrat e disa prej viktimave të renditur në Listën B. Megjithatë, në shumicën e rasteve,

¹³²⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹³³⁰ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 56 (e mbyllur me vulë).

¹³³¹ P942 (Dokumente për vendzhvarrimin e Batajnicës 02: aktautopsitë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 346–348.

¹³³² P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 331–332.

¹³³³ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 512.

¹³³⁴ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën). Ky dokument është pranuar si provë përmes dëshmitarit Sabri Popaj.

¹³³⁵ Isuf Zhuniqi, T. 410–4105 (27 shtator 2006).

¹³³⁶ Sabri Popaj, T. 5677 (1 nëntor 2006); P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 3–5.

këto mospërputhje janë kaq të vogla saqë Dhoma është në gjendje të arrijë në përfundimin se të dhënat përkatëse lidhen me viktimën e caktuar.

(1) Abdullah Begaj (25-vjeçar, mashkull)

412. Isuf Zhuniqi e identifikoi Abdullah Begajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³³⁷ Megjithatë, asnjë kufomë nuk është identifikuar si e tij; emri i tij nuk figuron në listën e aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik.¹³³⁸

(2) Murat Berisha (60-vjeçar, mashkull)

413. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Murat Berishën si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³³⁹ Dervish Berisha e identifikoi kufomën e të atit, Murat Berishës, me etiketë “JB-G/29/SR” (Zona 1) përmes veshjeve dhe fytyrës. Ekipi Mjekoligjor Britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁴⁰

(3) Fadil Gashi (46-vjeçar, mashkull)

414. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Fadil Gashin si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁴¹ Qamile Gashi e identifikoi kufomën e të shoqit, Fadil Gashit, me etiketë “JB-G/32/SR” (Zona 1), përmes veshjeve. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi një plagë të shkaktuar me armë zjarri, e cila, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, i ka shkaktuar vdekjen viktimës.¹³⁴²

¹³³⁷ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5.

¹³³⁸ P97 (Aktekspertiza e zhvarimit për Bellacërkën).

¹³³⁹ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

¹³⁴⁰ P97 (Aktekspertiza e zhvarimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 63.

¹³⁴¹ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

¹³⁴² P97 (Aktekspertiza e zhvarimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 65–66.

(4) Musa Morina (65-vjeçar, mashkull)

415. Isuf Zhuniqi e identifikoi Musa Morinën si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁴³ Megjithatë, asnjë kufomë nuk është identifikuar si e tij; emri i tij nuk figuron në listën e aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik.¹³⁴⁴

(5) Abdullah Popaj (18-vjeçar, mashkull)

416. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Abdullah Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁴⁵ Kufoma me etiketë “CAD/5/SR” (Zona 1) është identifikuar përmes veshjeve dhe fytyrës si Abdullah Popaj nga kushëriri i tij. Ekipi Mjekoligjor Britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁴⁶

(6) Agon Popaj (14-vjeçar, mashkull)

417. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Agon Popajn, të birin e Sabri Popajt, si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁴⁷ Sabri Popaj e identifikoi kufomën e të birit, Agon Popaj, me etiketë “CAD/8/SR” (Zona 1), përmes veshjeve dhe fytyrës. Kufomës iu gjet edhe një shishe, e cila bënte të ditur identitetin e tij. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁴⁸

(7) Alban Popaj (21-vjeçar, mashkull)

418. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Alban Popajn, nipin e Sabri Popajt, si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁴⁹ Megjithatë, asnjë

¹³⁴³ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5.

¹³⁴⁴ *Shih* P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën).

¹³⁴⁵ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 6; P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 3; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

¹³⁴⁶ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 85–86.

¹³⁴⁷ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 1; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 5, 7. *Shih gjithashtu* Sabri Popaj, T. 5739 (2 nëntor 2006).

¹³⁴⁸ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 89–90.

¹³⁴⁹ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 2; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 5.

kufomë nuk është identifikuar si e tij; emri i tij nuk figuron në listën e aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik.¹³⁵⁰

(8) Bedrush Popaj (47-vjeçar, mashkull)

419. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Bedrush Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁵¹ Kufoma me etiketë “CAD/6/SR” (Zona 1) është identifikuar nga kushëriri i tij përmes veshjeve dhe fytyrës si Bedrush Popaj. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁵²

(9) Belul Popaj (14-vjeçar, mashkull)

420. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Belul Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁵³ Kufoma me etiketë “CAD/3/SR” (Zona 1) është identifikuar nga kushëriri i tij përmes veshjeve si Belul Popaj. Kufomës iu gjet edhe një shishe, e cila bënte të ditur identitetin e tij. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, vdekja e viktimës është shkaktuar nga një goditje me armë zjarri në kokë.¹³⁵⁴

(10) Ethem Popaj (46-vjeçar, mashkull)

421. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Ethem Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁵⁵ Kufoma me etiketë “CAD/8/SR” (Zona 1) është identifikuar si Ethem Popaj nga kushëriri i tij përmes veshjeve dhe orës së dorës. Kufomës iu gjet edhe një shishe, e cila bënte të ditur identitetin e tij. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁵⁶

¹³⁵⁰ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën).

¹³⁵¹ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 6; P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 4; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

¹³⁵² P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 86–87.

¹³⁵³ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

¹³⁵⁴ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 84–85.

¹³⁵⁵ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; P94 (foto, të bëra përpara konfliktit, të personave të vrarë Bellacërkë), f. 6;

¹³⁵⁶ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 88–89.

(11) Hazer Popaj (77-vjeçar, mashkull)

422. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Hazer Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁵⁷ Kufomën e varrosën Sabri Popaj dhe Zenel Popaj.¹³⁵⁸ Zenel Popaj e identifikoi kufomën me etiketë “JB-G/61/SR” (Zonë 7) si Hazer M. Popaj. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁵⁹

(12) Hysni Popaj (37-vjeçar, mashkull)

423. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Hysni Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁶⁰ Megjithatë, asnjë kufomë nuk është identifikuar si e tij; emri i tij nuk figuron në listën e aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik.¹³⁶¹

(13) Irfan Popaj (41-vjeçar, mashkull)

424. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Irfan Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁶² Sabri Popaj dëshmoi se e gjeti kufomën e tij dhe e mori me mend se ai ishte njëri prej personave të vrarë nga MPB-ja kur kishte dëgjuar të shtënat në përroin e Bellajës, rreth pesë minuta pasi kishte parë vrasjen e grupit të madh të njerëzve.¹³⁶³ Kufomën e varrosën Sabri Popaj dhe Enver Popaj, vëllai i Irfan Popajt.¹³⁶⁴ Enver Popaj e identifikoi kufomën me etiketë “JB-G/56/SR” (Zona 5) si të vëllain, Irfan Popajn. Ekipi Mjekoligjor Britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁶⁵

¹³⁵⁷ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 6 dhe P2446 (shtojcë e deklaratës së dëshmitarit, datë 5 qershor 2002); P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 6;

¹³⁵⁸ Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 6 dhe P2446 (shtojcë e deklaratës së dëshmitarit, datë 5 qershor 2002); P97 (Aktekspertiza e zhvarimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 45.

¹³⁵⁹ P97 (Aktekspertiza e zhvarimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 81–82.

¹³⁶⁰ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 6. Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 5.

¹³⁶¹ *Shih* P97 (Aktekspertiza e zhvarimit për Bellacërkën).

¹³⁶² Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 7; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

¹³⁶³ Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 8, T. 5661–5662, 5674 (1 nëntor 2006).

¹³⁶⁴ Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7–8.

¹³⁶⁵ P97 (Aktekspertiza e zhvarimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 75–76.

(14) Isuf Popaj (76-vjeçar, mashkull)

425. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Isuf Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁶⁶ Kufomën e tij e varrosi Sabri Popaj.¹³⁶⁷ Kufoma me etiketë “CAD/13/SR” (Zona 2) është identifikuar si Isuf Popaj nga kushëriri i tij përmes veshjeve. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁶⁸

(15) Kreshnik Popaj (18-vjeçar, mashkull)

426. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Kreshnik Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁶⁹ Kufoma me etiketë “CAD/7/SR” (Zona 1) është identifikuar si Kreshnik Popaj nga kushëriri i tij përmes veshjeve dhe këpucëve. Kufomës iu gjet edhe një shishe, e cila bënte të ditur identitetin e tij. Ekipi Mjekoligjor Britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁷⁰

(16) Lindrit Popaj (18-vjeçar, mashkull)

427. Isuf Zhuniqi e identifikoi Lindrit Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁷¹ Megjithatë, asnjë kufomë nuk është identifikuar si e tij; emri i tij nuk figuron në listën e aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik.¹³⁷²

(17) Mehmet Popaj (46-vjeçar, mashkull)

428. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Mehmet Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁷³ Kufomën e varrosi Sabri Popaj.¹³⁷⁴

¹³⁶⁶ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 6. Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

¹³⁶⁷ Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 6. *Shih* Sabri Popaj, T. 5673–5674 (1 nëntor 2006); IC94 (fotografi e shënuar e Urës së Bellajës).

¹³⁶⁸ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 93–94.

¹³⁶⁹ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 8; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

¹³⁷⁰ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 87–88.

¹³⁷¹ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 6.

¹³⁷² P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën).

¹³⁷³ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 6. Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

Kufoma me etiketë “CAD/7/SR” (Zona 1) është identifikuar si Mehmet Popaj nga kushëriri i tij përmes veshjeve. Kufomës iu gjet edhe një shishe, e cila bënte të ditur identitetin e tij. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁷⁵

(18) Mersel Popaj (53-vjeçar, mashkull)

429. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Mersel Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁷⁶ Kufoma me etiketë “CAD/2/SR” (Zona 1) është identifikuar si Mersel Popaj nga kushëriri i tij përmes veshjeve. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁷⁷

(19) Nazmi Popaj (45-vjeçar, mashkull)

430. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Nazmi Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁷⁸ Kufoma me etiketë “CAD/12/SR” (Zona 1) është identifikuar si Nazmi Popaj nga i vëllai përmes veshjeve dhe fytyrës. Kufomës iu gjet edhe një shishe, e cila bënte të ditur identitetin e tij. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁷⁹

¹³⁷⁴ Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 6. Shih Sabri Popaj, T. 5673–5674 (1 nëntor 2006); IC94 (fotografi e shënuar e Urës së Bellajës).

¹³⁷⁵ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 94–95.

¹³⁷⁶ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

¹³⁷⁷ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 83–84.

¹³⁷⁸ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë të bëra përpara konfliktit), f. 9; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 5, 7, T. 5739 (2 nëntor 2006).

¹³⁷⁹ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 92–93.

(20) Nisim Popaj (35-vjeçar, mashkull)

431. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Nisim Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁸⁰ Kufoma me etiketë “CAD/11/SR” (Zona 1) është identifikuar si Nesim Popaj nga i vëllai përmes veshjeve dhe fytyrës. Kufomës iu gjet edhe një shishe, e cila bënte të ditur identitetin e tij. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁸¹

(21) Rrustem Popaj (61-vjeçar, mashkull)

432. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Rrustem Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁸² Megjithëse, emri “Popaj Rrustem” nuk del në deklaratën me shkrim të Isuf Zhuniqit, ku përmend emrat e personave që ka parë të vriten në fshatin e Bellacërkës, ka një fotografi të një presoni me emrin “Rrustem Halit Popaj” (61-vjeçar) mes fotografive të fshatarëve të Bellacërkës në P94 dhe Isuf Zhuniqi dëshmoi se ai i shqyrtoi këto fotografi dhe se të gjithë personat që janë në këto fotografi janë vrarë.¹³⁸³ Elmi Popaj e identifikoi kufomën e ungjit, “Rusten” Popajt, me etiketë “JB-G/33/SR” (Zona 1), përmes veshjeve dhe orës së dorës. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁸⁴

(22) Sahid Popaj (40-vjeçar, mashkull)

433. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Sahid Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁸⁵ Kufoma me etiketë “CAD/4/SR” (Zona 1) është identifikuar si Sahit Popaj nga kushëriri i tij përmes veshjeve dhe dokumenteve. Kufomës iu gjet edhe një shishe, e cila bënte të ditur identitetin e tij. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të

¹³⁸⁰ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 4; P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 10; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7, T. 5739 (2 nëntor 2006).

¹³⁸¹ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 91–92.

¹³⁸² Isuf Zhuniqi, T. 4104 (27 shtator 2006). P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 11; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

¹³⁸³ Isuf Zhuniqi, T. 4104 (27 shtator 2006). P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 11;

¹³⁸⁴ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 66–67.

¹³⁸⁵ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁸⁶

(23) Sedat Popaj (47-vjeçar, mashkull)

434. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Sedat Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁸⁷ Sabri Popaj dëshmoi se e gjeti kufomën e tij dhe e mori me mend se ai ishte njëri prej personave të vrarë nga MPB-ja kur kishte dëgjuar të shtënat në përroin e Bellajës, rreth pesë minuta pasi kishte parë vrasjen e grupit të madh të njerëzve. Kufomën e kishin varrosur Sabri Popaj dhe Zenel Popaj.¹³⁸⁸ Enver Popaj e identifikoi kufomën me etiketë “JB-G/55/SR” (Zona 5) si të vëllain, Sedat Popajn. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁸⁹

(24) Shëndet Popaj (17-vjeçar, mashkull)

435. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Shëndet Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁹⁰ Sabri Popaj e identifikoi kufomën e të birit, Shëndet Popajt, me etiketë “CAD/10/SR” (Zona 1), përmes veshjeve dhe fytyrës. Kufomës iu gjet edhe një shishe, e cila bënte të ditur identitetin e tij. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri. Sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, vdekja e viktimës është shkaktuar nga një goditje me armë zjarri në kokë.¹³⁹¹

(25) Vehap Popaj (58-vjeçar, mashkull)

436. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Vehap Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁹² Kufoma me etiketë “CAD/15/SR” (Zona 2)

¹³⁸⁶ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 84–85.

¹³⁸⁷ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 12; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

¹³⁸⁸ Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7–8, T. 5661–5662, 5674 (1 nëntor 2006), T. 5750–5752 (2 nëntor 2006).

¹³⁸⁹ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 74–75.

¹³⁹⁰ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 4; P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 13; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 4–5, 7, T. 5663 (1 nëntor 2006).

¹³⁹¹ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 90–91.

¹³⁹² Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 6. Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

është identifikuar si Vehap Popaj nga kushëriri i tij përmes veshjeve. Kufomës iu gjet edhe një shishe, e cila bënte të ditur identitetin e tij. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁹³

(26) Xhavit Popaj (32-vjeçar, mashkull)

437. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Xhavit Popajn si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹³⁹⁴ Shyrete Popaj e identifikoi kufomën e të birit, Xhavit Popajt, me etiketë “JB-G/39/SR” (Zona 1), përmes veshjeve. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹³⁹⁵

(27) Familja e Xhemal Spahiut

438. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj dëshmuan në sallën gjyqësore se panë vrasjen e familjes së Xhemal Spahiut nga MPB në lumin apo përroin e Bellajës më 26 mars 1999.¹³⁹⁶ Megjithatë, në dëshminë e tyre ka disa mospërputhje: Isuf Zhuniqi dëshmoi se pa vrasjen e “të gjithë anëtarëve” të familjes së Xhemal Spahiut: Xhemal Spahiun, të shoqen, një grua tjetër dhe katër fëmijë të vegjël;¹³⁹⁷ Sabri Popaj dëshmoi se pa me sytë e tij vrasjen e “tetë” anëtarëve të familjes Spahiu, emrat e të cilëve nuk i dinte.¹³⁹⁸ Dhoma do të shqyrtojë vetëm rastet e atyre anëtarëve të familjes Spahiu që janë renditur në Listën B, këtu.

439. Në Listën e Vërtetimeve të Vdekjes, bashkëlidhur Dosjes Përfundimtare Gjyqësore, Prokuroria i ka lidhur emrat Marigona Spahiu, Iliriana Spahiu, Lirim Spahiu, Qamile Spahiu dhe Xhemal Spahiu me dëshminë e Isuf Zhuniqit, e cila jepet e përmbledhur në paragrafin e mësipërm.¹³⁹⁹ Sidoqoftë, duhet theksuar se nuk ka dëshmi gjyqësore të drejtpërdrejtë e cila të tregojë se këta persona janë personat që Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj kanë parë tek janë vrarë në përroin e

¹³⁹³ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 95–96.

¹³⁹⁴ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 6. Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

¹³⁹⁵ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 72–73.

¹³⁹⁶ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 3; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 3, T. 5655–5656 (1 nëntor 2006).

¹³⁹⁷ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 3.

¹³⁹⁸ Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 4, T. 5655–5656 (1 nëntor 2006).

¹³⁹⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), Aneksi C (Bellacërka), f. 5; Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 3.

Bellajës. Sikurse theksohet më lart, asnjëri prej dy dëshmitarëve nuk kanë dhënë emrat e anëtarëve të vrasë të familjes Spahiu. Përrjashtim përbën vetëm Xhemal Spahiu.

440. Në aktekspertizën e Ekipit Mjekoligjor Britanik raportohet se kishte 12 persona të varrosur në Zonën 6 të vendvarrimit BC001 pranë fshatit Bellacërkë. Këqyrja e këtyre trupave është bërë më 3 korrik 1999. Në aktekspertizën e ekipit mjeko-ligjor britanik thuhet se të dymbëdhjetë kanë vdekur nga plagë të shkaktuara me armë zjarri të shpejtësisë së lartë. Shumica e lëndimeve në 12 kufomat ishin në kokë dhe/ose shpinë, ndërsa tre prej tyre kishin lëndime në kraharor.¹⁴⁰⁰ Më vonë, kufomat e zhvarrosura është identifikuar nga Sahit Zhuniqi, i cili kishte varrosur, si Shlirim/Çlirim Zhuniqi, “Lumnig Zhuniqi”, Dardan Zhuniqi, Dhurata Zhuniqi, Dardanë Zhuniqi, Xhemal/Gjermal Spahiu, Qamile Spahiu, Fiqriq Spahiu, Iliriana Spahiu, Labinot Spahiu, Marigioni Spahiu, Lirim Spahiu.¹⁴⁰¹

441. Provat mjeko-ligjore që përmban aktekspertiza e zhvarrimit i mbështesin dëshmitë gjyqësore të Isuf Zhuniqit dhe Sabri Popajt, sipas të cilave personat e renditur në aktekspertizën e zhvarrimit dhe që u përkasin familjeve Zhuniqi dhe Spahiu janë pikërisht personat që këta dy dëshmitarë kanë parë të vriten më 26 mars 1999 në përroin e Bellajës. Akti i zhvarrimit i identifikon viktimat dhe jep emrat e tyre dhe të dhëna të tjera përkatëse. Dhoma konstaton se, në bazë të dëshmisë gjyqësore të ofruar nga Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj dhe nga akti i zhvarrimit, për numrin e viktimave, moshën dhe gjininë e tyre dhe vendin ku janë varrosur dhe janë zhvarrosur më pas, mund të arrihet në përfundimin se Marigona, Iliriana, Lirimi dhe Labinoti kanë qenë katër fëmijët e familjes Spahiu që i kanë parë Isuf Zhuniqi (dhe Sabri Popaj) të vriten në kohën për të cilën bëhet fjalë. Dhoma vëren se emrat “Fiqriq Spahiu” dhe “Labinot Spahiu” nuk ndodhen në Listën B. Rrjedhimisht, këta emra trajtohen, më poshtë, në paragrafët 478-479.

(a) Marigona Spahiu (10-vjeçare, femër)

442. Sahit Zhuniqi e identifikoi kufomën me etiketë ”JB-G/72/SR” (Zona 6) si Marigona Spahiu. Kufomën e saj e kishte varrosur ai.¹⁴⁰² Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën si kufoma i një fëmije femër, afërsisht dhjetëvjeçare. Këqyrja e jashtme zbuloi një plagë në kraharor të shkaktuar me armë zjarri, e cila, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, i ka shkaktuar vdekjen viktimës.¹⁴⁰³

¹⁴⁰⁰ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 107.

¹⁴⁰¹ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 46–47.

¹⁴⁰² P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 47.

¹⁴⁰³ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 105.

(b) Iliriana Spahiu (12-vjeçare, femër)

443. Sahit Zhuniqi e identifikoi kufomën me etiketë "JB-G/70/SR" (Zona 6) si Iliriana Spahiu. Kufomën e saj e kishte varrosur ai.¹⁴⁰⁴ Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën si kufomën e një fëmije femër 12-vjeçare. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri. Sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, vdekja e viktimës është shkaktuar nga plaga që i është shkaktuar me armë zjarri në kraharor.¹⁴⁰⁵

(c) Lirim Spahiu (7-vjeçar, mashkull)

444. Sahit Zhuniqi e identifikoi kufomën me etiketë "JB-G/73/SR" (Zona 6) si Lirim Spahiu. Kufomën e tij e kishte varrosur ai.¹⁴⁰⁶ Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën si kufomën e një fëmije mashkull, afërsisht shtatëvjeçar. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri. Sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, vdekja e viktimës është shkaktuar nga plaga që i është shkaktuar me armë zjarri në kraharor.¹⁴⁰⁷

(d) Qamile Spahiu (69-vjeçare, femër)

445. Sahit Zhuniqi e identifikoi kufomën me etiketë "JB-G/68/SR" (Zona 6) si Qamile Spahiu. Kufomën e saj e kishte varrosur ai.¹⁴⁰⁸ Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën si kufomën një të femër moshuar. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹⁴⁰⁹

(e) Xhemal Spahiu (70-vjeçar, mashkull)

446. Sahit Zhuniqi e identifikoi kufomën me etiketë "JB-G/66/SR" (Zona 6) si Xhemal Spahiu përmes fytyrës. Kufomën e tij e kishte varrosur ai.¹⁴¹⁰ Edhe Isuf Zhuniqi dëshmoi se Xhaml Spahiu u vra.¹⁴¹¹ Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën si një mashkull të moshuar. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri. Sipas aktekspertizës së ekipit

¹⁴⁰⁴ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 47.

¹⁴⁰⁵ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 104.

¹⁴⁰⁶ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 47.

¹⁴⁰⁷ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 105–106.

¹⁴⁰⁸ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 47.

¹⁴⁰⁹ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 102–103.

¹⁴¹⁰ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 47.

¹⁴¹¹ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 3. P2332 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr No. IT-02-54-T), T. 6455.

mjeko-ligjor britanik, vdekja e viktimës është shkaktuar nga plaga që i është shkaktuar me armë zjarri në qafë.¹⁴¹²

(28) Familja e Çlirim Zhuniqit

447. Isuf Zhuniqi tha se ka parë 13 veta të familjeve të Çlirim Zhuniqit dhe Xhemal Spahiut tek janë vrarë nga MPB në përroin e Bellajës më 26 mars 1999: tetë anëtarë të familjes së Çlirim Zhuniqit dhe pesë anëtarë të familjes së Xhemal Spahiut. Nga familja Zhuniqi ka parë të vriten këta persona: Çlirimi, e shoqja, e bija Dardana (8-vjeçare), i biri Dardani (6-vjeçar) dhe “një djalë tjetër” (4-vjeçar) emrin e të cilit nuk e dinte.¹⁴¹³ Ai tha se më vonë zbuloi se djali 2-vjeçar i Çlirimit i mbijetoi ekzekutimit.¹⁴¹⁴

448. Sabri Popaj dëshmoi në sallë të gjyqit se ka parë te përroi, në kohën për të cilën bëhet fjalë, gjithsej 14 njerëz që i përkisnin familjes Zhuniqi dhe familjes Spahiu: gjashtë syresh i përkisnin familjes së Çlirim Zhuniqit dhe tetë persona i përkisnin familjes Spahiu. Nga familja Zhuniqi ka parë të vriten këta persona: babai Çlirimu, nëna Lumturia, dy vajza dhe dy djem.¹⁴¹⁵ Edhe Sabri Popaj ka dëgjuar se një djalë i vogël 2-vjeçar është gjetur gjallë në skenën e vrasjes që e kishte parë vetë.¹⁴¹⁶ Në dëshminë e tij gjyqësore, ai tha se e quanin “Shkodran” dhe se i përkiste familjes së “Arsim Zhuniqit”.¹⁴¹⁷

449. Sikurse thuhet më lart, akti i zhvarrimit identifikon pesë anëtarë të familjes së Çlirim Zhuniqit kufomat e të cilëve janë zhvarrosur në Zonën 6 të vendvarrimit BC001 dhe që janë identifikuar nga Sahit Zhuniqi: Shlirim/Çlirim Zhuniqi, Lumnig Zhuniqi, Dardan Zhuniqi, Dhurata Zhuniqi, Dardane Zhuniqi.¹⁴¹⁸ Krahas Çlirim Zhuniqit dhe bashkëshortes së tij, Isuf Zhuniqi ka parë tek janë vrarë djali i Çlirimit Dardani, e bija Dardana dhe “një djalë tjetër i tij”.¹⁴¹⁹ Nga ana tjetër, Sabri Popaj ka parë tek janë vrarë dy vajza dhe dy djem.¹⁴²⁰ Në bazë të dëshmive gjyqësore të Isuf Zhuniqit dhe Sabri Popajt dhe në bazë të provave mjeko-ligjore që ofron akti i zhvarrimit dhe provat fotografike, Dhoma konstaton se mund të arrihet në përfundimin se Çlirim Zhuniqi, Lumnie Zhuniqi, Dardan Zhuniqi, Dhurata Zhuniqi dhe Dardanë Zhuniqi janë vrarë më 26 mars 1999, sikurse trajtohet më poshtë.

¹⁴¹² P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 101.

¹⁴¹³ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 3.

¹⁴¹⁴ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 3. P2332 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr No. IT-02-54-T), T. 6455.

¹⁴¹⁵ Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 3.

¹⁴¹⁶ Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 5.

¹⁴¹⁷ Sabri Popaj, T. 5650 (1 nëntor 2006).

¹⁴¹⁸ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 46–47.

¹⁴¹⁹ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 3.

¹⁴²⁰ Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 3.

(a) Çlirim Zhuniqi (40-vjeçar, mashkull)

450. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Çlirim Zhuniqin si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹⁴²¹ Sahit Zhuniqi e identifikoi kufomën me etiketë "JB-G/62/SR" si të vëllain, Shlirim Zhuniqin. Kufomën e tij e kishte varrosur ai.¹⁴²² Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri. Sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, vdekja e viktimës është shkaktuar nga plagë të shumta me armë zjarri në shpinë.¹⁴²³

(b) Lumnie Zhuniqi (39-vjeçare, femër)

451. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Lumnie Zhuniqin si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹⁴²⁴ Sahit Zhuniqi e identifikoi kufomën me etiketë "JB-G/63/SR" (Zona 6) si "të motrën", Lumnie Zhuniqin. Kufomën e saj e kishte varrosur ai.¹⁴²⁵ Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën si kufomën e një femre të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri. Sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, vdekja e viktimës është shkaktuar nga plagë të shumta me armë zjarri në kokë dhe shpinë.¹⁴²⁶

(c) Dardan Zhuniqi (6-vjeçar, mashkull)

452. Isuf Zhuniqi e identifikoi Dardan Zhuniqin si njërin prej personave që janë vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹⁴²⁷ Edhe Sabri Popaj dëshmoi në sallën gjyqësore se, mes anëtarëve të tjerë të familjes së Çlirim Zhuniqit, ka parë tek janë vrarë dy bijtë e tij.¹⁴²⁸ Sahit Zhuniqi e identifikoi kufomën me etiketë "JB-G/64/SR" (Zona 6) si nipin e tij, Dardan Zhuniqin. Kufomën e tij e kishte varrosur ai.¹⁴²⁹ Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën si kufomën e një fëmije

¹⁴²¹ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 3. P2332 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr No. IT-02-54-T), T. 6455; P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 18; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 3–4.

¹⁴²² P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 47.

¹⁴²³ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 98–99.

¹⁴²⁴ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 3. P2332 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr No. IT-02-54-T), T. 6455; P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 18; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 3–4.

¹⁴²⁵ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 47.

¹⁴²⁶ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 99.

¹⁴²⁷ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 3. P2332 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr No. IT-02-54-T), T. 6455; P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 20;

¹⁴²⁸ Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 3–4.

¹⁴²⁹ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 47.

mashkull gjashtëvjeçar. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹⁴³⁰

(d) Dardane Zhuniqi (8-vjeçare, femër)

453. Isuf Zhuniqi e identifikoi Dardane Zhuniqin si njërin prej personave që janë vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹⁴³¹ Edhe Sabri Popaj dëshmoi në sallën gjyqësore se, mes anëtarëve të tjerë të familjes së Çlirim Zhuniqit, ka parë tek janë vrarë dy bijat e tij.¹⁴³² Sahit Zhuniqi e identifikoi kufomën me etiketë "JB-G/67/SR" (Zona 6) si mbesën e tij, Dardane Zhuniqin. Kufomën e saj e kishte varrosur ai.¹⁴³³ Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën si kufomën e një fëmije femër për afërsisht të moshës 6- ose 7-vjeçare. Këqyrja e jashtme zbuloi një plagë në kokë të shkaktuar me armë zjarri, e cila, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, ka shkaktuar vdekjen e viktimës.¹⁴³⁴

(e) Dhurata Zhuniqi (9-vjeçare, femër)

454. Isuf Zhuniqi e identifikoi Dhurata Zhuniqin si njërin prej personave që janë vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹⁴³⁵ Megjithatë, emri i saj nuk është në deklaratën e dëshmitarit të Isuf Zhuniqit, ku identifikon personat që ka parë tek janë vrarë në Bellacërkë.¹⁴³⁶ Edhe Sabri Popaj dëshmoi në sallën gjyqësore se, mes anëtarëve të tjerë të familjes së Çlirim Zhuniqit, ka parë tek janë vrarë dy bijat e tij.¹⁴³⁷ Sahit Zhuniqi e identifikoi kufomën me etiketë "JB-G/65/SR" (Zona 6) si mbesën e tij, Dhurata Zhuniqin. Kufomën e saj e kishte varrosur ai.¹⁴³⁸ Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën si kufomën e një fëmije femër për afërsisht të moshës 9- ose 10-vjeçare. Këqyrja e jashtme zbuloi një plagë në pjesën e pasme të kokës të shkaktuar me armë zjarri, e cila, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, ka shkaktuar vdekjen e viktimës.¹⁴³⁹ Sidoqoftë, Dhoma vëren dhe e konsideron të rëndësishme që Dhurata Zhuniqi është përfshirë si një person mashkull katërvjeçar në Listën B të Aktakuzës, mirëpo gjykon se kjo nuk e prek konkluzionin se nëntëvjeçarja Dhurata Zhuniqi u vra gjatë incidentit në fjalë.

¹⁴³⁰ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 100.

¹⁴³¹ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 3; P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 20;

¹⁴³² Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 3–4.

¹⁴³³ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 47.

¹⁴³⁴ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 101–102.

¹⁴³⁵ Isuf Zhuniqi, T. 4104 (27 shtator 2006). P94 (foto të personave të vrarë Bellacërkë, të bëra përpara konfliktit), f. 19;

¹⁴³⁶ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 3.

¹⁴³⁷ Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 3–4.

¹⁴³⁸ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 47.

¹⁴³⁹ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 100–101.

(f) Abedin Zhuniqi (37-vjeçar, mashkull)

455. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Abedin Zhuniqin si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹⁴⁴⁰ Sari Zhuniqi e identifikoi kufomën e të vëllait, Abedin Zhuniqit, me etiketë “JB-G/28/SR” (Zona 1), përmes këpucëve dhe veshjeve. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹⁴⁴¹

(g) Agim Zhuniqi (51-vjeçar, mashkull)

456. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Agim Zhuniqin si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹⁴⁴² Sabri Popaj dëshmoi se e gjeti kufomën e tij dhe e mori me mend se ai ishte njëri prej personave të vrarë nga MPB-ja kur kishte dëgjuar të shtënat në përroin e Bellajës, rreth pesë minuta pasi kishte parë vrasjen e grupit të madh të njerëzve.¹⁴⁴³ Naim Zhuniqi e identifikoi kufomën e të atit, Agim Zhuniqit, me etiketë “JB-G/58/SR” (Zona 5), përmes fytyrës. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹⁴⁴⁴

(h) Bajram Zhuniqi (51-vjeçar, mashkull)

457. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Bajram Zhuniqin si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹⁴⁴⁵ Bashkim Zhuniqi e identifikoi kufomën e kushëririt të tij, Bajram Zhuniqit, me etiketë “JBG/34/SR”, përmes veshjes. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹⁴⁴⁶

¹⁴⁴⁰ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; P94 (foto, të bëra përpara konfliktit, të personave të vrarë Bellacërkë), f. 14; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

¹⁴⁴¹ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 41, 61–62.

¹⁴⁴² Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; P94 (foto, të bëra përpara konfliktit, të personave të vrarë Bellacërkë), f. 15; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 8.

¹⁴⁴³ Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 8. *Shih gjithashtu* Sabri Popaj, T. T. 5661–5662, 5674 (1 nëntor 2006).

¹⁴⁴⁴ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 45, 78–79.

¹⁴⁴⁵ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 maj 1999), f. 5; P94 (foto, të bëra përpara konfliktit, të personave të vrarë Bellacërkë), f. 16; Sabri Popaj, P2446 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 qershor 1999), f. 7.

¹⁴⁴⁶ P97 (Aktekspertiza e zhvarrimit për Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 42, 67–68.

(i) Bilal Zhuniqi (67-vjeçar, mashkull)

458. Isuf Zhuniqi dhe Sabri Popaj e identifikuan Bilal Zhuniqin si njërin prej personave të vrarë në përroin e Bellajës në Bellacërkë, më 26 mars 1999.¹⁴⁴⁷ Kufoma me etiketë “JBG/36/SR” është identifikuar përmes dokumenteve që i janë gjetur në xhep. Ekipi mjeko-ligjor britanik e identifikoi kufomën se i përkiste një mashkulli të rritur. Këqyrja e jashtme zbuloi plagë të shumëfishta të shkaktuara me armë zjarri, të cilat, sipas aktekspertizës së ekipit mjeko-ligjor britanik, kanë shkaktuar vdekjen e viktimës.¹⁴⁴⁸

(j) Destan Zhuniqi (68-vjeçar, mashkull)

¹⁷⁵³ P2486 (Raport i Shërbimit të Biologjisë), f. 5.

¹⁷⁵⁴ P2407 (Aktekspertiza mjeko-ligjore individuale e kufomave nga Batajnica I), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 214–216; P186 (Aktautopsi për Ba-46 dhe Ba-46a).

¹⁷⁵⁵ P2351 (Lista e personave të vrarë/zhdukur në 1998 dhe 1999), f. 1.

¹⁷⁵⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁷⁵⁷ Shyrete Berisha, T. 3905 (25 shtator 2006).

¹⁷⁵⁸ Shyrete Berisha, T. 3869–3872 (25 shtator 2006); P2346 (trungu i familjes Berisha).

¹⁷⁵⁹ P2351 (Lista e personave të vrarë/zhdukur në 1998 dhe 1999), f. 1.

¹⁷⁶⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁷⁶¹ Shyrete Berisha, T. 3869–3871, 3895–3896 (25 shtator 2006); P2346 (trungu i familjes Berisha).

¹⁷⁶² P2282 (deklaratë e dëshmitarit, datë 20 gusht 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 14; P2351 (Lista e personave të vrarë/zhdukur në 1998 dhe 1999), f. 1.

¹⁷⁶³ Halit Berisha, P2326 (deklaratë e dëshmitarit, datë 17 gusht 2001), f. 3.

¹⁷⁶⁴ P136 (Aktekspertiza mjeko-ligjore individuale e kufomave nga Batajnica I); P137 (Aktpërmbledhje antropologjike: SCG/33/SR).

¹⁷⁶⁵ *Shih* Vëllimi 2, shënimi 1372.

identifikim duke qenë se dukej se kishte një mospërputhje në etiketat e këtyre kufomave midis aktekspertizave të përgatitura nga Black dhe aktekspertizës së përgatitur nga Roberts. Megjithatë, duke pasur parasysh se kufoma e Sedatit është identifikuar edhe përmes këpucës së tij, Dhoma është e mendimit se eksperti Baccard ka treguar kujdes të tepruar në këtë çështje, kështu që është e bindur se kufoma në fjalë i përket Sedatit. Shkaku i vdekjes nuk mund të përcaktohej.¹⁷⁶⁶

(36) Sherine Berisha (17-vjeçare, femër)

641. Shyrete Berisha ka dhënë dëshmi gjyqësore se Sherine Berisha ishte e pranishme në piceri më 26 mars 1999.¹⁷⁶⁷ Flora Berisha është përfshirë edhe në listën e Hysni Berishës të personave të zhdukur,¹⁷⁶⁸ si edhe në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur.¹⁷⁶⁹

(37) Sofije Berisha (58-vjeçare, femër)

642. Shyrete Berisha ka dëshmuar se Sofije Berisha ishte e pranishme në piceri më 26 mars 1999.¹⁷⁷⁰ Hysni Berisha i ka identifikuar disa prej sendeve të Sofije Berishës mes sendeve të gjetura në një varr të përbashkët dhe përmend Sofije Berishën si njërin prej personave të zhdukur dhe/ose të vrarë në Suharekë.¹⁷⁷¹ Përmes analizave të ADN-së, Alonso e identifikoi kufomën me etiketë “Ba-32” se i përket Sofije Berishës.¹⁷⁷² Kjo kufomë identifikohet edhe në raportin e KNPZH-së se i përket Sofije Berishës.¹⁷⁷³ Sipas aktekspertizës së Dunjiqit, pjesët e kufomës me etiketë “Ba-31” dhe “Ba-32” i përkasin të njëjtit person me moshë të përafërt 40- deri 56-vjeçare. Shkaku i vdekjes nuk mund të përcaktohej.¹⁷⁷⁴ Sofije Berisha është edhe në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur.¹⁷⁷⁵

(38) Vesel Berisha (61-vjeçar, mashkull)

643. Shyrete Berisha dëshmoi se Vesel Berisha ishte i pranishëm në piceri më 26 mars 1999.¹⁷⁷⁶ Njëri prej sendeve të gjetur në një varr të përbashkët pranë poligonit të qitjes në Prizren është

¹⁷⁶⁶ P1809 (raport i përgjithshëm i Eric Baccard-it), f. 74–78; P2683 (Aktekspertiza Antropologjike: analizë e SCG/33/SR); P136 (Aktekspertiza Antropologjike e Ekipit Mjeko-Ligjor Britanik); P137 (Aktpërmbledhje antropologjike: SCG/33/SR).

¹⁷⁶⁷ Shyrete Berisha, T. 3869–3872 (25 shtator 2006); P2346 (trungu i familjes Berisha).

¹⁷⁶⁸ P2351 (Lista e personave të vrarë/zhdukur në 1998 dhe 1999), f. 1.

¹⁷⁶⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁷⁷⁰ Shyrete Berisha, T. 3869–3872 (25 shtator 2006); P2346 (trungu i familjes Berisha).

¹⁷⁷¹ P133 (Fotografi të ndryshme të sendeve të gjetura në varrin e përbashkët në poligonin e qitjes), KRA/1081 (fotografi e një shapke të Sofije Berishës); P2351 (Lista e personave të vrarë/zhdukur në 1998 dhe 1999), f. 2.

¹⁷⁷² P2486 (Raport i Shërbimit të Biologjisë), f. 4–5.

¹⁷⁷³ P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës) (e mbyllur me vulë), f. 21.

¹⁷⁷⁴ P2407 (Aktekspertiza mjeko-ligjore individuale e kufomave nga Batajnica I), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 172–175; P184 (Aktautopsi për Ba-31 dhe Ba-32); P2394 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 158–161.

¹⁷⁷⁵ P2798 (lista e ZPZHML-së e personave të zhdukur).

identifikuar se i përkiste Vesel Berishës.¹⁷⁷⁷ Përmes analizave të ADN-së, Alonso dhe KNPZH i identifikuan kufomën me etiketë “Ba-22” dhe “Ba-59” se i përket Vesel Berishës.¹⁷⁷⁸ Sipas aktekspertizës së Dunjiqit, kufoma me etiketë “Ba-22” i përket një mashkulli me moshë të përafërt 40- deri në 50-vjeçare, ndërsa shkak i vdekjes nuk mund të përcaktohej.¹⁷⁷⁹ Sa i takon kufomës me etiketë “Ba-59”, ekipi nuk ishte në gjendje ta përcaktonte gjininë dhe as shkakun e vdekjes.¹⁷⁸⁰ Megjithatë, ekipi i ZPZHML-së ishte në gjendje të përcaktonte shkakun e vdekjes, që ishte një plagë me armë zjarri në shtyllën kurrizore.¹⁷⁸¹ Sendet që çuan në identifikimin e Vesel Berishës janë gjetur së bashku me kufomën e tij në Batajnicë.¹⁷⁸² Hysni Berisha e rendit Vesel Berishën si njërin prej personave të zhdukur dhe/ose të vrarë në Suharekë, sikurse renditet edhe në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur.¹⁷⁸³

(39) Vlorjan Berisha (17-vjeçar, mashkull)

644. Shyrete Berisha ka dëshmuar se Vlorjan Berisha ishte i pranishëm në piceri më 26 mars 1999.¹⁷⁸⁴ Vlorjan Berisha është përfshirë edhe në listën e Hysni Berishës të personave të zhdukur,¹⁷⁸⁵ si edhe në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur.¹⁷⁸⁶

(40) Zelihe Berisha (50-vjeçare, femër)

645. Hysni Berisha dëshmoi se Zelihe Berisha u vra në Suharekë.¹⁷⁸⁷ Zelihe Berisha është edhe në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur.¹⁷⁸⁸

¹⁷⁷⁶ Shyrete Berisha, T. 3869–3872 (25 shtator 2006); P2346 (trungu i familjes Berisha).

¹⁷⁷⁷ P133 (Fotografi të ndryshme të sendeve të gjetura në varrin e përbashkët në poligonin e qitjes), KRA/1050 (fotografi e çizmes së Vesel Berishës); Hysni Berisha, P2282 (deklaratë e dëshmitarit, datë 20 gusht 2001), f. 9.

¹⁷⁷⁸ P2486 (Raport i Shërbimit të Biologjisë), f. 5; P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës) (e mbyllur me vulë), f. 20; P2558 (Njoftim për Raportet e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 35.

¹⁷⁷⁹ P2407 (Aktekspertiza mjeko-ligjore individuale e kufomave nga Batajnica I), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 143–148; P182 (Aktautopsi për Ba-22 dhe Ba-59).

¹⁷⁸⁰ P2407 (Aktekspertiza mjeko-ligjore individuale e kufomave nga Batajnica I), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 73–75; P182 (Aktautopsi për Ba-22 dhe Ba-59).

¹⁷⁸¹ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 390.

¹⁷⁸² P151 (Indeksi i fotografive të sendeve identifikuese të Vesel Berishës); P152 (Fotografi të sendeve identifikuese të Vesel Berishës).

¹⁷⁸³ P2351 (Lista e personave të vrarë/zhdukur në 1998 dhe 1999), f. 2; P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁷⁸⁴ Shyrete Berisha, T. 3869–3872 (25 shtator 2006); P2346 (trungu i familjes Berisha).

¹⁷⁸⁵ P2351 (Lista e personave të vrarë/zhdukur në 1998 dhe 1999), f. 2.

¹⁷⁸⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁷⁸⁷ Hysni Berisha, T. 4012 (26 shtator 2006); P122 (Fotografi të ndryshme të sendeve të gjetura në varrin e përbashkët pranë Prizrenit), f. 5, 6; P2351 (Lista e personave të vrarë/zhdukur në 1998 dhe 1999), f. 1.

¹⁷⁸⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

2. Viktimat e papërfshira në Listën D të Aktakuzës (Suharekë)

(1) Genc Berisha (4-vjeçar, mashkull) dhe Granit Berisha (2-vjeçar, mashkull)

646. Shyrete Berisha dëshmoi se Genc dhe Granit Berisha qenë të pranishëm në piceri më 26 mars 1999.¹⁷⁸⁹ Përmes analizës së AND-së, Alonso i identifikoi pjesët e kufomës me etiketë “Ba-34” dhe “Ba-52a” se i përkasin njërit prej të bijve të Besim Berishës, ose Genc Berishës ose Granit Berishës.¹⁷⁹⁰ Sipas aktekspertizës së Dunjiqit, kufoma me etiketë “Ba-52” i përket një fëmijë të moshës katër deri katër vjeç e gjysmë. Ekipi nuk ishte në gjendje ta përcaktonte shkaku e vdekjes.¹⁷⁹¹ Sa i takon etiketës “Ba-34”, ekipi i Dunjiqit konstatoi se i përkiste një fëmijë mashkull, me moshë të përafërt dy ose tre vjeç. Disa prej lëndimeve në kufomë janë shkaktuar nga predha e shkrepur me armë dore ose armë shpërthyes, mirëpo shkaku i vdekjes nuk mund të përcaktohej.¹⁷⁹² Megjithatë, raporti i ZPZHML-së e identifikon shkaku e vdekjes si një plagë e mundshme e shkaktuar me armë zjarri.¹⁷⁹³ Hysni Berisha i përmend të dy si persona të zhdukur dhe/ose të vrarë në Suharekë,¹⁷⁹⁴ dhe ata janë përfshirë edhe në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur.¹⁷⁹⁵

(2) Jashar Berisha (56-vjeçar, mashkull)

647. K83 ka qenë dëshmitar në vrasjen e Jashar Berishës.¹⁷⁹⁶ Shyrete Berisha ka dëshmuar se ka folur me Jashar Berishën më 26 mars 1999 mu përpara incidentit të picerisë.¹⁷⁹⁷ Hysni Berisha ishte në gjendje të identifikonte disa sende të gjetura në një varr të përbashkët se i përkisnin Jashar Berishës dhe, kështu, e përfshiu në listën e tij të personave të zhdukur dhe/ose të vrarë.¹⁷⁹⁸ Vëllai i Jasharit, Halit Berisha, ka dhënë dëshmi të gjerë gjyqësore për lëvizjet dhe zhdukjen e të vëllait më 26 mars 1999 dhe për veshjet e Jasharit, të cilat i njohu më vonë.¹⁷⁹⁹ Përmes analizave të ADN-së,

¹⁷⁸⁹ Shyrete Berisha, T. 3869–3872 (25 shtator 2006); P2346 (trungu i familjes Berisha).

¹⁷⁹⁰ P2486 (Raport i Shërbimit të Biologjisë), f. 7.

¹⁷⁹¹ P2407 (Aktekspertiza mjeko-ligjore individuale e kufomave nga Batajnica I), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 37–40; P173 (Aktautopsi për Ba-52a); P944 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 443–444.

¹⁷⁹² P2407 (Aktekspertiza Mjeko-Ligjore individuale të trupave nga Batajnica I), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 33–36; P172 (Aktautopsi për Ba-34).

¹⁷⁹³ P934 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 386.

¹⁷⁹⁴ P2351 (Lista e personave të vrarë/zhdukur në 1998 dhe 1999), f. 2.

¹⁷⁹⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁷⁹⁶ K83, T. 3959–3961 (26 shtator 2006).

¹⁷⁹⁷ Shyrete Berisha, T. 3898 (25 shtator 2006).

¹⁷⁹⁸ P2282 (deklaratë e dëshmitarit, datë 20 gusht 2001), f. 9; P133 (Fotografi të ndryshme të sendeve të gjetura në varrin e përbashkët në poligonin e qitjes), KRA/1072 (fotografi e tutave sportive të Jashar Berishës); P2351 (Lista e personave të vrarë/zhdukur në 1998 dhe 1999), f. 2. Jashar Berisha është në listën e ZPZHML-së. *Shih* P2798 (lista e ZPZHML-së e personave të zhdukur).

¹⁷⁹⁹ Halit Berisha, T. 3611–3614 (20 shtator 2006); P2326 (deklaratë e dëshmitarit, datë 17 gusht 2001), f. 3; P133 (Fotografi të ndryshme të sendeve të gjetura në varrin e përbashkët në poligonin e qitjes), KRA/1072 (fotografi e tutave sportive të Jashar Berishës).

Alonso dhe KNPZH i identifikuan pjesët e kufomës me etiketë “Ba-11”, “Ba-50” dhe “Ba-55” se i përkasin Jashar Berishës.¹⁸⁰⁰ Sipas aktekspertizës së Dunjiqit, mbetjet skeletore me etiketë “Ba-50” i përkisnin një mashkulli dhe kishin një lëndim të shkaktuar me armë zjarri dore ose mjet shpërthyes, mirëpo shkak i vdekjes nuk mund të përcaktohej.¹⁸⁰¹ Sa i takon etiketës “Ba-55” ekipi nuk mundi ta përcaktonte shkakun e vdekjes.¹⁸⁰² Nuk jepet asnjë hollësi tjetër në lidhje me kufomën me etiketë “Ba-11”, duke qenë se duket se mungon faqja përkatëse e aktekspertizës.

D. SKËNDERAJ

1. Viktimat e përfshira në Listën F të Aktakuzës (Izbicë)

648. Pasi analizoi aktekspertizat e ndryshme Mjeko-ligjore, si edhe dëshminë në sallën gjyqësore të një numri dëshmitarësh të përmendur më lart, Dhoma Gjyqësore ka bërë listën e vet të veçantë të provave mjeko-ligjore që ka në dispozicion për secilën viktimë të renditur në Listën F të Aktakuzës, si dhe për një viktimë të papërfshirë në Listë. Dhoma vëren se ka një sërë mospërputhesh midis provave mjeko-ligjore dhe Aktakuzës sa i takon shkrimit të emrave të disa prej viktimave, si edhe sa i takon shkronjës së parë të emrit të babait. Megjithatë, në shumicën e rasteve, këto mospërputhje janë aq të vogla sa që Dhoma është në gjendje të arrijë në përfundim se të dhënat e caktuara lidhen me viktimën përkatëse. Dhoma vëren gjithashtu se, shpesh, ka një mospërputhje midis moshave të viktimave të pretenduara të renditura në Listën F të Aktakuzës dhe moshave të disa prej viktimave në prova të tjera gjyqësore, siç është lista e ZPZHML-së të personave të zhdukur. Pasi dëgjoi se si është përpiluar kjo listë, Dhoma do të konsiderojë si përfundimtare moshat e dhëna në listën e ZPZHML-së.

(1) Jetullah Alushi (93-vjeçar, mashkull)

649. Jetullah Alushi është përfshirë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli si njëri prej personave të vrarë në Izbicë.¹⁸⁰³ Jetullah Alushi, i moshës 90-vjeçare, është përfshirë në listën e ZPZHML-së si i zhdukur më 28 mars 1999 në Izbicë.¹⁸⁰⁴

(2) Asllan Amrushi ([nuk ka të dhëna për moshën], mashkull)

¹⁸⁰⁰ P2486 (Raport i Shërbimit të Biologjisë), f. 9; P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës) (e mbyllur me vulë), f. 20; P2558 (Njoftim për Raportet e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 35.

¹⁸⁰¹ P2407 (Aktekspertiza mjeko-ligjore individuale e kufomave nga Batajnica I), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 48–51.

¹⁸⁰² P2407 (Aktekspertiza mjeko-ligjore individuale e kufomave nga Batajnica I), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 61–62.

¹⁸⁰³ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

¹⁸⁰⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

650. Asllan Amrushi është përfshirë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli si njëri prej personave të vrarë në Izbicë.¹⁸⁰⁵

(3) Asllan Bajra (60-vjeçar, mashkull)

651. Asllan Bajra është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në pjesën VII.G, më lart, konkretisht, përmes një fotografie të nxjerrë nga videoja e Liri Loshit dhe etiketës së emrit mbi kufomë.¹⁸⁰⁶ Ai është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë edhe në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁰⁷ Kufoma e tij është identifikuar përmes analizës së ADN-së nga ekipi i ekspertëve të KNPZH-së.¹⁸⁰⁸ Asllan Bajra, i moshës 61-vjeçare, përmendet në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur si i zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Kufoma e tij i është kthyer tashmë familjes.¹⁸⁰⁹

(4) Bajram (H) Bajra (62-vjeçar, mashkull)

652. Bajram (H) Bajra është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në seksionin VII.G, më lart, konkretisht, përmes një fotografie të nxjerrë nga videoja e Liri Loshit dhe etiketës së emrit mbi kufomë.¹⁸¹⁰ Bajram Bajra është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë edhe në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸¹¹ Bajram (H) Bajra, i moshës 63-vjeçare, renditet edhe në listën e ZPZHML-së si i zhdukur më 28 mars 1999 në Izbicë.¹⁸¹²

(5) Bajram (C) Bajra (60-vjeçar, mashkull)

653. Bajram (C) Bajra është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸¹³

(6) Bajram (S) Bajra (68-vjeçar, mashkull)

¹⁸⁰⁵ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

¹⁸⁰⁶ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 30. P231 (Fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë), f. 135–136.

¹⁸⁰⁷ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸⁰⁸ P2558 (Njoftim për Raportet e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 32.

¹⁸⁰⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸¹⁰ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 30. P231 (Fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë), f. 137–138.

¹⁸¹¹ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸¹² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸¹³ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

654. Bajram (S) Bajra është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në Seksionin VII.G, më lart, konkretisht, përmes një fotografie të nxjerrë nga videoja e Liri Loshit dhe etiketës së emrit mbi kufomë.¹⁸¹⁴ Ai është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë edhe në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸¹⁵ Kufoma e tij është identifikuar më pas, përmes analizës së ADN-së, nga KNPZH-ja.¹⁸¹⁶ Bajram (S) Bajra, i moshës 68-vjeçare, përmendet në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur si i zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Kufoma e tij i është kthyer tashmë familjes.¹⁸¹⁷

(7) Brahim Bajra (81-vjeçar, mashkull)

655. Brahim Bajra është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në Seksionin VII.G, më lart, konkretisht, përmes një fotografie të nxjerrë nga videoja e Liri Loshit dhe etiketës së emrit mbi kufomë.¹⁸¹⁸ Brahim Bajra, i moshës 80-vjeçare, është përfshirë në listën e ZPZHML-së si i zhdukur më 31 mars 1999 në Izbicë.¹⁸¹⁹

(8) Fazli Bajra (60-vjeçar, mashkull)

656. Fazli Bajra është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në Seksionin VII.G, më lart, konkretisht, përmes një fotografie të nxjerrë nga videoja e Liri Loshit dhe etiketës së emrit mbi kufomë.¹⁸²⁰ Ai është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë edhe në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸²¹ Kufoma e Fazli Bajrës është identifikuar përmes analizës së ADN-së nga KNPZH-ja.¹⁸²² Fazli Bajra, i moshës 62-vjeçare, përmendet edhe në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur si i zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Kufoma e tij i është kthyer tashmë familjes.¹⁸²³

(9) Ilaz Bajra (70-vjeçar, mashkull)

¹⁸¹⁴ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 29. P231 (Fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë), f. 131–132.

¹⁸¹⁵ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸¹⁶ P2558 (Njoftim për Raportet e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 32.

¹⁸¹⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸¹⁸ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 18, 29; P231 (Fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë), f. 127–128.

¹⁸¹⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸²⁰ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 30. P231 (Fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë), f. 133–134.

¹⁸²¹ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸²² P2558 (Njoftim për Raportet e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 32.

¹⁸²³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

657. Ilaz Bajra është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në Seksionin VII.G, më lart, konkretisht, përmes një fotografie të nxjerrë nga videoja e Liri Loshit dhe etiketës së emrit mbi kufomë.¹⁸²⁴ Ai është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë edhe në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸²⁵ Krahas kësaj, Loshi dëshmoi në sallë se e ka parë vetë kufomën e Ilaz Bajrës.¹⁸²⁶ Kufoma e Ilaz Bajrës është identifikuar më pas, përmes analizës së ADN-së, nga KNPZH.¹⁸²⁷ Ilaz Bajra, i moshës 69-vjeçare, përmendet edhe në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur si i zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Kufoma e tij i është kthyer tashmë familjes.¹⁸²⁸

(10) Sami Bajra (19-vjeçar, mashkull)

658. Sami Bajra është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në Seksionin VII.G, më lart, konkretisht, përmes një fotografie të nxjerrë nga videoja e Liri Loshit dhe etiketës së emrit mbi kufomë.¹⁸²⁹ Sami Bajra është përfshirë edhe si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸³⁰ Sami Bajra, i moshës 19-vjeçare, është i regjistruar si i zhdukur edhe në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur.¹⁸³¹ Megjithatë, në deklaratën e tij, Loshi ka thënë se ky person nuk u vra gjatë incidentit të Izbicës më 18 mars 1999.¹⁸³²

(11) Bislim Bajraktari (58-vjeçar, mashkull)

659. Bislim Bajraktari është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸³³ Bislim Bajraktari, i moshës 62 vjeçare, është përfshirë si i zhdukur në listën e ZPZHML-së për personat e zhdukur, ku thuhet se ai është zhdukur në Izbicë më 31 mars.¹⁸³⁴

(12) Hajdar Bajraktari (53-vjeçar, mashkull)

¹⁸²⁴ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 29. P231 (Fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë), f. 129–130.

¹⁸²⁵ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸²⁶ Liri Loshi, T. 5362 (26 tetor 2006).

¹⁸²⁷ P2558 (Njoftim për Raportet e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 32.

¹⁸²⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸²⁹ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 32. P231 (Fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë), f. 163–164.

¹⁸³⁰ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸³¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸³² Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 32.

¹⁸³³ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

¹⁸³⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

660. Hajdar Bajraktari është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸³⁵ Lista e ZPZHML-së të personave të zhdukur e përfshin Brahim Bajrën, i moshës 53-vjeçare, si të zhdukur më 31 mars 1999 në Izbicë.¹⁸³⁶ Kufoma e tij është identifikuar tashmë nga ZPZHML dhe i është kthyer familjes.¹⁸³⁷ Së fundi, varri i njërit prej trupave të zvarrosur në Izbicë nga ekipi i SPB-së së Mitrovicës është shënuar me emrin Hajdar Bajraktari.¹⁸³⁸

(13) Demush Behrami (63-vjeçar, mashkull)

661. Demush Behrami është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸³⁹ Sipas listës së ZPZHML-së të personave të zhdukur, Demush Behrami, i moshës 66-vjeçare, është zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999.¹⁸⁴⁰

(14) Muhamet Behrami (61-vjeçar, mashkull)

662. Muhamet Behrami është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁴¹ Sipas njërit prej raporteve të KNPZH-së, kufoma e gjetur në Petrovo Sello dhe me etiketë “PSII-27” është identifikuar përmes analizës së ADN-së se i përket Muhamet Behramit.¹⁸⁴² Kufomës i është bërë një autopsi nga ekspertë mjekoligjorë të Institutit Mjekoligjor të Nishit. Në aktautopsi thuhet se kufoma i përkiste një burri 50- deri 55-vjeçar, vdekja e të cilit ishte shkaktuar nga një predhë e shkrepur nga armë zjarri dore.¹⁸⁴³ Raporti i ZPZHML-së konfirmon konstatimin se shkak i vdekjes ka qenë një plagë në kraharror e shkaktuar me armë zjarri.¹⁸⁴⁴ Muhamet Behrami, i moshës 61-vjeçare, përmendet në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur si i zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Kufoma e tij i është kthyer tashmë familjes.¹⁸⁴⁵

(15) Nuredin Behrami (76-vjeçar, mashkull)

663. Nuredin Behrami është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të

¹⁸³⁵ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸³⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸³⁷ P2558 (Njoftim për Raportet e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 32.

¹⁸³⁸ 6D116 (Raport i MPB-së për këqyrjen e vendngjarjes në Izbicë, 2 qershor 1999), f. 6.

¹⁸³⁹ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

¹⁸⁴⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁴¹ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

¹⁸⁴² P2558 (Njoftim për Aktekspertizat e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 33. *Shih gjithashtu* P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6.

¹⁸⁴³ P2606 (Aktautopsi për PS/II-27), f. 4–5.

¹⁸⁴⁴ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 361.

përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁴⁶ Sipas listës së ZPZHML-së të personave të zhdukur, Nuredin Behrami, i moshës 80-vjeçare, është zhdukur në Izbicë më 28 mars 1999.¹⁸⁴⁷

(16) Asllan Dajaku (63-vjeçar, mashkull)

664. Asllan Dajaku është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁴⁸

(17) Dibran (H) Dani (67-vjeçar, mashkull)

665. Dibran (H) Dani është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁴⁹ Sipas njërit prej raporteve të KNPZH-së, është konstatuar përmes analizës së ADN-së se kufoma e gjetur në Petrovo Sello me etiketë “PS/II-20” i përket Dibran (Haxhi) Danit.¹⁸⁵⁰ Kjo kufomë është analizuar edhe nga anëtarët e ekipit mjekoligjor të Nishit dhe është konstatuar se i përkiste një burri të moshës 55- deri 60-vjeçare i cili kishte pasur një vdekje të dhunshme nga një lëndim i kokës i shkaktuar nga një predhë e shkrepur me armë zjarri dore.¹⁸⁵¹ Pas identifikimit të kësaj kufome, është lëshuar nga autoritetet serbe certifikata e vdekjes me emër “Dibran (Haxhi) Pani”.¹⁸⁵² Dibran (Haxhi) Dani, i moshës 67-vjeçare, përmendet në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur si i zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Kufoma e tij i është kthyer tashmë familjes.¹⁸⁵³

(18) Sali Dervishi (61-vjeçar, mashkull)

666. Sali Dervishi është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në Seksionin VII.G, më lart, konkretisht, përmes një fotografie të nxjerrë nga videoja e Liri Loshit dhe etiketës së emrit mbi kufomë.¹⁸⁵⁴ Sali Dervishi është përfshirë edhe si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁵⁵ Sali Dervishi, i moshës 59-vjeçare, regjistrohet në

¹⁸⁴⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁴⁶ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

¹⁸⁴⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁴⁸ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸⁴⁹ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

¹⁸⁵⁰ P2558 (Njoftim për Aktekspertizat e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 38. Shih edhe P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6.

¹⁸⁵¹ P224 (Aktautopsi për PS/II-20).

¹⁸⁵² P223 (Certifikata e vdekjes për Dibran Panin).

¹⁸⁵³ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁵⁴ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 32. P231 (Fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë), f. 159–160.

¹⁸⁵⁵ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur si i zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Në listë thuhet se Kufoma e tij i është kthyer tashmë familjes.¹⁸⁵⁶

(19) Bajram Dervishi (73-vjeçar, mashkull)

667. Bajram Dervishi është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në Seksionin VII.G, më lart, konkretisht, përmes videos të Liri Loshit.¹⁸⁵⁷ Ai është përfshirë edhe si një prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁵⁸ Sipas njërit prej raporteve të KNPZH-së, analiza e ADN-së ka treguar se kufoma e gjetur në Petrovo Sello me etiketë “PSII-30” është e Bajram Dervishit.¹⁸⁵⁹ Kjo kufomë analizuar edhe nga anëtarët e ekipit mjekoligjor të Nishit dhe është konstatuar se i përket një burri të moshës 50- deri 55-vjeçare i cili kishte pasur një vdekje të dhunshme, me një lëndim të kokës të shkaktuar nga një predhë e shkrepur nga armë zjarri dore.¹⁸⁶⁰ Ky shkak i vdekjes është konfirmuar nga ekipi mjekoligjor i ZPZHML-së.¹⁸⁶¹ Bajram Dervishi, i moshës 73-vjeçare, është përfshirë në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur si i zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Kufoma e tij është kthyer tashmë.¹⁸⁶²

(20) Ilaz Dervishi (73-vjeçar, mashkull)

668. Ilaz Dervishi është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në Seksionin VII.G, më lart, konkretisht, përmes një fotografie të nxjerrë nga videoja e Liri Loshit dhe etiketës së emrit mbi kufomë.¹⁸⁶³ Ai është përfshirë edhe si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁶⁴ Ilaz Dervishi, i moshës 72-vjeçare, është përfshirë në listën e ZPZHML-së si i zhdukur më 31 mars 1999 në Izbicë.¹⁸⁶⁵

(21) Musli Doçi (63-vjeçar, mashkull)

669. Musli Doçi është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁶⁶ Sipas njërit prej raporteve të KNPZH-së, është konstatuar,

¹⁸⁵⁶ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁵⁷ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 18.

¹⁸⁵⁸ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

¹⁸⁵⁹ P2558 (Njoftim për Raportet e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 38.

¹⁸⁶⁰ P2431 (Aktautopsi për PS/II-30).

¹⁸⁶¹ P943 (Raportet e ZPZHML-së), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 362.

¹⁸⁶² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁶³ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 32. P231 (Fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë), f. 165–166.

¹⁸⁶⁴ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸⁶⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁶⁶ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

përmes analizës së ADN-së, se kufoma me etiketë “FHG-05-006B” e përket “Musli (Sejdi) Doqi”.¹⁸⁶⁷ Musli Doqi, i moshës 62-vjeçare, përmendet në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur si i zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Kufoma e tij i është kthyer tashmë familjes.¹⁸⁶⁸

(22) Hamdi Doqi (42-vjeçar, mashkull)

670. Hamdi Doqi është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në Seksionin VII.G, më lart, konkretisht, përmes videos të Liri Loshit.¹⁸⁶⁹ Hamdi Doqi është përfshirë edhe si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁷⁰ Hamdi Doqi, i moshës 43-vjeçare, përmendet në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur si i zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Kufoma e tij i është kthyer tashmë familjes.¹⁸⁷¹

(23) Ali Draga (65-vjeçar, mashkull)

671. Mustafa Draga e identifikoi Ali Dragën si njërin prej burrave në grupin e tij që ishin marrë dhe ekzekutuar më 28 mars 1999.¹⁸⁷² Ali Draga është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁷³ Krahas kësaj, ai është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në pjesën VII.G, konkretisht, përmes një fotografie të nxjerrë nga videoja e Liri Loshit dhe etiketës së emrit mbi kufomë.¹⁸⁷⁴ Sipas aktautopsive të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, të përpiluara nga Dr. Gordana Tomasheviq, njëri prej trupave që i janë nënshtruar autopsisë kishte dokumente që identifikonin si “Alija Dragaj” dhe mbante edhe veshjet që mund të shihen në videon e Liri Loshit.¹⁸⁷⁵ Në të vërtetë, varri i njërit prej trupave të zhvarrosur në Izbicë nga ekipi i SPB-së së Mitrovicës ishte shënuar me emrin “Alija Dragaj”, i moshës 57-vjeçare.¹⁸⁷⁶ Sipas njërit prej raporteve të KNPZH-së, është konstatuar, përmes analizës së ADN-së, se kufoma me etiketë “FHG-051-006B” i përket Ali (Zymer) Dragës.¹⁸⁷⁷ Së fundi, Ali Draga, i moshës

¹⁸⁶⁷ P2558 (Njoftim për Raportet e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 39.

¹⁸⁶⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁶⁹ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 24.

¹⁸⁷⁰ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸⁷¹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁷² Mustafa Draga, P2244 (deklaratë e dëshmitarit, datë 13 nëntor 1999), f. 4.

¹⁸⁷³ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸⁷⁴ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 30. P231 (Fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë), f. 143–144.

¹⁸⁷⁵ P248 (aktautopsitë e Gordana Tomasheviqit), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 306–309.

¹⁸⁷⁶ 6D116 (Raport i MPB-së për këqyrjen e vendngjarjes në Izbicë, 2 qershor 1999), f. 6.

¹⁸⁷⁷ P2558 (Njoftim për Raportet e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 39.

57-vjeçare, përmendet në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur si i zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Kufoma e tij i është kthyer tashmë familjes.¹⁸⁷⁸

(24) Cen Draga (68-vjeçar, mashkull)

672. Mustafa Draga e identifikoi Cen Dragën si njërin prej burrave në grupin e tij të cilët janë marrë dhe ekzekutuar më 28 mars 1999.¹⁸⁷⁹ Cen Draga është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁸⁰ Krahas kësaj, Cen Draga është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në pjesën VII.G, konkretisht, përmes një fotografie të nxjerrë nga videoja e Liri Loshit dhe etiketës së emrit mbi kufomë.¹⁸⁸¹ Së fundi, Cen Draga, i moshës 69-vjeçare, përmendet në listën e ZPZHML-së si i zhdukur më 31 mars 1999 në Izbicë.¹⁸⁸²

(25) Hajriz Draga (43-vjeçar, mashkull)

673. Mustafa Draga dëshmoi në gjyq për mënyrën se si ka vdekur më 28 mars 1999 Hajriz Draga.¹⁸⁸³ Hajriz Draga është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁸⁴ Krahas kësaj, ai është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në pjesën VII.G, konkretisht, përmes një fotografie të nxjerrë nga videoja e Liri Loshit dhe etiketës së emrit mbi kufomë.¹⁸⁸⁵ Sipas njërit prej raporteve të KNPZH-së, është konstatuar, pasi është bërë analiza e ADN-së, se kufoma me etiketë “FHH 14/001B” i përket Hajriz Dragës.¹⁸⁸⁶ Së fundi, Hajriz Draga, i moshës 44-vjeçare, përmendet në listën e ZPZHML-së si i zhdukur më 31 mars 1999 në Izbicë. Kufoma e tij i është kthyer tashmë familjes.¹⁸⁸⁷

¹⁸⁷⁸ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁷⁹ Mustafa Draga, P2244 (deklaratë e dëshmitarit, datë 13 nëntor 1999), f. 4.

¹⁸⁸⁰ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸⁸¹ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 30. P231 (Fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë), f. 141–142.

¹⁸⁸² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁸³ Mustafa Draga, T. 2356–2357 (25 gusht 2006); P2244 (deklaratë e dëshmitarit, datë 13 nëntor 1999), f. 4.

¹⁸⁸⁴ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸⁸⁵ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 31. P231 (Fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë), f. 148–49.

¹⁸⁸⁶ P2558 (Njoftim për Raportet e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 39.

¹⁸⁸⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

(26) Ismet Draga (31-vjeçar, mashkull)

674. Mustafa Draga e identifikoi Ismet Dragën si njërin prej burrave në grupin e tij, të cilët janë marrë më 28 mars 1999 dhe janë ekzekutuar në Izbicë.¹⁸⁸⁸ Ismet Draga është përfshirë edhe si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁸⁹ Së fundi, Ismet Draga, i moshës 31-vjeçare, është përfshirë në listën e ZPZHML-së si i zhdukur më 31 mars 1999 në Izbicë.¹⁸⁹⁰

(27) Murat Draga (68-vjeçar, mashkull)

675. Mustafa Draga e identifikoi Murat Dragën si njërin prej burrave në grupin e tij të cilët janë ekzekutuar më 28 mars 1999 në Izbicë.¹⁸⁹¹ Murat Draga është përfshirë edhe si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁹² Krahas kësaj, ai është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në pjesën VII.G, konkretisht, përmes një fotografie të nxjerrë nga videoja e Liri Loshit dhe etiketës së emrit mbi kufomë.¹⁸⁹³ Sipas njërës prej raporteve të KNPZH-së, është konstatuar përmes analizës së ADN-së se kufoma me etiketë “FHG-38-001B” i përket Murat Dragës.¹⁸⁹⁴ Së fundi, Murat Draga, i moshës 64-vjeçare, është përfshirë në listën e ZPZHML-së si i zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Kufoma e tij i është kthyer tashmë familjes.¹⁸⁹⁵

(28) Rahim Draga (70-vjeçar, mashkull)

676. Dhoma nuk ka marrë asnjë provë mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të pretenduar.

(29) Rrustem Draga (81-vjeçar, mashkull)

677. Mustafa Draga e identifikoi Rrustem Dragën si njërin prej burrave në grupin e tij të cilët janë ekzekutuar më 28 mars 1999.¹⁸⁹⁶ Rrustem Draga është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁸⁹⁷ Krahas kësaj, ai është identifikuar përmes procedurës që përshkruhet në pjesën VII.G, konkretisht, përmes një fotografie të

¹⁸⁸⁸ Mustafa Draga, P2244 (deklaratë e dëshmitarit, datë 13 nëntor 1999), f. 4.

¹⁸⁸⁹ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸⁹⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁹¹ Mustafa Draga, P2244 (deklaratë e dëshmitarit, datë 13 nëntor 1999), f. 4.

¹⁸⁹² Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁸⁹³ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 30. P231 (Fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë), f. 145.

¹⁸⁹⁴ P2558 (Njoftim për Raportet e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 39.

¹⁸⁹⁵ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁸⁹⁶ Mustafa Draga, P2244 (deklaratë e dëshmitarit, datë 13 nëntor 1999), f. 4.

¹⁸⁹⁷ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

nxjerrë nga videoja e Liri Loshit dhe etiketës së emrit mbi kufomë.¹⁸⁹⁸ Së fundi, Rustem Draga, i moshës 80-vjeçare, përmendet në listën e ZPZHML-së si i zhdukur më 31 mars 1999 në Izbicë.¹⁸⁹⁹

(30) Zade Dragaj (71-vjeçar, mashkull)

678. Mustafa Draga dëshmoi se kishte parë kufomën e një femre me emrin Zade Dragaj e cila ishte “vlarë gjatë rrugës”.¹⁹⁰⁰ Zade Alushi është përfshirë si njëri prej personave të vlarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁹⁰¹ Sipas njërit prej raporteve të KNPZH-së, kufoma e gjetur në Petrovo Sello me etiketë “PS/II-29” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se i përket Zade Dragës.¹⁹⁰² Kufomës i është bërë autopsia nga ekspertë mjekoligjorë të Institutit Mjekoligjor të Nishit. Në aktautopsi thuhet se kufoma i përkiste një femre 55- deri 60-vjeçare, vdekja e së cilës ishte shkaktuar nga një predhë e shkrepur nga armë zjarri dore.¹⁹⁰³ Së fundi, Zade Draga është përfshirë në listën e ZPZHML-së si e zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Kufoma e saj i është kthyer tashmë familjes.¹⁹⁰⁴ Duke pasur parasysh se të gjitha provat mjeko-ligjore tregojnë faktin se Zade Draga ishte femër, duket se Aktakuza e ka renditur gabimisht këtë person si mashkull.

(31) Avdullah Duraku (55-vjeçar, mashkull)

679. Avdullah Duraku është përfshirë si njëri prej personave të vlarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁹⁰⁵ Sipas njërit prej raporteve të KNPZH-së, kufoma me etiketë “FLP10/001B” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se i përket Avdullah Durakut të moshës 55-vjeçare.¹⁹⁰⁶ Krahas kësaj, Avdullah Duraku, i moshës 45-vjeçare, përmendet në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur si i zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Kufoma e tij i është kthyer familjes.¹⁹⁰⁷

¹⁸⁹⁸ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 30. P231 (Fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë), f. 139–140.

¹⁸⁹⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁹⁰⁰ Mustafa Draga, T. 2360 (25 gusht 2006).

¹⁹⁰¹ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁹⁰² P2558 (Njoftim për Aktekspertizat e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 39. Shih edhe P2559 (Shtojcë e Aktekspertizës) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6.

¹⁹⁰³ P2607 (Aktautopsi për PS/II-29), f. 6. *Shih gjithashtu* P943 (Raportet e ZPZHML-së) dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 441, i cili është një aktautopsi për mbetjet trupore me etiketë PS/II-29 dhe i cili thotë se shkaku i vdekjes ka qenë një plagë me armë zjarri në kokë dhe në trung.

¹⁹⁰⁴ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁹⁰⁵ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

¹⁹⁰⁶ P2558 (Njoftim për Raportet e ADN-së) (e mbyllur me vulë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 39.

¹⁹⁰⁷ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

(32) Bel (A) Duraku (81-vjeçar, mashkull)

680. Bel (A) Duraku është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁹⁰⁸ Bel (A) Duraku, i moshës 71-vjeçare, është renditur gjithashtu si i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur, mirëpo thuhet se ai është zhdukur në Burojë.¹⁹⁰⁹ Dhoma vëren mospërputhjen në moshat midis viktimës së pretenduar në Aktakuzë dhe viktimës së përfshirë në listën e ZPZHML-së, si edhe faktin se i dyti nuk është regjistruar si i zhdukur në Izbicë. Krahas kësaj, lista e ZPZHML-së e regjistron rastin e këtij personi si të mbyllur duke qenë se nuk kishte të dhëna të mjaftueshëm në dispozicion.

(33) Dibran Duraku (65-vjeçar, mashkull)

681. Dibran Duraku, i moshës 67-vjeçare, regjistrohet si i zhdukur në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur, si i zhdukur në Burojë. Lista e ZPZHML-së gjithashtu e regjistron rastin e këtij personi si të mbyllur duke qenë se nuk kishte të dhëna të mjaftueshëm në dispozicion.¹⁹¹⁰

(34) Rexhë Duraku (87-vjeçar, mashkull)

682. Rexhë Duraku është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁹¹¹ Sipas listës së ZPZHML-së të personave të zhdukur, kufoma me etiketë “PSII-2” dhe “PSII-6” është identifikuar përmes analizës së ADN-së se i përket Rexhë Durakut, i cili është zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Lista thotë gjithashtu se kjo kufomë i është kthyer tashmë familjes.¹⁹¹² Aktekspertizat Mjeko-ligjore që lidhen me kufomën arrijnë në përfundimin se ajo i përket një mashkulli 178 deri në 183 cm të gjatë dhe se frakturat e shumëfishta të eshtrave, sidomos të eshtrave të kafkës, janë shkaktuar me një mjet të fortë, çka tregon një vdekje të dhunshme.¹⁹¹³

(35) Muhamat Emra ose Muhamet Kadriu (56-vjeçar, mashkull)

683. Muhabet (K) Emra është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁹¹⁴ Sipas Prokurorisë, kufoma me etiketë “PSII-46” i

¹⁹⁰⁸ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

¹⁹⁰⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁹¹⁰ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁹¹¹ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

¹⁹¹² P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁹¹³ P2419 (Aktautopsi për PS/II-2), f. 7–10. P2604 (Aktautopsi për PS/II-6).

¹⁹¹⁴ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

përket Muhamet Emrës/Muhamet Kadriut.¹⁹¹⁵ Aktekspertiza Mjeko-ligjore që lidhet me këtë kufomë thotë se ajo i përket një mashkulli të moshës 40- deri 50-vjeçare, dhe se vdekja e tij ka shumë të ngjarë të jetë shkaktuar nga një predhë ose nga copëza të shpërndara nga një mjet shpërthyes.¹⁹¹⁶ Muhamet (Kadri) Emra, i moshës 60-vjeçare, është përfshirë edhe në listën e ZPZHML-së si i zhdukur më 31 mars 1999 në Izbicë.¹⁹¹⁷ Mirëpo, të dhënat në listë nuk e lidhin këtë emër me kufomën me etiketë “PSII-46” dhe Dhoma nuk është në gjendje të kuptojë nga aktekspertiza mjeko-ligjore nëse ajo është e Muhamet (K) Emrës. Në aktekspertizë thjesht përmendet fakti se analiza e ADN-së nuk është kryer ende. Rrjedhimisht, Dhoma mbetet e paqartë se si ka mundur Prokuroria t’a lidhë këtë kufomë me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(36) Lah Fetahu (67-vjeçar, mashkull)

684. Lah Fetahu është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁹¹⁸ Një person me këtë emër renditet edhe në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur, se është zhdukur në Turiçec. Duket se rasti i tij është mbyllur për mungesë informacioni.¹⁹¹⁹ Sipas Prokurorisë, kufoma me etiketë “PSII-33” i përket Hajrullah Fetahut.¹⁹²⁰ Në aktekspertizën Mjeko-ligjore që lidhet me këtë kufomë thuhet se ajo i përket një mashkulli të moshës 50- deri 55-vjeçare, dhe se vdekja e tij ka shumë të ngjarë të ketë qenë e dhunshme e shkaktuar nga një predhë e shkrepur nga armë zjarri dore.¹⁹²¹ Megjithatë, informacioni në listën e ZPZHML-së nuk e lidh këtë emër me kufomën me etiketë “PSII-46”, por thotë vetëm se ky rast është mbyllur për mungesë informacioni. Krahas kësaj, Dhoma nuk ishte në gjendje të konkludonte nga aktekspertiza Mjeko-ligjore se kjo kufomë me etiketë “PS/II-33” është në të vërtetë e Lah Fetahut. Në aktekspertizë thjesht përmendet fakti se analiza e ADN-së nuk është kryer ende. Rrjedhimisht, Dhoma mbetet e paqartë se si ka mundur Prokuroria t’i lidhë këtë kufomë me këtë viktimë të përfshirë në listë.

(37) Ibrahim Gashi (70-vjeçar, mashkull)

685. Dhoma nuk ka marrë asnjë provë mjeko-ligjore në lidhje me këtë viktimë të supozuar.

¹⁹¹⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), Aneksi C (Izbicë), f. 3;

¹⁹¹⁶ P2611 (Aktautopsi për PS/II-46).

¹⁹¹⁷ P2798 (lista e ZPZHML-së për personat e zhdukur).

¹⁹¹⁸ Liri Loshi, P2436 (paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁹¹⁹ P2798 (lista e personave të zhdukur e ZPZHML-së).

¹⁹²⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), Aneksi C (Izbicë), f. 3;

¹⁹²¹ P2608 (Aktautopsi për PS/II-33).

(38) Ramë Gashi ([nuk ka të dhëna për moshën], mashkull)

686. Sipas njërit prej raporteve të KNPZH-së, kufoma me etiketë “PS/II-12” është identifikuar përmes analizave të ADN-së se i përket Ramë Gashit, i moshës 54-vjeçare.¹⁹²² Ramë Gashi, i moshës 54-vjeçare, është përfshirë në listën e ZPZHML-së si i zhdukur në Izbicë më 31 mars 1999. Kufoma e tij i është kthyer tashmë familjes.¹⁹²³ Megjithatë, Dhoma nuk e ka marrë aktautopsinë në lidhje me këtë person dhe nuk ka asnjë të dhëna në lidhje me moshën e tij. Krahas kësaj, nuk ka asnjë dëshmi gjyqësore nga dëshmitarë okularë përpara Dhomës që e lidhë këtë person me vendin e vrasjes në Izbicë, në kohën në fjalë.

(39) Halil Hajdari (50-vjeçar, mashkull)

687. Halil Hajdari është përfshirë si njëri prej personave të vrarë në Izbicë në një listë të përgatitur nga Liri Loshi dhe Afrim Xhemajli.¹⁹²⁴ Halil (Q) Hajdari, i moshës 63-vjeçare, është përfshirë edhe në listën e ZPZHML-së të personave të zhdukur, si i zhdukur më 28 mars 1999 në Izbicë.¹⁹²⁵

(40) Mehmet Hajra (65-vjeçar, mashkull)

²³⁵⁴ P333 (Aktekspertizë e këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Misioni Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 1), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 7; P331 (Aktekspertizë e këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Misioni Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 2), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 4–6; P332 (Aktatopsi të Misionit Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 2), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 2–5.

²³⁵⁵ Sabit Kadriu, P2377 (deklaratë e dëshmitarit, datë 10 dhjetor 2000), f. 21–24.

²³⁵⁶ P333 (Aktekspertizë e këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Misioni Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 1), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 7; P332 (Aktatopsi të Misionit Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 2), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 101–104; P331 (Aktekspertizë e këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Misioni Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 2), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 62–64.

²³⁵⁷ Sabit Kadriu, P2377 (deklaratë e dëshmitarit, datë 10 dhjetor 2000), f. 21–24.

²³⁵⁸ P333 (Aktekspertizë e këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Misioni Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 1), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 8; P331 (Aktekspertizë e këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Misioni Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 2), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 83–85; P332 (Aktatopsi të Misionit Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 2), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 134–137.

(103) Naser Zhegrova (34-vjeçar, mashkull)

871. Sabit Kadriu ka mbledhur të dhëna për këtë viktimë gjatë një hetimi që ka kryer në Studime të Epërme.²³⁵⁹ Krahas kësaj, misioni mjeko-ligjor francez konstatoi se Naser Zhegrova ka vdekur si pasojë e një plage të tejprërtejshme në kafkë të shkaktuar me armë zjarri nga afërsia.²³⁶⁰

2. Viktimat e papërfshira Listën I të Aktakuzës (Studime e Epërme)

(1) Miran Xhafa (mashkull)

872. Dhoma dëgjoi nga Fedrije Xhafa se i ati, Miran Xhafa, një viktimë që nuk ndodhet në Listën I, u vra nga forcat paraushtarake ose policore serbe më 2 maj 1999, kur po udhëtonte në kolonë.²³⁶¹ Krahas kësaj, mision mjeko-ligjor francez konkludon se Miran Xhafa ka vdekur si pasojë e një plage të tejprërtejshme në kafkë të shkaktuar me armë zjarri nga afërsia.²³⁶²

F. KAÇANIK

1. Viktimat e përfshira në Listën K të Aktakuzës (Kotlinë)

873. Dhoma vëren se ka një sërë mospërputhjesh midis provave mjeko-ligjore dhe Aktakuzës sa i takon shkrimin të emrave të disa prej viktimave të renditur në Listën K (Kotlinë). Megjithatë, në shumicën e rasteve, këto mospërputhje janë kaq të vogla sa që Dhoma është në gjendje të konkludojë se të dhënat e caktuara lidhen me viktimë përkatëse.

(1) Idriz Kuqi (55-vjeçar, mashkull)

874. Hazbi Loku ka parë në oborrin e Liman Lokut në Kotlinë kufomën e vdekur të Idriz Kuqit, me një plagë në pjesën e pasme të kokës të shkaktuar me armë zjarri.²³⁶³ Kufoma e Idriz Kuqit është

²³⁵⁹ Sabit Kadriu, P2377 (deklaratë e dëshmitarit, datë 10 dhjetor 2000), f. 21–24.

²³⁶⁰ P333 (Aktekspertizë e këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Misioni Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 1), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 7; P332 (Aktautopsi të Misionit Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 2), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 47–49; P331 (Aktekspertizë e këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Misioni Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 2), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 33–34.

²³⁶¹ Fedrije Xhafa, P2274 (deklaratë e dëshmitarit, datë 29 gusht 2006), para. 8.

²³⁶² P333 (Aktekspertizë e këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Misioni Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 1), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 8; P331 (Aktekspertizë e këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Misioni Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 2), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 81–82; P332 (Aktautopsi të Misionit Mjeko-Ligjor Francez, Studime e Epërme, Vol. 2), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 130–133.

²³⁶³ Hazbi Loku, P2296 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 qershor 1999), f. 5.

zhvarrosur nga oborri i brendshëm i xhamisë së Kotlinës.²³⁶⁴ Në aktekspertizën e ekipit mjeko-Ligjor austriak, Idriz Kuqit i është vënë etiketa “Kufoma 24” dhe si shkak i vdekjes evidentohen plagët në të djathtë të gjoksit të shkaktuar me armë zjarri.²³⁶⁵ Dr. Zoran Stankoviq, specialist mjeko-ligjor, thekson në aktekspertizën e tij se dëshmia e Lokut në lidhje me vendin e plagës nuk konfirmohet nga aktekspertiza mjeko-ligjore.²³⁶⁶

(2) Ismail Kuqi (21-vjeçar, mashkull)

875. Hazbi Loku e përmendi emrin e Ismail Kuqit, duke e identifikuar nga fotografitë, si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²³⁶⁷ Vebi Kuqi e identifikoi kufomën e kushëririt të tij, Ismail Kuqit, me etiketë “Kufoma 13” përmes veshjes pas konsultimit me të ëmën e të vdekurit.²³⁶⁸ Në aktekspertizën austriake evidentohen plagë të shumta të shkaktuara me armë zjarri dhe thuhet se kafka e viktimës është shkatërruar me gjasë si pasojë e shpërthimit.²³⁶⁹ Në aktekspertizën e tij, Stankoviqi thotë në lidhje me këtë kufomë se është gjetur e shtrirë përmbys me një plagë shpërthimi në zonën e sjetullës së majtë. Ai konkludon se plaga është shkaktuar jashtë pusit dhe shpjegon se nëse kufoma do të kishte qenë në pus përpara se të hidhej mjeti shpërthyes në të atëherë do të ishte e logjikshme që lëndimet të ishin në pjesën e pasme dhe jo në pjesën e përparme, po të mbahet parasysh pozicioni në të cilin janë gjetur kufomat.²³⁷⁰

(3) Nexhad Kuqi (31-vjeçar, mashkull)

876. Hazbi Loku e identifikoi Nexhad Ferid Kuçin nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²³⁷¹ Vebi Kuqi e identifikoi kufomën e kushëririt të tij, Nexhad Kuqit, me etiketë “Kufoma 8”, përmes veshjes dhe formës së shputës së këmbës së djathtë.²³⁷² Në aktekspertizën austriake evidentohen gjurmë shpërthimi dhe zjarri në kufomë dhe thuhet se mungon pjesa më e madhe e kufomat.²³⁷³ Stankoviq dëshmoi në gjyq se në aktekspertizën austriake duhej evidentuar dhe paraqitur më me hollësi fakti se kishte plagë edhe në pjesët e tjera të mbetura të kufomat, edhe pse mungonte pjesa më e madhe e kufomat.²³⁷⁴ Ai arriti edhe në përfundimin se nëse

²³⁶⁴ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 38–39.

²³⁶⁵ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 39.

²³⁶⁶ Zoran Stankoviq, T. 26164, 24166 (14 maj 2008); 6D670 (Aktekspertizë e Dr. Stankoviqit), para. 19.

²³⁶⁷ Hazbi Loku, T. 3164 (11 shtator 2006); P380 (24 fotografi të paraqitura nga Hazbi Loku), f. 5.

²³⁶⁸ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 25.

²³⁶⁹ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 25.

²³⁷⁰ Zoran Stankoviq, T. 26150 (14 maj 2008); 6D670 (Aktekspertizë e Dr. Stankoviqit), para. 8.

²³⁷¹ Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 3.

²³⁷² P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 18.

²³⁷³ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 19.

²³⁷⁴ Zoran Stankoviq, T. 26178–26179 (14 maj 2008);

kufoma do të ishte plagosur nga lëndë shpërthyesë në pus atëherë do të kishin gjetur më shumë pjesë të kufomat atje. Sipas mendimit të tij, kjo do të thotë se lëndimi është shkaktuar gjatë.²³⁷⁵

(4) Xhemjal Kuqi (22-vjeçar, mashkull)

877. Hazbi Loku e identifikoi Xhemal Muradem Kuçin nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²³⁷⁶ Vebi Kuqi e identifikoi kufomën e kushëririt të tij, Xhemal Kuqit, me etiketë “Kufoma 4” përmes veshjes dhe sendeve vetjake.²³⁷⁷ Aktekspertiza austriake evidenton një plagë plumbi në pjesën e pasme të trungut. Në aktautopsinë e përmendur në të njëjtën aktekspertizë thuhet se në trup kishte gjurmë shpërthimi dhe zjarri dhe se në shpinë mund të shiheshin dëmtime të lëkurës, të cilat ka të ngjarë të kenë qenë plagë cifle. Mungonte koka e viktimës.²³⁷⁸ Stankoviqi komenton se mjeku që ka shkruar aktekspertizën bie në kundërshtim kur përshkruan lëndimet në trup dhe dëshmoi në gjyq se në aktekspertizë kishte një gabim ku thuhej se kishte një plagë plumbi në trung, ndërsa më poshtë thuhet se autopsia tregoi se kishte gjurmë shpërthimi dhe zjarri, dhe kjo mund ta diskualifikonte mjekun si ekspert.²³⁷⁹ Ai komenton se mjeku nuk e ka kryer këqyrjen me kujdesin e duhur.²³⁸⁰ Dhoma Gjyqësore vëren se duket sikur Stankoviqi e interpreton aktekspertizën sikur në jepen dy shkaqe për të e njëjtën plagë, çka nuk del qartë nga aktekspertiza.²³⁸¹ Më pas, gjatë dëshmisë së tij në gjyq, Stankoviqi u pajtua me sugjerimin se përshkrimi i parë i plagës ishte bërë nga dikush që mblidhte prova mjeko-ligjore në vendin ku ndodheshin kufomat, për dallim nga shënimet e autopsisë të bëra nga Dr. Markwalder në varrezën e Kaçanikut.²³⁸²

(5) Agim Loku (31-vjeçar, mashkull)

878. Hazbi Loku e identifikoi Agim Lokun nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²³⁸³ Isuf Loku e identifikoi kufomën e vëllait të tij, Agim Lokut, me etiketë “Kufoma 17”, përmes dhëmbëve dhe flokëve të mbetur.²³⁸⁴ Në aktekspertizën austriake evidentohen gjurmë shpërthimi dhe zjarri dhe një plagë e shkaktuar me armë zjarri në kufomë. Mungonte pjesa

²³⁷⁵ Zoran Stankoviq, T. 26200 (14 maj 2008).

²³⁷⁶ Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 3.

²³⁷⁷ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 13.

²³⁷⁸ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 12–13.

²³⁷⁹ Zoran Stankoviq, T. 26124, 26127, 26130–26131 (14 maj 2008); P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 12–13.

²³⁸⁰ Zoran Stankoviq, T. 26131–26134 (14 maj 2008).

²³⁸¹ Zoran Stankoviq, T. 26128–26129 (14 maj 2008).

²³⁸² Zoran Stankoviq, T. 26172–26173 (14 maj 2008).

²³⁸³ Hazbi Loku, T. 3164 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 5.

²³⁸⁴ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 30.

më e madhe e kufomat.²³⁸⁵ Në aktekspertizën e tij, Stankoviqi thotë se fakti që letërnjoftimi i kufomës është gjetur në dheun e pusit tregon se sendet janë hedhur në pus gjatë varrimit.²³⁸⁶

(6) Atan Loku (28-vjeçar, mashkull)

879. Hazbi Loku e identifikoi Adnan Lokun nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²³⁸⁷ Megjithatë, nuk është e qartë nëse kjo ka lidhje me emrin “Atan Loku”. Për më tepër, asnjë kufomë nuk është identifikuar se i përket Atan Lokut, ndërsa emri i tij nuk figuron në aktekspertizën e ekipit mjeko-ligjor austriak.

(7) Garip Loku (47-vjeçar, mashkull)

880. Hazbi Loku e identifikoi Garip Lokun nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²³⁸⁸ Emrush Loku e identifikoi kufomën me etiketë “Kufoma 11” si të vëllain e tij, Garip Lokun.²³⁸⁹ Në aktekspertizën austriake evidentohen gjurmë të shpërthimit, plagë të shkaktuara nga një shpërthim, tri plagë të shkaktuara me armë zjarri, përfshirë edhe një plagë të shkaktuar nga një predhë rrotulluese, dhe faktin se mund të supozohej se kishte gjakderdhje të brendshme sepse “mëlçia dhe mushkëritë ishin bërë copa”.²³⁹⁰ Mungonte shputa e majtë të kufomës.²³⁹¹

(8) Ibush Loku (20-vjeçar, mashkull)

881. Hazbi Loku e identifikoi Ibush Lokun nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²³⁹² Rexhep Loku e identifikoi kufomën me etiketë “Kufoma 21” si djalin e tij, Ibush Lokun.²³⁹³ Në aktekspertizën austriake evidentohen gjurmë shpërthimi dhe zjarri, një predhë të nxjerrë nga pjesa e sipërme e kofshës së majtë dhe fakti se ishin shkatërruar këmbët dhe kafka. Mungonin të dyja këmbët nën kofshë.²³⁹⁴

(9) Ismail Loku (28-vjeçar, mashkull)

²³⁸⁵ P361 (Aktespertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 30.

²³⁸⁶ 6D670 (Aktespertizë e Dr. Stankoviqit), para. 12.

²³⁸⁷ Hazbi Loku, T. 3164 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 1. *Shih gjithashtu* më poshtë lidhur me viktimën jo të përfshirë në listë, Adnan Loku.

²³⁸⁸ Hazbi Loku, T. 3164 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 4.

²³⁸⁹ P361 (Aktespertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 22.

²³⁹⁰ P361 (Aktespertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 23.

²³⁹¹ P361 (Aktespertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 22.

²³⁹² Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 1.

²³⁹³ P361 (Aktespertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 34.

²³⁹⁴ P361 (Aktespertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 33–34.

882. Hazbi Loku e identifikoi Ismail Lokun nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²³⁹⁵ Për më tepër, emri Ismail Loku, i datëlindjes 20 janar 1971, figuron në listën e viktimave dhe të lënduarve në aktekspertizën austriake si njëri prej personave që, sipas aktekspertizës austriake, “janë vrarë me të shtëna dhe shpërthim të eksplozivëve” në vendin e ngjarjes 1 (pusi i sipërm dhe i poshtëm i Kotlinës).²³⁹⁶ Megjithatë, asnjë kufomë nuk është identifikuar si e Ismail Lokut.²³⁹⁷ Krahas kësaj, në aktekspertizë nuk jepen të dhëna të tjera në lidhje me Ismail Lokun. Duhet thënë se sipas aktekspertizës austriake, pesë nga 22 kufomat apo pjesët trupore të gjetura në puse nuk mund të identifikoheshin (Kufoma 3, Kufoma 5, Kufoma 9, Kufoma 22 dhe Kufoma 23).²³⁹⁸

(10) Iziah Loku (19-vjeçar, mashkull)

883. Hazbi Loku e identifikoi Zija Lokun nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²³⁹⁹ Fshatarët e identifikuan kufomën e Iziah Lokut, me etiketë “Kufoma 2”, në bazë të sendeve të nxjerra në afërsi të kufomës.²⁴⁰⁰ Në aktekspertizën austriake evidentohet se gjurmët e shpërthimit dhe të zjarrit në trup mund të jenë shkaktuar ose përpara ose pas vdekjes. Kafka ishte tërësisht e copëtuar.²⁴⁰¹

(11) Milaim Loku (34-vjeçar, mashkull)

884. Hazbi Loku e identifikoi të vëllain, Milaim Loku, nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴⁰² Ai dëshmoi gjithashtu se e gjeti kufomën e vdekur të Milaim Lokut në një lumë të vogël gjashtë ditë pas sulmit të 9 marsit 1999, me një plagë në pjesën e pasme të kokës të shkaktuar me armë zjarri dhe plagën dalëse në fytyrë, si edhe një plagë të prerë në anën e djathtë.²⁴⁰³ Edhe pse asnjë kufomë nuk është identifikuar si e Milaim Lokut, Dhoma Gjyqësore e pranon dëshminë gjyqësore të Hazbi Lokut se Milaim Loku u vra gjatë sulmit të zhvilluar më 9 mars 1999.

²³⁹⁵ Hazbi Loku, T. 3164 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 5.

²³⁹⁶ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 6.

²³⁹⁷ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 6.

²³⁹⁸ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 11, 13, 20, 34, 36; *Shih gjithashtu* P1809 (raport i përgjithshëm i Eric Baccard-it), f. 48; Eric Baccard, T. 10129 (19 shkurt 2007).

²³⁹⁹ Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 1.

²⁴⁰⁰ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 9.

²⁴⁰¹ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 10.

²⁴⁰² Hazbi Loku, T. 3164 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 5.

²⁴⁰³ Hazbi Loku, P2296 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 qershor 1999), f. 3.

(12) Naser (R) Loku (17-vjeçar, mashkull)

885. Hazbi Loku e identifikoi Naser Lokun nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴⁰⁴ Rexhep Loku e identifikoi kufomën me etiketë “Kufoma 20” si të birin e tij, Nasser (R) Loku.²⁴⁰⁵ Në aktekspertizën austriake evidentohen gjurmë shpërthimi dhe zjarri në trup, disa plagë nga ciflat në shpinë dhe një plagë me thikë në fytyrë. Mungonte pjesa e poshtme e këmbës së djathtë koka dhe këmbët ishin shkatërruar nga pasojat e shpërthimit.²⁴⁰⁶ Stankoviqi raportoi se nuk mund të thuhej me siguri se plaga e fytyrës ishte shkaktuar me thikë, sepse mund të jetë shkaktuar edhe me shrapnel.²⁴⁰⁷

(13) Sabit Loku (20-vjeçar, mashkull)

886. Hazbi Loku e identifikoi Sabit Lokun nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴⁰⁸ Për më tepër, emri Sabit Loku, i datëlindjes 1979, figuron në listën e viktimave dhe të lënduarve në aktekspertizën austriake si njëri prej personave që, sipas aktekspertizës austriake, “janë vrarë me të shtëna dhe shpërthim të eksplozivëve” në vendin e ngjarjes 1 (pusi i sipërm dhe i poshtëm i Kotlinës).²⁴⁰⁹ Megjithatë, asnjë kufomë nuk është identifikuar si e Sabit Lokut. Krahas kësaj, në aktekspertizë nuk jepen të dhëna të tjera në lidhje me Sabit Lokun. Duhet thënë se sipas aktekspertizës austriake, 5 nga 22 kufomat apo pjesët trupore të gjetura në puse nuk mund të identifikoheshin (Kufoma 3, Kufoma 5, Kufoma 9, Kufoma 22 dhe Kufoma 23).²⁴¹⁰

(14) Zymer Loku (67-vjeçar, mashkull)

887. Hazbi Loku e gjeti Zymer Lokun të gjallë, por shumë të lënduar, më 24 mars 1999, pasi “serbët filluan të largohen nga” fshati.²⁴¹¹ Zymer Loku kishte plagë në kraharor dhe këmbën e djathtë nga gjuri e kishte pothuajse të këputur. Megjithatë, ai dëshmoi se Zymer Loku “vdiq nga lëndimet” më vonë atë ditë dhe e identifikoi gjithashtu në bazë të fotografive.²⁴¹² Kufoma i Zymer Lokut u zhvarros nga oborri i brendshëm të xhamisë së Kotlinës.²⁴¹³ Aktekspertiza austriake i kishte vënë kufomat të Zymer Lokut etiketën “Kufoma 25”. Sipas aktekspertizës, dora e djathtë ishte e fashuar

²⁴⁰⁴ Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 1.

²⁴⁰⁵ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 33.

²⁴⁰⁶ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 32–33.

²⁴⁰⁷ 6D670 (Aktekspertizë e Dr. Stankoviqit), para. 14.

²⁴⁰⁸ Hazbi Loku, T. 3164 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 4.

²⁴⁰⁹ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 6, 71.

²⁴¹⁰ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 11, 13, 20, 34, 36; *Shih gjithashtu* P1809 (raport i përgjithshëm i Eric Baccard-it), f. 48; Eric Baccard, T. 10129 (19 shkurt 2007).

²⁴¹¹ Hazbi Loku, P2296 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 qershor 1999), f. 6.

²⁴¹² Hazbi Loku, P2296 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 qershor 1999), f. 6; Hazbi Loku, T. 3164 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 5.

ndërsa këmba e djathtë ishte mbështjellë me një shall me kuadrate. Një letërnjoftim me numër SK 01361710, i lëshuar në Kaçanik më 19 shkurt 1990 me emrin Zimer Loki Kemal u gjet në xhepat e tij. Në aktekspertizë evidentohet shkak i vdekjes si një plagë e shkaktuar me armë zjarri në pulpën e djathtë dhe gjakderdhje e jashtme.²⁴¹⁴ Stankoviçi komentonte në aktekspertizën e tij se vdekja nga hemorragjia mund të ndodhë vetëm nëse lëndohet një enë e madhe gjaku e eshtrave të poshtme, afër eshtrave. Ai nënvizonte edhe mospërputhjen midis aktekspertizës austriake se kishte një plagë shkaktuar me armë zjarri në pulpën e djathtë dhe dëshmisë së Lokut se këmba e tij e djathtë ishte thuarje e këputur.²⁴¹⁵

(15) Neshat Rexha (16-vjeçar, mashkull)

888. Hazbi Loku e identifikoi Neshad Rexhën nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴¹⁶ Ferid B. Rexha e identifikoi kufomën me etiketë “Kufoma 7” si të birin, Neshat Rexhën.²⁴¹⁷ Në aktekspertizën austriake evidentohen gjurmë shpërthimi dhe zjarri në trup dhe thuhet se kafka është thyer nga forca e një goditjeje me mjet të fortë. Nuk mund të përcaktohet nëse lëndimi është pësuar përpara vdekjes apo pas saj.²⁴¹⁸ Stankoviçi dëshmoi në gjyq se në aktekspertizën austriake duhej të ishte shpjeguar më me hollësi fraktura e kafkës duke qenë se mund të ketë disa shpjegime për shkakun e saj.²⁴¹⁹ Gjatë pyetjeve nga Prokuroria, ai konfirmoi se një lëndim i tillë i kafkës mund të jetë shkaktuar edhe nga degët dhe shkopinjtë e bimësisë rreth pusit.²⁴²⁰ Ai shpjegoi edhe se ka krahasuar nëse përshkrimi i veshjeve të trupave të nxjerrë nga pusët përputhet apo jo me teshat që mund të shihen në fotografitë e nxjerra nga MPB-ja²⁴²¹ në vendngjarje dhe se kishte arritur në përfundimin se ka arsye të besojë se një trup në hendekun pranë njërit prej puseve ka veshjet që thuhet se janë të Neshat Rexhës.²⁴²²

(16) Sali (M) Vlasi (42-vjeçar, mashkull)

889. Hazbi Loku e identifikoi Sali Vasliun nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴²³ Zyber Vlasi e identifikoi kufomën me etiketë “Kufoma 6” si të vëllain,

²⁴¹³ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 38–39.

²⁴¹⁴ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 39–40.

²⁴¹⁵ 6D670 (Aktekspertizë e Dr. Stankoviçit), para. 16.

²⁴¹⁶ Hazbi Loku, T. 3164 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 5.

²⁴¹⁷ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 16.

²⁴¹⁸ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 16.

²⁴¹⁹ Zoran Stankoviç, T. 26136 (14 maj 2008); *Shih gjithashtu* 6D670 (Aktekspertizë e Dr. Stankoviçit), para. 10.

²⁴²⁰ Zoran Stankoviç, T. 26170 (14 maj 2008). *Shih gjithashtu* 6D670 (Aktekspertizë e Dr. Stankoviçit), para. 18.

²⁴²¹ *Shih* 6D501 (Dosje e lëndës për një akt terrorizmi në Kotlinë, 24 mars 1999).

²⁴²² Zoran Stankoviç, T. 26139, 26182–26184 (14 maj 2008). *Shih gjithashtu* 6D670 (Aktekspertizë e Dr. Stankoviçit), para. 2. Gjatë marrjes në pyetje nga pala tjetër ai i krahasoi teshat në bazë të ngjyrave të tyre.

²⁴²³ Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 1.

Sali Vlashin.²⁴²⁴ Në aktekspertizën austriake evidentohen gjurmë shpërthimi dhe zjarri në trup, plagë të shkaktuara me armë zjarri, dhe kokën dhe këmbët e copëtuara. Këmbët kanë qenë, “sipas supozimeve, në qendër të shpërthimit”.²⁴²⁵ Në aktekspertizën e tij, Stankoviqi thotë në lidhje me këtë kufomë se është gjetur e shtrirë përmbys në pus dhe se qendra e plagës ishte në bark. Ai konkludoi se “me siguri” plaga ishte shkaktuar jashtë pusit dhe shpjegonte se nëse kufoma do të kishte qenë në pus përpara se të hidhej mjete shpërthyes në të atëherë do të kishte qenë e logjikshme që lëndimet të ishin në pjesën e pasme dhe jo në pjesën e përparme, po të kemi parasysh pozicionin në të cilin janë gjetur kufomat.²⁴²⁶

(17) Vesel Vlashi (55-vjeçar, mashkull)

890. Hazbi Loku e përmendi emrin e Vesel Vlashit, duke u nisur nga fotografitë, si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴²⁷ Ai dëshmoi se disa burra nga Kottlina e kishin gjetur Vesel Vlashin në një dhomë të katit të dytë të shtëpisë së Liman Lokut. Hazbi Lokut i thanë se Vesel Vlashit i kishin qëlluar disa herë në kraharor dhe se pjesa e poshtme e kufomat të tij ishte djegur keqas.²⁴²⁸ Kufoma i Veysel Vlashit u zhvarros nga oborri i brendshëm të xhamisë së Kotlinës.²⁴²⁹ Aktautopsia austriake i ka vënë Veysel Vlashit etiketën “Kufoma 26”²⁴³⁰ dhe ka identifikuar gjurmë bloze në krahët dhe këmbët e tij dhe disa plagë të shkaktuara me armë zjarri. Sipas aktekspertizës, këto plagë mund të kenë qenë edhe shkaku i vdekjes.²⁴³¹ Në një portofol plastik të gjetur në xhepin e xhakëtës së tij kishte një patentë shoferi jugosllave, një letërnjoftim dhe një pasaportë, të gjitha të lëshuara në emrin e Veysel Vlashit.²⁴³²

2. Viktimat e papërfshira në Listën K të Aktakuzës (Kotlinë)

(1) Minah Kuqi ([nuk ka të dhëna për moshën], mashkull)

891. Hazbi Loku e identifikoi Minan Kuqin, duke u nisur nga fotografitë, si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴³³ Baki Kuqi e identifikoi kufomën e të birit, Minah Kuqit, me

²⁴²⁴ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 15.

²⁴²⁵ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 15.

²⁴²⁶ Zoran Stankoviqi, T. 26150 (14 maj 2008); 6D670 (Aktekspertizë e Dr. Stankoviqit), para. 8.

²⁴²⁷ Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 2.

²⁴²⁸ Hazbi Loku, P2296 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 qershor 1999), f. 5.

²⁴²⁹ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 38–39.

²⁴³⁰ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 40.

²⁴³¹ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 41.

²⁴³² P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 41.

²⁴³³ Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006); P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 1.

etiketë “Kufoma 1”, përmes veshjes.²⁴³⁴ Në aktekspertizën austriake evidentohen gjurmë shpërthimi dhe zjarri në kufomë. Ishin të pranishme disa plagë hyrëse të plumbave. Sipas aktekspertizës, plagët e plumbave ka shumë të ngjarë të jenë shkaktuar pas vdekjes, sepse nuk kishte asnjë hematomë në to.²⁴³⁵

(2) Sherif Kuqi ([nuk ka të dhëna për moshën], mashkull)

892. Hazbi Loku e identifikoi Sherif Kuçin nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴³⁶ Vebi Kuqi e identifikoi kufomën me etiketë “Kufoma 12” si të vëllain, Sherif Kuqi.²⁴³⁷ Në aktekspertizën austriake evidentohen gjurmë shpërthimi dhe djegie në trup dhe plagë të shumëfishta shkaktuar me armë zjarri dhe thuhet se zorrët, mëlçia dhe mushkëritë e viktimës ishin shkatërruar nga të shtëna me armë zjarri ose nga pasojat e shpërthimit.²⁴³⁸ Në aktekspertizën e tij, Stankoviqi thotë në lidhje me këtë kufomë se është gjetur e shtrirë në shpinë me plagë shpërthimi në pjesën e përparme. Ai konkludoi se plaga ishte shkaktuar jashtë pusit dhe shpjegon se nëse kufoma do të kishte qenë në pus përpara se të hidhej mjeti shpërthyes në të atëherë do të kishte qenë e logjikshme që lëndimet të ishin në pjesën e pasme dhe jo në pjesën e përparme, po të kemi parasysh pozicioni në të cilin janë gjetur kufomat.²⁴³⁹

(3) Ismet Loku ([nuk ka të dhëna për moshën], mashkull)

893. Hazbi Loku e përmendi emrin e Ismet Lokut, duke u nisur nga fotografitë, si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴⁴⁰ Zenel Loku e identifikoi kufomën e të birit, Ismet Lokut, me etiketë “Kufoma 14”, përmes veshjes dhe sendeve vetjake.²⁴⁴¹ Në aktekspertizën austriake evidentohen gjurmë shpërthimi dhe djegie në trup, një plagë në sup shkaktuar me armë zjarri dhe se kafka është thyer nga forca e një goditjeje me mjet të fortë.²⁴⁴²

(4) Mahi Loku ([nuk ka të dhëna për moshën], mashkull)

894. Hazbi Loku e identifikoi Mahi Lokun nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴⁴³ Latif Loku e identifikoi kufomën e të vëllait, Mahi Lokut, me etiketë

²⁴³⁴ P361 (Aktespertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 10.

²⁴³⁵ P361 (Aktespertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 11.

²⁴³⁶ Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006); P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 2.

²⁴³⁷ P361 (Aktespertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 24.

²⁴³⁸ P361 (Aktespertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 24.

²⁴³⁹ Zoran Stankoviç, T. 26150 (14 maj 2008); 6D670 (Aktespertizë e Dr. Stankoviçit), para. 8.

²⁴⁴⁰ Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006); P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 1.

²⁴⁴¹ P361 (Aktespertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 26.

²⁴⁴² P361 (Aktespertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 27.

²⁴⁴³ Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006); P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 1.

“Kufoma 18”, përmes veshjes.²⁴⁴⁴ Në aktekspertizën austriake evidentohen gjurmë shpërthimi dhe zjarri në trup, dhe plagë cifle në shpinën e viktimës.²⁴⁴⁵

(5) Naser (F) Loku ([nuk ka të dhëna për moshën], mashkull)

895. Hazbi Loku e identifikoi Nasir Fadil Lokun nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴⁴⁶ Mohamed Loku e identifikoi kufomën e të vëllait, Naser (F) Lokut, me etiketë “Kufoma 19”, në bazë të veshjes.²⁴⁴⁷ Në aktekspertizën austriake evidentohen gjurmë shpërthimi dhe zjarri në trup, një plagë në stomak shkaktuar me armë zjarri dhe disa plagë në shpinë, që mund jenë shkaktuar nga goditje me armë zjarri ose nga një shpërthim.²⁴⁴⁸ Stankoviqi vërente në aktekspertizën e tij se fakti që personat që kanë bërë këqyrjen mjekësore nuk kanë qenë në gjendje të saktësojnë nëse lëndimet janë shkaktuar nga një armë zjarri apo nga një shpërthim konfirmon mungesën e përvojës së tyre si ekspertë në fushën e plagëve të armëve të zjarrit dhe shpërthimeve dhe në fushën e metodave të konstatimit të shrapnelit në një kufomë.²⁴⁴⁹

(6) Bajram Loku ([nuk ka të dhëna për moshën], mashkull)

896. Hazbi Loku e identifikoi Bajram Lokun duke u nisur nga fotografitë, si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴⁵⁰ Aktekspertiza austriake vëren se pjesët e një kufome me etiketë “Kufoma 23”, së bashku me pjesë të mbetura të veshjeve, copa mishi dhe eshtrash, nuk mund të identifikoheshin. Megjithatë, në masën e zhvarrosur ishte një xhakëtë e cila u identifikua në vend nga Qani Loku si send i të birit, Bajram Lokut.²⁴⁵¹

(7) Sabri Loku ([nuk ka të dhëna për moshën], mashkull)

897. Hazbi Loku e identifikoi Sabri Hamed Lokut nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴⁵² Për më tepër, emri Sabri Loku, i datëlindjes 18 maj 1971, figuron në listën e viktimave dhe të lënduarve në aktekspertizën austriake si njëri prej personave që, sipas aktekspertizës austriake, “janë vrarë me armë zjarri dhe eksploziv” në vendin e ngjarjes 1 (pusi i sipërm dhe i poshtëm i Kotlinës).²⁴⁵³ Megjithatë, asnjë kufomë nuk është identifikuar si e Sabri

²⁴⁴⁴ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 31.

²⁴⁴⁵ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 31.

²⁴⁴⁶ Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006); P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 3.

²⁴⁴⁷ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 32.

²⁴⁴⁸ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 32.

²⁴⁴⁹ 6D670 (Aktekspertizë e Dr. Stankoviqit), para. 13.

²⁴⁵⁰ Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006); P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 1.

²⁴⁵¹ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 36.

²⁴⁵² Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006); P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 3.

²⁴⁵³ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 6, 71.

Lokut. Krahas kësaj, në aktekspertizë nuk jepen të dhëna të tjera në lidhje me Sabri Lokun. Duhet thënë se sipas aktekspertizës austriake, pesë nga 22 kufomat apo pjesët trupore të gjetura në puse nuk mund të identifikoheshin (Kufoma 3, Kufoma 5, Kufoma 9, Kufoma 22 dhe Kufoma 23).²⁴⁵⁴

(8) Emërllah Kuçi ([nuk ka të dhëna për moshën], mashkull)

898. Hazbi Loku e gjeti dhe e identifikoi kufomën e Emërllah Kuçit gjashtë ditë pas sulmit të 9 marsit, pranë kufomat të Milaim Lokut. Kishte dy vrima plumbi në xhaketë, në anën e djathtë të shpinës, dhe dy vrima të tjera, në anën e majtë të xhaketës. Kufomën e kishin ngrënë pjesërisht kafshët, kështu që plagët e sipërpërmendura, të shkaktuara me armë zjarri, ishin të vetmet që mund të shihje dëshmitari. Emërllah Kuçi është zhdukur më 9 mars 1999.²⁴⁵⁵ Asnjë kufomë nuk është identifikuar si e Emërllah Kuçit.

(9) Atmir Loku ([nuk ka të dhëna për moshën], mashkull)

899. Emrush Loku i identifikoi pjesët trupore të nipit të tij, Atmir Lokut, me etiketë “Kufoma 10”, përmes atyre pjesëve të veshjes që kishin mbetur.²⁴⁵⁶ Në aktekspertizën e Ekipit Mjekoligjor Austriak evidentohen gjurmë shpërthimi dhe zjarri në kufomë, e cila përbëhej vetëm nga gjymtyrët e poshtme. Pjesa e sipërme e kufomat mungonte.²⁴⁵⁷ Emrush Loku i identifikoi pjesët trupore të Atmir Lokut, me etiketë “Kufoma 16”, duke dalluar dhëmbët e dalë dhe të vendosur në mënyrë të çrregullt në nofullën e sipërme dhe përmes të brendshmeve në ngjyrë kaki në të gjelbër.²⁴⁵⁸ Në aktekspertizën austriake evidentohen gjurmë shpërthimi dhe djegie në pjesët e kufomës dhe fakti se kufoma ndodhej thujse në qendër të shpërthimit. Kafka ishte thyer si pasojë e goditjes me mjet të fortë. Në bazë të veshjes, është konstatuar se gjymtyrët e poshtme të viktimës janë etiketuar si “Kufoma 10”.²⁴⁵⁹

(10) Cen Loku ([nuk ka të dhëna për moshën], mashkull)

900. Ekrem Loku e identifikoi kufomën e të birit, Cen Lokut, me etiketë “Kufoma 15”, përmes çizmeve dhe çorapeve.²⁴⁶⁰ Në aktekspertizën austriake evidentohen gjurmë shpërthimi dhe djegie në trup dhe fakti se kufoma pothuajse ishte shkatërruar nga efekti i shpërthimit.²⁴⁶¹

²⁴⁵⁴ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 11, 13, 20, 34, 36; *Shih gjithashtu* P1809 (raport i përgjithshëm i Eric Baccard-it), f. 48; Eric Baccard, T. 10129 (19 shkurt 2007).

²⁴⁵⁵ P2296 (deklaratë e dëshmitarit, datë 4 qershor 1999), f. 3.

²⁴⁵⁶ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 20.

²⁴⁵⁷ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 20.

²⁴⁵⁸ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 29.

²⁴⁵⁹ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 29. *Shih gjithashtu* f. 19–20.

²⁴⁶⁰ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 28.

²⁴⁶¹ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 28.

(11) Danush Kuqi ([nuk ka të dhëna për moshën], mashkull)

901. Hazbi Loku e identifikoi Danush Idriz Kuçin nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴⁶² Për më tepër, emri Danush Kuqi, i datëlindjes qershor 1982, figuron në listën e viktimave dhe të lënduarve në aktekspertizën austriake si njëri prej personave që, sipas aktekspertizës austriake, “janë vrarë me të shtëna dhe shpërthim të eksplozivëve” në vendin e ngjarjes 1 (pusi i sipërm dhe i poshtëm i Kotlinës).²⁴⁶³ Megjithatë, asnjë kufomë nuk është identifikuar si e Danush Kuqit. Krahas kësaj, në aktekspertizë nuk jepet asnjë të dhëna tjetër në lidhje me Danush Kuqin. Duhet thënë se sipas aktekspertizës austriake, 5 nga 22 kufomat apo pjesët trupore të gjetura në puse nuk mund të identifikoheshin (Kufoma 3, Kufoma 5, Kufoma 9, Kufoma 22 dhe Kufoma 23).²⁴⁶⁴

(12) Adnan Loku ([nuk ka të dhëna për moshën], mashkull)

902. Hazbi Loku e identifikoi Adnan Lokun nga fotografitë si njërin prej personave të vrarë në Kotlinë në mars 1999.²⁴⁶⁵ Asnjë kufomë nuk është identifikuar se i përket Adnan Lokut, ndërsa emri i tij nuk del në aktekspertizën e ekipit mjeko-ligjor austriak.

3. Viktimat e përfshira në Listën K të Aktakuzës (Vataj (Sllatinë))

903. Dhoma vëren se ka një sërë mospërputhjesh midis provave mjeko-ligjore dhe Aktakuzës sa i takon shkrimit të emrave të disa prej viktimave të renditur në Listën K (Vataj (Sllatinë)). Megjithatë, në shumicën e rasteve, këto mospërputhje janë aq të vogla saqë Dhoma është në gjendje të arrijë në përfundim se të dhënat e caktuara lidhen me viktimën përkatëse.

(1) Illir Osman Caka (15-vjeçar, mashkull)

904. Sejdi Lami e varrosi Illir Osman Cakën në varrezën e fshatit Vataj, Lamë, më 14 prill 1999.²⁴⁶⁶ Ai e identifikoi Illir Osman Cakën si njërin prej shtatë personave të vrarë në lagjet e Cakës dhe Tifekut më 13 prill 1999.²⁴⁶⁷ Aktekspertiza mjeko-ligjore e Lamës evidenton plagët në kokë dhe kraharor të shkaktuara me armë zjarri si shkakun e vdekjes së Illir Osman Cakës, me etiketën

²⁴⁶² Hazbi Loku, T. 3163 (11 shtator 2006); P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 2.

²⁴⁶³ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 6, 71.

²⁴⁶⁴ P361 (Aktekspertiza e Ekipit Mjeko-Ligjor Austriak për Kotlinën), f. 11, 13, 20, 34, 36; *Shih gjithashtu* P1809 (raport i përgjithshëm i Eric Baccard-it), f. 48; Eric Baccard, T. 10129 (19 shkurt 2007).

²⁴⁶⁵ Hazbi Loku, T. 3164 (11 shtator 2006), P380 (24 fotografi të ofruara nga Hazbi Loku), f. 1. *Shih gjithashtu* më lart lidhur me viktimën e përfshirë në listë, Atan Loku.

²⁴⁶⁶ Sejdi Lami, T. 3260–3261 (12 shtator 2006).

²⁴⁶⁷ Sejdi Lami, T. 3260–3261 (12 shtator 2006). P2271 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 korrik 2000), f. 5.

“viktima nr 7”, më 13 prill 1999. Aktekspertiza konkludon se “konstatimet e autopsisë përputhen me pretendimet se është ekzekutuar nga largësia”.²⁴⁶⁸

(2) Jakup Mustaf Caka (37-vjeçar, mashkull)

905. Sejdi Lami e varrosi Jakup Mustafë Cakën në varrezën e fshatit Vataj, Lamë, më 14 prill 1999. Ai e identifikoi Jakup Cakën si njërin prej shtatë personave të vrarë në lagjet e Cakës dhe Tifekut më 13 prill 1999.²⁴⁶⁹ Aktekspertiza mjeko-ligjore e Lamës evidentonte një plagë të vetme të kraharorit të shkaktuar me armë zjarri si shkakun e vdekjes së Jakup Mustafë Cakës, me etiketë “viktima nr 6”, më 13 prill 1999.²⁴⁷⁰

(3) Mahmut Hasan Caka (45-vjeçar, mashkull)

906. Sejdi Lami e identifikoi Mahmut Cakën si njërin prej katër trupave të vdekur që ka gjetur në një rrugicë, nga fshati i Vatajt, Lamë, në një vend të cilin vendasit e quajnë “Gurët e Kripës”, më 13 prill 1999.²⁴⁷¹ Sipas aktekspertizës mjeko-ligjore të Lamës, kufoma u identifikua nga vëllai i të ndjerit, me etiketë “viktima nr 5”, ndërsa vdekja ka ndodhur më 13 prill 1999.²⁴⁷² Në aktekspertizën Mjeko-ligjore të Lamës evidentohet një plagë në kraharor e shkaktuar me armë zjarri si shkakun e vdekjes dhe thuhet se, nga pamja, plaga dukej sikur të ishte shkaktuar nga largësia.²⁴⁷³

(4) Qemajl Deda (47-vjeçar, mashkull)

907. Në aktautopsinë për varrin e Sllatinës evidentohet një plagë në kraharor të shkaktuar me armë zjarri, një plagë me thikë në kraharor dhe një prerje në fyt si shkakun e vdekjes së Qemajl Dedës. Aktautopsia konkludon se mënyra e vdekjes ishte vrasje.²⁴⁷⁴

(5) Nazmi Elezi (29-vjeçar, mashkull)

908. Në aktautopsinë për varrin e Sllatinës evidentohet plaga në kokë me granatë si shkakun e mundshëm të vdekjes së Nazmi Elezit. Aktautopsia konkludon se mënyra e vdekjes ishte vrasje.²⁴⁷⁵

²⁴⁶⁸ P364 (Aktekspertiza Mjeko-Ligjore e Lamës), f. 21–24; P363 (Aktekspertizë e Ekipit Mjeko-Ligjor Kanadez, 22 korrik 1999), f. 13.

²⁴⁶⁹ Sejdi Lami, T. 3260–3261 (12 shtator 2006). P2271 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 korrik 2000), f. 5.

²⁴⁷⁰ P364 (Aktekspertiza Mjeko-Ligjore e Lamës), f. 17–20; P363 (Aktekspertizë e Ekipit Mjeko-Ligjor Kanadez, 22 korrik 1999), f. 13.

²⁴⁷¹ P2271 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 korrik 2000), f. 4; T. 3262 (12 shtator 2006).

²⁴⁷² P364 (Aktekspertiza Mjeko-Ligjore e Lamës), f. 13; P363 (Aktekspertizë e Ekipit Mjeko-Ligjor Kanadez, 22 korrik 1999), f. 12.

²⁴⁷³ P364 (Aktekspertiza Mjeko-Ligjore e Lamës), f. 13–16.

²⁴⁷⁴ P365 (Aktautopsi për varrezën e Sllatinës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 5.

²⁴⁷⁵ P365 (Aktautopsi për varrezën e Sllatinës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 11.

(6) Vesel Elezi (41-vjeçar, mashkull)

909. Aktautopsia për varrin e Sllatinës evidentonte plagë të shumëfishta shkaktuar me armë zjarri si shkakun e vdekjes së Vesel Elezit. Akti konkludon se mënyra e vdekjes ishte vrasje.²⁴⁷⁶

(7) Brahim Lama (52-vjeçar, mashkull)

910. Sejdi Lami e përmendi emrin e Brahim Lamës si njërin prej katër trupave të vdekur që ka gjetur në një rrugicë, nga fshati i Vatajt, Lamë, në një vend të cilin vendasit e quajnë “Gurët e Kripës”, më 13 prill 1999.²⁴⁷⁷ Në aktekspertizën mjeko-ligjore të Lamës evidentohen plagë të shumëfishta në kraharorit të shkaktuara me armë zjarri si shkakun e vdekjes së Brahim Lamës me etiketë “viktima nr 9”, më 13 prill 1999.²⁴⁷⁸

(8) Hebib Lama (18-vjeçar, mashkull)

911. Sejdi Lami e identifikoi Hebib Lamën si njërin prej katër kufomave që kishte gjetur në një rrugicë, nga fshati i Vatajt, Lamë, në një vend të cilin vendasit e quajnë “Gurët e Kripës”, më 13 prill 1999.²⁴⁷⁹ Në aktekspertizën Mjeko-ligjore të Lamës evidentohen plagë të shumëfishta në kraharor dhe bark të shkaktuara me armë zjarri si shkakun e vdekjes së Hebib Lamës me etiketë “viktima nr 10”, më 13 prill 1999.²⁴⁸⁰

(9) Ibrahim Lama (52-vjeçar, mashkull)

912. Në aktekspertizën Mjeko-ligjore të Lamës evidentohen plagë në kraharor të shkaktuara me armë zjarri si shkakun e vdekjes së Ibrahim Lamës me etiketë “viktima nr 8”, më 13 prill 1999.²⁴⁸¹

(10) Izahir Salihu (22-vjeçar, mashkull)

913. Në aktekspertizën Mjeko-ligjore të Lamës evidentohet një plagë në shpinë e shkaktuar me armë zjarri si shkakun e vdekjes së Izahir Ilaz Salihut me etiketë “viktima nr 4”, më 13 prill 1999.²⁴⁸²

(11) Kemajl Salihu (40-vjeçar, mashkull)

²⁴⁷⁶ P365 (Aktautopsi për varrezën e Sllatinës), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 19.

²⁴⁷⁷ Sejdi Lami, P2271 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 korrik 2000), f. 4, T. 3261–3262 (12 shtator 2006).

²⁴⁷⁸ P364 (Aktekspertiza Mjeko-Ligjore e Lamës), f. 29–32; P363 (Aktekspertizë e Ekipit Mjeko-Ligjor Kanadez, 22 korrik 1999), f. 12.

²⁴⁷⁹ Sejdi Lami, P2271 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 korrik 2000), f. 4, T. 3261–3262 (12 shtator 2006).

²⁴⁸⁰ P364 (Aktekspertiza Mjeko-Ligjore e Lamës), f. 33–36; P363 (Aktekspertizë e Ekipit Mjeko-Ligjor Kanadez, 22 korrik 1999), f. 12.

²⁴⁸¹ P364 (Aktekspertiza Mjeko-Ligjore e Lamës), f. 25–28.

²⁴⁸² P364 (Aktekspertiza Mjeko-Ligjore e Lamës), f. 10–12; P363 (Aktekspertizë e Ekipit Mjeko-Ligjor Kanadez, 22 korrik 1999), f. 13.

914. Në aktekspertizën mjeko-ligjore të Lamës evidentohet një plagë në bark e shkaktuar me armë zjarri si shkak i vdekjes së Kemajl Ilaz Salihut me etiketë “viktima nr 3”, më 13 prill 1999.²⁴⁸³

(12) Sabri Salihu (38-vjeçar, mashkull)

915. Në aktekspertizën Mjeko-ligjore të Lamës evidentohen plagë në shpinë të shkaktuara me armë zjarri si shkak i vdekjes së Sabri Ilaz Salihut me etiketë “viktima nr 2”, më 13 prill 1999.²⁴⁸⁴

(13) Shyqyri Halili (46-vjeçar, mashkull)

916. Sejdi Lami e identifikoi Shyqyriun si njërin prej personave të vrarë në fshatin Vataj më 13 prill 1999.²⁴⁸⁵ Në aktekspertizën mjeko-ligjore të Lamës evidentohet një plagë në pjesën e poshtme të shpinës e shkaktuar me armë zjarri si shkak i vdekjes së Shyqyri Halilit me etiketë “viktima nr 11”, më 13 prill 1999.²⁴⁸⁶ Në aktekspertizë evidentohen edhe katër plagë të shkaktuara me armë zjarri, në sup dhe krahë, të cilat janë potencialisht vdekjeprurëse dhe të cilat, për shkak të gjakderdhjes së shkaktuar kanë kontribuar në vdekjen e viktimës.²⁴⁸⁷ Në aktekspertizën mjeko-ligjore kanadeze thuhet se viktima është identifikuar nga i ati, Beqir Halili.²⁴⁸⁸

4. Viktimat e papërfshira në Listën K të Aktakuzës (Vataj (Sllatinë))

(1) Ramadan Xhokli (28-vjeçar, mashkull)

917. Sejdi Lami e përmend Ramadan Xhoklin si njërin prej personave të vrarë në Vataj, Komuna e Kaçanikut, më 13 prill 1999.²⁴⁸⁹ Në aktekspertizën mjeko-ligjore kanadeze kufoma në varrin nr 1 identifikohet si Ramadan Xhokli.²⁴⁹⁰ Në Aktekspertizën mjeko-ligjore kanadeze thuhet se viktima është identifikuar nga vëllai, Zeqir Xhokli.²⁴⁹¹

(2) Rraman Lami (52-vjeçar, mashkull)

²⁴⁸³ P364 (Aktekspertiza Mjeko-Ligjore e Lamës), f. 6–9; P363 (Aktekspertizë e Ekipit Mjeko-Ligjor Kanadez, 22 korrik 1999), f. 13.

²⁴⁸⁴ P364 (Aktekspertiza Mjeko-Ligjore e Lamës), f. 2–5; P363 (Aktekspertizë e Ekipit Mjeko-Ligjor Kanadez, 22 korrik 1999), f. 13.

²⁴⁸⁵ Sejdi Lami, T. 3261 (12 shtator 2006). P2271 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 korrik 2000), f. 5.

²⁴⁸⁶ P364 (Aktekspertiza Mjeko-Ligjore e Lamës), f. 38–41; P363 (Aktekspertizë e Ekipit Mjeko-Ligjor Kanadez, 22 korrik 1999), f. 12.

²⁴⁸⁷ P364 (Aktekspertiza Mjeko-Ligjore e Lamës), f. 40.

²⁴⁸⁸ P363 (Aktekspertizë e Ekipit Mjeko-Ligjor Kanadez, 22 korrik 1999), f. 17.

²⁴⁸⁹ Sejdi Lami, T. 3261 (12 shtator 2006). P2271 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 korrik 2000), f. 5.

²⁴⁹⁰ P363 (Aktekspertizë e Ekipit Mjeko-Ligjor Kanadez, 22 korrik 1999), f. 4.

²⁴⁹¹ P363 (Aktekspertizë e Ekipit Mjeko-Ligjor Kanadez, 22 korrik 1999), f. 17.

918. Në aktekspertizën mjeko-ligjore kanadeze Rraman Lama fillimisht identifikohet në varrin numër 9.²⁴⁹² Megjithatë, më pas në aktekspertizë Rraman Lama quhet “viktima mashkull nr 8”.²⁴⁹³ Duket se ka një mospërputhje të brendshme në aktekspertizë. Sejdi Lami e identifikoi njëren prej viktimave të vrarë më 13 prill 1999 si Rraman Lami.²⁴⁹⁴

5. Viktimat e përfshira në Listën K të Aktakuzës (Stagovë)

919. Dhoma vëren se ka një sërë mospërputhjesh midis provave mjeko-ligjore dhe Aktakuzës sa i takon shkrimit të emrave të disa prej viktimave të renditur në Listën K (Stagovë). Megjithatë, në shumicën e rasteve, këto mospërputhje janë aq të vogla sa që Dhoma është në gjendje të arrijë në përfundimin se të dhënat e caktuar me viktimën përkatëse.

(1) Baki Bela (72-vjeçar, mashkull)

